

**UNIVERSITETI I TETOVËS**  
**FAKULTETI FILOZOFIK**  
**Programi studimor: Histori**  
**Cikli i tretë i studimeve**



**Disertacion doktore**

**Pozita e shqiptarëve në Shkup me rrethinë**  
**1918-1941**

**Mentori:**

**Prof. Dr. Nebi Dervishi**

**Kandidati:**

**Mr. Besnik Rameti**

**Tetovë, 2020**

<b>PËRMBAJTJA</b>	
<b>PARATHËNIE</b> .....	<b>5</b>
<b>HYRJE</b> .....	<b>7</b>
<b>Kapitulli I</b>	
<b>I. Pozita e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë gjatë sundimit të Mbretërisë Serbe</b>	
<b>Kroate dhe Sllovene (SKS) 1918-1929</b> .....	<b>12</b>
I.1. Ndarja administrative dhe territoriale të shqiptarët në Shkup me rrethinë.....	12
I.2. Gjendja ekonomike e shqiptarëve në Shkup me rrethinë.....	16
I.3 Gjendja politike e shqiptarëve dhe aktiviteti politik i Xhemijetit në Shkup me rrethinë gjatë viteve 1918-1929.....	20
<b>Kapitulli II</b>	
<b>II. Pozita e shqiptarëve gjatë Mbretërisë Jugosllave 1929-1941, Shkupi qendër administrative e Banovinës së Vardarit</b> .....	
	<b>38</b>
II.1. Ndarja administrative dhe territoriale dhe shqiptarët në Shkup me rrethinë .....	38
II.2. Gjendja ekonomike e shqiptarëve në Shkup me rrethinë.....	43
II.3. Pozita politike e shqiptarëve në Shkup me rrethinë gjatë viteve 1929- 1941 .....	50
II.4. Roli i Bashkësisë Fetare Islame 1929-1941 .....	56
<b>Kapitulli III</b>	
<b>III. Reformat agrare kolonizuese dhe pozita e shqiptarëve në Shkup me rrethinë</b> .....	
	<b>66</b>
III.1. Reformat agrare dhe kolonizuese gjatë viteve 1918-1929 .....	66
III.2. Reformat agrare dhe kolonizuese gjatë viteve 1929-1941 .....	79
III.3. Konventa jugosllavo-turke 1938 dhe dispozitat themelore të saj.....	87
<b>Kapitulli IV</b>	
<b>IV. Organizimi i jetës arsimore, fetare dhe kulturore të shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë gjatë viteve 1918-1941</b> .....	
	<b>96</b>
IV.1. Arsimi i shqiptarëve në Shkup me rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore .....	96
<b>PËRFUNDIMI</b> .....	<b>107</b>
<b>LITERATURA E SHFRYTËZUAR</b> .....	<b>121</b>

## ARSYETIMI I TEMËS

Tema e propozuar e doktoraturës “*Pozita e shqiptarëve e Shkupit me rrethinë gjatë viteve 1918-1941*”, është një përpjekje për të pasqyruar njërin nga periudhat më të vështira të shqipëtarëve në Shkup dhe rrethinë, sundimin e Mbretërisë Jugosllave.

Fatkeqësisht, Pavarësia e Shqipërisë, nuk e zgjodhi çështjen shqiptare, pasi me shumë se gjysma e trungut etnik, ngeli jashtë kufijve nën sundimin e mbretërive fqinje. Shqiptarët e Maqedonisë ndërmjet dy luftërave botërore përjetuan të “*zitë e ullirit*” thoshte profesor Masar Kodra. Politika shkombëtarizuese, Reforma agrare, shpërnguljet massive drejt Turqisë, dhuna dhe diskriminimi në të gjitha fushat e jetës janë ngjarjet që kanë përshkruar këtë periudhë. Shkupi ashtu si gjatë gjithë Rilindjes Kombëtare edhe ndërmjet dy luftërave botërore ka qenë qendra më e rëndësishme politike, ekonomike, arsimore dhe kulturore e shqiptarëve që jetonin në territoret e ish vilajetit të Kosovës. Për këtë shkak, që nga ditët e para të okupimit serb gjatë luftërave ballkanike deri në rënien e Mbretërisë së Jugosllavisë ndaj qytetit të Shkupit dhe çdo elementi shqiptar brënda dhe jashtë tij, është ushtruar presion dhe dhunë e tmerrshme.

Disa nga tematikat e kësaj teme mund të jenë trajtuar nga studiues në punime shkencore të ndryshme, por rëndësia e këtij disertacioni është trajtimi i shumë çështjeve të një periudhe të shkurtër, të një territori të caktuar brënda një teme të veçantë. Përmes shfrytëzimit të dokumentacionit dhe literaturës relevante dhe të pasur, do të sjellim fakte dhe njohuri të reja, të cilat janë një kontribut sa modest, po aq i çmuar për historiografinë shqiptare.

Rëndësi të veçantë nga të gjitha çështjet dhe problemet me të cilat janë përballur shqiptarët gjatë kësaj periudhe do t’i kushtohet politikës shtetërore të drejtuar nga qarqet serbe për spastrimin etnik të shqiptarëve nga Shkupi me rrethinë përmes Reformës agrare, marrëveshjeve për shpërngulje të muslimanëve në Turqi, dhe forma të presionit dhe dhunës sistematike nga regjimi jugosllav. Këtyre çështjeve dhe problemeve t’ju qasemi nga një këndvështrim ndryshe, gjithnjë duke u munduar që të jetë sa më objektiv dhe për këtë është munduar ta bëjë përmes faktografisë shkencore.

## **HIPOTEZAT E HULUMTIMIT**

Punimi i doktoraturës me titull *Pozita e shqiptarëve në Shkupit me rrethinë gjatë viteve 1919-1941*, në pajtim me teorinë shkencore dhe metodologjinë e punës kërkimore-shkencore, do të ketë dy hipoteza kryesore, të shoqëruara me nga dy hipoteza ndihmëse.

1. Gjendja politike dhe shoqërore e shqiptarëve të Shkupit me rrethinë pas Luftës së Parë Botërore?
  - a. Rivendosja e pushtetit ushtarako-polikor serb dhe ndarja administrative-territoriale?
  - b. Dhuna dhe presioni serb ndaj shqiptarëve në Shkup me rrethinë?
2. Gjendja shoqërore dhe ekonomike e shqiptarëve të Shkupit me rrethinë në prag të Luftës së Dytë Botërore?
  - a. Politika kolonizuese serbe dhe rezistenca shqiptare?
  - b. Pasojat dhe ndryshimet demografike në Shkup dhe rrethinë?

## **METODAT SHKENCORE TË HULUMTIMIT**

Për realizimin e suksesshëm të një punimi shkencor shfrytëzimi dhe mbështetja në metodat shkencore është jo vetëm i nevojshëm por edhe i domosdoshëm. Gjatë hartimit të këtij punimi të doktoraturës do të shfrytëzojmë disa metoda shkencore, edhe atë: Analizën (induksionin), sintezën (deduksionin), krahasimin dhe kriticizmin. Ndërsa metoda përshkruese për shkak të natyrës së punimit do të gjejë zbatim më të gjerë. Në bashkëpunim të vazhdueshëm me mentorin do të mundohemi që ky punim të jetë i mbështetur dhe hartuar sipas parimeve të metodologjisë shkencore.

## **ORGANIZIMI DHE ECURIA E HULUMTIMIT**

Disertacioni do të punohet nën përkujdesje të vazhdueshme të mentorit, duke filluar nga konstatimi i literaturës gjegjëse, leximi dhe deduktimi i çështjeve që në trajtë të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me temën, gjurmimi i literaturës në gjuhën shqipe, maqedone dhe gjuhën serbe. Pasi tema është e kufizuar në periudhë kohore (1918-1941) dhe hapësirë të caktuar gjeografike, ndarja e saj do të jetë tematike.

## PARATHËNIE

Punimi i temës së doktoraturës **“Pozita e shqipëtarëve në Shkup me rrethinë 1918-1941”** është një temë e rëndësishme për mua si punim shkencore, e cila shumë pak është e njohur në opinionin shkencor, relativisht në historiografinë tonë shqiptare.

Duke u mbështetur në materialet e hulumtuara arkivore në literaturën e botuar dhe të pabotuar, revista, gazeta, që përmes këtyre fakteve të përshkruaj pozitën e shqipëtarëve në Shkup me rrethinë gjatë viteve 1918-1941.

Duke shikuar rrethanat historike me përfundimin e Luftës së Parë Botërore, kanë ndodhur shumë padrejtësi ndaj shqiptarve në trevat lindore gjithashtu edhe në qytetin e Shkupit me rrethinë pas vendosjes së Mbretërisë Serbe Kroate dhe Slovene dhe Mbretërisë Jugosllave ku përmesregjimit ushtarako policor, dekret ligjeve, reformave agrare dhe kolonizuese, tentonin që popullatën shqiptare t’i fusin frigë, dhunë terror dhe varfëri të madhe skllavëruese si në aspektë ekonomike, politike, kulturore dhe arsimore.

Rezultatet nga kjo punë shkencore që bëra i kamë paraqitur të ndarë në disa kapituj, ku si qëllim kryesor kisha zbardhjen e veprimtarisë së këtij populli dhe plotësimin e zbrastirave, në suazat e përgjithshme të historiografisë.

Kapitulli i parë, **Pozita e shqipëtarëve në Shkup dhe rrethinë gjatë sundimit të Mbretërisë Serbe Kroate dhe Slovene (SKS)**, përmbledh disa nëntema dhe tematika të përgjithshme apo një historik të shkurtër për periudhën e viteve 1919-1929, si: Ndarja administrative dhe territoriale të shqiptarët në Shkup me rrethinë; Gjendja ekonomike e shqipëtarëve në Shkup me rrethinë; Gjendja politike e shqipëtarëve në Shkup me rrethinë gjatë viteve 1918-1929.

Në kapitullin e dytë, **Pozita e shqipëtarëve gjatë formimit të Mbretërisë Jugosllavisë- Shkupi si qendër administrative e Banovinës së Vardarit**, kam përfshirë disa nga temat me të rëndësishme dhe si i tillë ky kapitull do të paraqes edhe thelbin e studimit. Ky kapitull është i ndarë në katër nënkapituj tematikë edhe atë: Ndarja administrative dhe territoriale dhe shqiptarët në Shkup me rrethinë; Gjendja ekonomike e shqipëtarëve në Shkup me rrethinë; Pozita politike e shqipëtarëve në Shkup me rrethinë gjatë viteve 1929- 1941; Roli i Bashkësisë Fetare Islame 1929-1941.

Në kapitullin e tretë me titull **Reforma agrare e kolonizuese dhe pozita e shqiptarëve në Shkup me rrethinë**, trajtohet njëra nga temat me të ndjeshme ndërmjet dy luftërave botërore dhe roli i kësaj ngjarje në tjetërsimin dhe ndryshimin demografik të Shkupit me rrethinë, në veçanti të qytetit. Janë trajtuar tre nëntema: Dizpozitat themelore të Konventës Jugosllavo-turke; Mënyra e shpërnguljes, organizimi dhe finansimi; Shkupi si qendër për shpërnguljen e popullatës shqiptare për në Turqi.

Në kapitullin e katërt, **Organizimi i jetës arsimore, fetare dhe kulturore të shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë gjatë viteve 1918-1941**, brënda pak faqeve trajtohen dy segmente të rëndësishme të shqiptarëve në Shkup me rrethinë në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore: arsimi dhe jeta kulturore në Shkup me rrethinë.

Gjatë hartimit të kësaj teme jam mbështetur në burime arkivore dhe literature të shumta me qëllim që të ndriçoj veprimtarinë e shqiptarëve të Shkupit, dhe kjo temë është përpjekja dhe hartimi im i parë ku jam munduar të paraqes dhe plotësoj boshllëqet e këtij rajoni, që shpresoj se kam dhënë një kontribut në historinë e shqiptarëve të rajonit të Shkupit për periudhën e viteve 1918-1941.

Krejtësisht, në fund shpreh mirënjohjen e thellë për mentorin tim, Prof.dr. Nebi Dervishi, i cili përmes udhëzimeve, rekomandimeve dhe vërejtjeve të vazhdueshme kontribuoi që ky disertacion i doktoraturës të marrë këtë formë.

## HYRJJE

Në fillimin të dekadës së dytë të shekullit XX, me fillimin e luftërave ballkanike, shtetet përreth tokave të banuara me shqiptarë, të cilat dikur ishin pjesë përbërëse e Perandorisë Osmane, kishin për synim që sapo të shkatërrohet kjo perandori ato t'i fusin shqiptarët dhe trojet e tyre në përbërjen e shteteve të tyre etnike. Jorastësisht gjatë lidhjes së Aleancës Ballkanike populli shqiptar edhe pse kishte dëshirë të jetë pjesë përbërëse e saj, ai nuk u pranua me të vetmin qëllim se ishte paraparë në planet e projektet e tyre okupuese. Gjatë depërtimit në viset shqiptare ushtria e Aleancës Ballkanike kishte lënë pas vetes masakra dhe tmerr për popullatën shqiptare, e cila do të rezultojë me shpërngulje masive në drejtim të kryeqendrës së Perandorisë Osmane, Stambollit. Këtë dhunë e shfarosje Aleanca Ballkanike e justifikonte se po e luftonte dhe po e ndiqte ushtrinë osmane. Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër viset veri-lindore shqiptare iu dhanë Serbisë, me çka faktikisht kjo konference e zyrtarizoi aneksimin e këtyre viseve dhe e krijoi një shtet të cinguar shqiptar. Ndaj këtyre vendimeve dhe ndaj dhunës shqiptarët ishin përgjigjur me kryengritjen antiserbe të shtatorit të vitit 1913.

Me fillimin e Luftës Ballkanike për popujt që nuk ishin pjesë e Aleancës Ballkanike u krijua një gjendje e re politike tepër e rëndë dhe e rrezikshme. Në këto rrethana përpara prijësve të popullit shqiptar dilnin dy probleme të ngutshme: qëndrimi që duhej mbajtur ndaj konfliktit ballkanik dhe ç'duhej bërë për t'i shpëtuar trojet e banuara me shqiptarë nga rreziqet që i kanoseshin atij. Zhvillimi i shpejtë i Luftës Ballkanike dhe fitoret e saj në fushëbeteja mundësuan që Aleanca Ballkanike ta realizojë qëllimin e kahmotshëm për t'i realizuar projektet "Serbia e Madhe" dhe "Megala Idea" greke. Në këtë rast më e theksuara ishte Beteja e Kumanovës, ku ushtria osmane kapitulloi përballë ushtrisë serbe dhe i mundësoi asaj që të depërtojë në brendi të territoreve të banuara me shqiptarë.

Ushtria e aleatëve ballkanikë, gjatë okupimit të territoreve të banuara me shqiptarë, duke përdorur propagandën se "po ndjek armikun", ajo vuri në jetë planin për spastrimin etnik të këtyre territoreve. Marshimi i ushtrisë serbe dhe i çetave çetnike gjatë operacioneve luftarake në Luftën e Parë Ballkanike, edhe në viset lindore të banuara me

shqiptarë përcillej me represion, çarmatosje të shqiptarëve dhe armatosje të serbëve dhe të të krishterëve të tjerë, me shfarosje fizike, dhunime, djegie të shtëpive etj.

Muaji tetor i vitit 1912 për shqiptarët e Shkupit ishte i kobshëm. Në një rënanë atyre iu desh të përplasën me Perandorinë Osmane, ndërsa në anën tjetër ballafaquan me pushtuesit serbë. Shqiptarët e Shkupit, duke pasur mungesë armatimi dhe një ushtri të pakonsoliduar, sepse kryengritësit shqiptarë pasarritjes së marrëveshjes politike shqiptaro-osmane të 18 gushtit 1912 ishin demobilizuar dhe ishin shpërndarë nëpër krahinat e tyre, atyre iu desh të ballafaqohen me Aleancën Ballkanike, e cila përveç që dispononte me armatimin më modern të kohës, gëzonte edhe përkrahjen e Rusisë.

Pas largimit të Perandorisë Osmane nga Shkupi dhe nga Ballkani, në trojet verilindore shqiptare edhe në Shkup, në kryeqytetin e Vilajetit të Kosovës, erdhi sundimi serbosllav, i cili pas luftës së Parë Botërore do ta shndërrojë kryeqytet të Serbisë Jugore dhe, më vonë, të Banovinës Jugosllave të Vardarit.

Pas Betejës së Kumanovës, më 26 tetor 1912 ushtria serbe e pushtoi Shkupin pa luftë. Gjatë rrugëtimit saj për në Shkup, ajo vrau e masakroi pa mëshirë disa mijëra shqiptarë të pafajshëm. Atë ditë, pas rënies së Shkupit, ushtria serbe i kapi të gjallë 13 krerë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Komanda Supreme serbe në një njoftim të saj thekson se në afërsi të Shkupit ishin zënë rob prijësit shqiptarë dhe ishin deportuar në drejtim të Beogradit, si: Hasan Bej Prishtina dhe Said Efendi Hoxha nga Shkupi. Që të dy, sipas këtij raporti, ishin deputetë të parlamentit të Stambollit dhe nacionalistë të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Në këtë raport Hasan Prishtina vlerësohej si intelektual dhe fanatik i madh për çështjen shqiptare.

Me vendosjen e Komandës III Serbe në Shkup, do të fillonin edhe vrasjet, dhunimet, torturimet dhe djegiet e fshatrave dhe lagjeve shqiptare të Shkupit dhe rrethinës. Të gjitha këto veprime të ushtrisë serbe do t'i përshkruante deri edhe në detaje Leon Trocki, i cili flet për veprimet e devijuesve të shteteve ballkanike ndaj popullatës së pafajshme shqiptare gjatë viteve 1912-1913, sepse shteti dhe qeveria djathtë e Dumës Ruse atëbotë i heshte këto krime të kryera nga aleatët e saj sllavistë në Gadishullin Ballkanik ndaj trevave shqiptare. Ndërkaq gazetari austriak Leo Frojdli, në librin "Golgotha Shqiptare", përshkruan masakrat e serbëve në vjeshtën e vitit 1912 deri në pranverën e 1913-tës, në trojet shqiptare, Kosovë e Maqedoni.



Përveç kësaj, Komanda III Serbe me seli në Shkup do të angazhojë arkitektë, nga të cilët do të kërkojë të hartojnë një plan urbanistik për qytetin e Shkupit. Ky plan iu besua arkitektit Dimitrije Leka, i cili u miratua dhe kishte për synim t'u përshtatet synimeve të okupatorit për ta ndryshuar pamjen ekëtij qyteti. Por, ky projekt urbanistik nuk mundi të vihej në funksion, sepse shumë shpejt filloi Lufta e Parë Botërore, andaj fill pas përfundimit të Luftës ky projekt famëkeq menjëherë u vë në funksion. Ky projekt mëtohej të realizohej mbi vakëfin, xhamitë, teqetë, varrezat dhe objektet tjera që ishin nënpronësi të Bashkësisë Fetare Islame.

Me vendimet e padrejta nga ana e Fuqive të Mëdha në Konferencën e Paqes në Londër, si dhe Marrëveshjen e Bukureshtit, Mbretëria e Serbisë, arriti ta dyfishoj territorin e sajë. Në mbështetje të burimeve të kohës, qartë shihet se shumica e popullsisë në këto territore ishte shqiptare, ndërsa popullsia serbe përbëhej nga një pakicë e parëndësishme. Përbërja etnike, nuk mund të fshihej as nga administrata e atëhershme ushtarak-police serbe, e cila u vendos menjëherë pas pushtimit të këtyre viseve. Në raportet e tyre, shihet qartë se në qarkun e Tetovës, Kumanovës, Kërçovës, Ohrit, Strugës, Dibrës, pastaj mbarë territori i sotëm i Kosovës, Sanxhaku etj, shqiptarët përbënin numrin më të madh të popullsisë, të cilët asnjëherë nuk do të pajtohen të ngelin nën robërinë serbe.

Me fillimin e Luftës së Parë Botërore 1914, gjithashtu në vitin 1915, Bullgaria si aleate e paktit të Forcave Qendrore, iu mundësua që ta vë në funksion Traktatin e Shën Stefanit, me ç'rast në mesin e shumë qyteteve me popullsi shqiptare nën okupimin bullgar u përfshi edhe qyteti i Shkupit.

Nuk ngelej prapa as propaganda sllave, e cila shfrytëzonte të gjithë mënyrat e mashtrimit propagandistik të kohës, për riinstalimin e sundimit serbomadh në trojet shqiptarë. Kështu, pas 29 shtatorit 1918 komandantit të avacionit serb i jepen 5000 fletushka, në gjuhën turke të cilat u dedikoheshin kryesisht popullatës shqiptare. Me anën e këtyre proklamatave shqiptarët thirreshin që të ngrihen kundër administratës politiko-ushtarake bullgare, gjermane dhe austro-hungareze, duke rikujtuar krimet bullgare gjatë sundimit të tyre, duke premtuar “miqësi të sërishme”, nëse i ruajnë serbët që të mos

largohen nga shtëpitë e tyre. Një pjesë e këtyre proklamatave u hodhën edhe në qytetin e Shkupit dhe rrethinën e tij.

Avancimi i forcave të Antantës (pas thyerjes së Frontit të Selanikut) i mundësoi ushtrisë serbe të rivendoste kontrollin policor – ushtarak mbi këto treva. Pra, edhe qyteti i Tetovës me rrethinë hyri në një sundim tëri të shtetit të sapo krijuar, Mbretërisë Sërbo Kroato Sllovene (SKS), ku mbisundonte hegjemonia e vjetër borgjeze serbo-sllave. Një rol të madhë në avancimin dhe hyrjen e shpejtë të forcave serbe në trojet shqiptare dhe në veçanti në fushën e Pollogut (Tetovë – Gostivar), ka luajtur elementi pro serb vendas (përfshi këtu edhe shqipfolës) dhe njësi speciale, të cilat si model funksionimi dhe organizimi kishin çetat çetnike serbegjatë luftime ballkanike (1912-1913) dhe qëmbështeteshin me logjistikë ushtarake dhe me vullnetar jo vetëm nga kolonizatorët serbtë vendosur në këto vende, por edhe nga popullata sllavo-maqedonase.

Lufta e Parë Botërore i solli vuajtje të reja popullit shqiptar kudo ku banonte, duke i shkaktuar humbje të mëdha njerëzore dhe ekonomike, pasi pjesamë e madhe e veprimtarisë luftarake u zhvillua në tokën shqiptare, ku u stacionuan mbi gjysëm milioni ushtar nga të dy palët ndërluftuese. Më shumë pësuan shqiptarët që jetonin nën sundimin bullgar (1915-1918), ku bullgarët plaçkitën gjithçka që mund të merrej dhe të dërgohej në vendin e tyre, bile edhe farën e bukës. Serbisë si aleate e Antantës iu mundësua që të jetë edhe bërthama e Mbretërisë së SKS-së, e cila si aleate e atyre që e kishin fituar luftën, i mundësuan që të zgjerohet territorialisht, duke okupuar trevat veri-lindore të banuara me shqiptarë, në mesin e tyre edhe krahinën e Shkupit.

Shteti i ri i dominuar nga borgjezia serbe nuk do ta njohë kombin shqiptar, edhe pse kishte nënshkruar shumë marrëveshje ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të pakicave. Ajo kishte për synim të bënte spastrimin etnik të shqiptarëve nga trojet e tyre etnike. Andaj, duke e ndjerë këtë rrezik, shqiptarët u desh të shfrytëzojnë disa liri që i mundësonte ligji, ashtu që e vetmja shpresë ishte organizimi nën ombrellën e fesë islame për të siguruar kështu mbijetesë në trojet e tyre etnike në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore.

Përsikaj pasojave të rënda në sferën ekonomike, pas përfundimit të Luftës, rrethanat historike për formimin e Mbretërisë së Serbëve Kroatëve dhe Sllovenëve ishin bërë të përshtatshme, kjo për shkak të pjesëmarrjes së Serbisë në Luftën e Parë Botërore

në krahun e Antantës, si dhe për shkak të lidhjeve tradicionale me disa shtete evropiane (Francën, Britaninë e Madhe, Rusinë, etj). Mbretëria SKS ishte përcjellëse e politikës ruse në Ballkan, andaj edhe e siguroi përkrahjen e sajë Krijimi i projektit Serbia e Madhe, ishte në korrelacion me rritjen e ndikimit të politikës ruse në Ballkan. Kjo politikë i ndihmoi Nikolla Pashiqit, që ta forcojë dhe realizojë idenë serbomadheë. Kjo mundësoi që Mbretëria SKS në Ballkan të paraqitet si fuqi dominuese në raport me fqinjët, gjë që i mundësoi asaj të ketë stabilitet politik dhe të shprehë apetite për zgjerim territorialë

Në anën tjetër, Fuqitë e Mëdha, përmes Mbretërisë SKS, dëshironin ta forcojnë dominimin e tyre në Ballkan. Në bazë të të gjitha kriterëve, si kriteri historik, tradicional politik, në bazë të standardit politiko-ekonomik, sistemit legal, fesë dhe kulturës, Mbretëria SKS ishte më e komplikuar nga shtetet e reja të Evropës Lindore dhe Qendrore në periudhën në mes dy luftërave botëroreë Ajo ishte e përbërë nga një numër i madh i njësive territoriale dhe popujve prej para vitit 1918. Nga gjysma austro-hungareze e ish perandorisë së Habsburgëve, Mbretëria SKS e trashëgoi Sllavinë dhe Dalmacinë, Kroacinë, Slloveninë, rajonin e Vojvodinës dhe provincën e Bosnjë-Hercegovinës, ndërsa pjesën e Maqedonisë së sotme, Kosovën e Sanxhakun i trashëgoi nga Perandoria Osmane. Themelimi i Mbretërisë SKS dhe veçanërisht pozita e saj e favorshme në marrëdhëniet ndërkombëtare, i kishte disa përparësi menjëherë pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Me një politikë të tillë, Mbretëria SKS 1918-1929, u shëndrua në burg të vërtetë të popujve, në veçanti të popullit shqiptar, duke vepruar padrejtësisht ndaj shqipëtarëve të Shkupit si në aspekt politik, ekonomik, administrativ dhe ushtarak duke ua mohuar të drejtat e tyre, kjo politik ka vazhduar edhe pas Diktaturës së 6-të Janarit. Atëhere Mbretëria e SKS-së, e ndërroi emrin në Mbretëri Jugosllave, ndërsa territori i saj, u nda në njësi të reja administrative e territoriale, në banovina, në krye nga një Banin nga viti 1929-1941 u krijuan shumë dekret ligje dhe u përpiluan platforma institucionale ku për mes reformave agrare e kolonizuese do të bëhet shpërngulja e popullatës shqiptare të Shkupit me rrethinë gjithashtu u hapën edhe shkolla në gjuhën serbe që të bëhet asimilimi dhe shkombëtarizimi i popullatës shqiptare.

## Kapitulli I

### I. Pozita e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë gjatë sundimit të Mbretërisë Serbe Kroate dhe Sllovene (SKS) 1918-1929

#### I.1. Ndarja administrative dhe territoriale të shqiptarët në Shkup me rrethinë

Në vendet shqiptare, të cilët u ripushtuan nga forcat serbe, gjatë vitit 1918, u rikonstruua administrata civilo-ushtarake serbe (e Mbretërisë SKS), e cila funksiononte në bazë të dy akteve të para (urdhëresave) dhe dekretit të mbretit serb, dhe atë:

- a. Rregullores së përkohshme për rregullimin e pushteteve të varura në rajonet e ripushtuara” e datës 14 dhjetor 1912;
- b. Rregullores së re për rajonet e çliruara, të datës 18 gusht 1913, dhe
- c. Dekretin e mbretit të Serbisë, të datës 20 dhjetor 1913

Sipas këtij dekreti territori i Maqedonisë së sotme që hynte në përbërje të Mbretërisë së Serbisë trajtohej si “Serbia e Vjetër” dhe kishte këtë ndarje administrative – territoriale: Qarku i Shkupit, i Tetovës, i Tikveshit, Kumanovës, Bregallnicës, Manastirit dhe Ohrit. Kjo ndarje administrative me ndryshime të vogla u ruajt edhe pas vitit 1918. Në krye të qarqeve dhe rretheve shumicën, dërmuese të administratorëve dhe udhëheqësve politiko-ushtarak e përbënte kuadri serbo-kolonial i ardhur nga Serbia, çetnikët e saj, por edhe elementi lojal vendas, që kish kontribuar përrikthimin e administratës borgjeze serbe.<sup>1</sup>

Pas stabilizimit të gjendjes dhe shtypjes së revoltave masive të popullatës shqiptare anekand territorit, komanda ushtarake e Armatës së III-të dha pëlqimin për ndarjen e territorit në krahina. Kështu, në 1 nëntor të vitit 1919, territori i “Serbisë së Vjetër” (Serbisë së jugut) u nda në tre krahina, përkatësisht në tre divizione ushtarake: të

---

<sup>1</sup>Петар Стојанов, *Македонија времето на балканските и Правата Светска Војна (1912-1918)*, Скопје, 1969, 136; Bogomil Hrabrak, *Stanje u Vardarskoj Makedoniji u Jesen i zimu 1918*,”Istoriski Glasnik”, 1966, 27.

Kosovës, Manastirit dhe Vardarit. Kjo ndarje administrative – territorial qëndroj në fuqi për një vit e gjysëm, deri në 28 qershor 1921, kur u miratua Kushtetuta e Vidovdanit. Sipas kësaj Kushtetute Maqedonia e Vardarit ndahej në 7 qarqe.<sup>2</sup>

Shtabi krahinor i divizionit të Vardarit ndodhej në Shkup. Në këtë gjendje, rendin dhe qetësinë publike e rregullonte xhandarmëria serbe më ndihmën e pushtetit policor, kurse në raste të veçanta inkuadrohej edhe ushtria serbe, e cila shtypte me agresivitet ç‘do revolt kryengritje të armatosur nga popullata shqiptare. Kjo ndarje administrative–territoriale qëndroj në fuqi deri në 3 tetor të vitit 1929, përkatësisht deri në miratimin e ligjit për ndarjen e shtetit në Banovina.<sup>3</sup>

Pozita e vështirë e shqiptëtarve në trevat lindore posaçërisht në Shkup me rrethinë u paraqit me krijimin e Mbretërisë Serbe Kroate dhe Sllovene më 1 dhjetor 1918, ku do të vendosë ndarjen e re administrative territoriale që synonte ti mbante ato të coptuara dhe të përçarë popullin shqiptar. Në bazë të dekretligjit për ndarjen territoriale dhe ushtarake më 19 gusht 1919, Komanda e Krahinës së Armatës së Tretë dha pëlqimin për ndarjen territoriale të Krahinave. Më 1 nëntor 1919 territori i Sërbisë së Vjetër ose Sërbisë Jugore, të ndahen në këto tri krahina, përkatësisht divizione ushtarake: të Kosovës, të Vardarit dhe Manastirit. Ndërkaq me kushtetutën e Vidovdanit (28 qershor 1921), Maqedonia e Vardarit ndahet në shtatë qarqe.<sup>4</sup>

Shkupi u bë qendër e zonës së tretë të Armatave serbe (e më vonë Jugosllave), një prej katër zonave ushtarake të Shtetit Serbo-Kroat-Slloven (SKS).<sup>5</sup>

Krahas ndarjes ushtarake kishte edhe një ndarje toksore-administrative sipas regjimentit të postkomandave të xhandarshmërisë. Ndarja toksore-ushtarake e vendosur me dekretligjin e regjentit Aleksandër, 19 gusht 1919, me pak ndryshime mbeti deri në vitin 1929. Shkupi ishte qendër e Zonës së tretë ushtarake e shtetit SKS, sipas kësaj ndarjeje i takonin tokat e Kosovës dhe viset shqiptare rreth saj, të cilat ishin të ndara në qarqe të regjimenteve ushtarake. Ndarja e re në krahina, e cila u fut me projektligjin e 5 nëntorit të vitit 1921, dhe u bë me dekretligjin e 22 prillit 1922, ku parashikohej formimi i

<sup>2</sup> Marija Jovanović, *Prosvetno – politički priliki vo Vardarska Makedonija (1918-1929)*, Shkup, 1983, 38.

<sup>3</sup> Almanah Kralevine „SKS, për vitet 1921 – 1922, Beograd, pa vit botimi, 17-35.

<sup>4</sup> Марија Јовановиќ, *Просветно-политичките прилики во Вардарска Македонија 1918-1929*, Скопје, 1983, 39.

<sup>5</sup> Јевте Николиќа, *Управа пре ослобођења*, Спомени, Скопје, 1937, 985.

33 krahinave<sup>6</sup>, si njësi toksore administrative. Por edhe pas shpalljes së dekretligjit , për zbatimin në praktikë të kësaj ndarjeje u deshën 3-4 vite. Ky riorganizim i njërive toksore u bë meqenëse qarqet, duke qenë njësi tepër të mëdha, mund të ktheheshin në vatra të qëndresës së shqiptarëve kundër pushtetit serb.

Në vitet 1921 krahina e Shkupit me qendër në Shkup përfshinte këto rrethe: Rostushën, Tetovën, Gostivarin, Kaçanikun, Shkupin, Ohrin dhe Kumanovën. Popullsia e krahinës së Shkupit ishte shqiptare, maqedone dhe shumë pak serbe. Në krye të krahinave qëndronin zhupanët, kurse në krye të rrethëve qëndronin naçallnikët. Organet nëpërmjet të cilëve Ministria e Punëve të Brendshme i realizonte vendimet e veta ishin Prefekti i rrethit –naçallniku, të cilët kishin në disponim një numër nëpunësish, agjente dhe xhandarë.<sup>7</sup>

Ndarja e trefishtë ushtarake-policore-civile, si dhe caktimi i kufijve vëndohej në atë pjesë ku popullsia e tyre ishte etnikisht e përzier, kishin për qëllim t’u mohoeshin të drejtat kombëtare shqiptarëve, që shiheshin etnikisht “si të huaj”, të dobsohej bashkimi e qëndresa e popullit shqiptar dhe të lehtësohej serbizimi i këtyre trevave. Për këtë punoni edhe organet vendore, të cilat nëpërmjet shpërnguljes së shqiptarëve e kolonizimit të brendshëm, bënë lëvizjen e rishpërndarjen e popullsisë sllave brenda përbrena krahinës, pra sillnin popullsi serbe dhe i vëndonin në viset shqiptare.<sup>8</sup>

Sipas hierarkisë qeverisëse, krahina e Maqedonisë së Vardarit në krye kishte Zhupanin e Madh, i cili emërohej në mënyrë të drejtpërdrejtë nga mbreti. Zhupani përmes organeve shtetërore qeveriste me të gjitha punët administrative në krahinë. Sipas nenit 98 të kësaj kushtetute, organet e tjera administrative të krahinës ishin: Kuvendi krahinor dhe këshilli krahinor. Ndërsa neni 135 parashihte që qarqet si njësi administrative shtetërore të mbesin përderisa këto nuk hiqen me ligj. Kushtetuta e Vidovdanit nuk dha zgjidhje definitive në lidhje me ndarjen e vendit në krahina. Por, një ndarje e tillë do të bëhej më vonë me anë të legjislaturës së rëndomtë. Mirëpo, autonomia e krahinave ka ekzistuar nominalisht nga vitit 1921 deri 1925.<sup>9</sup>

---

<sup>6</sup> Po aty, 986.

<sup>7</sup> Almanah Krlevine SKS, Beograd, 1927-1928, 39.

<sup>8</sup> Merenglen Verli, *Reformat agrare kolonizuese në Kosovë (1918-1941)*, Tiranë, 1992, 55-56.

<sup>9</sup> Limon Rushiti, *Rregullii administrative i Kosovës (1918-1929)*, në “Përparimi”, Prishtinë, 1976, 256.

Sipas Kushtetutes së Vidovdanit dhe ligjeve-dispozitive në fuqi, veçanërishtë ligjit për administratën e përgjithshme krahinore dhe të rrethit (26 prill 1922), për rrethet thuhet: Rrethet janë persona juridik sinë bazë të së drejtës publike, po ashtu edhe në bazë të së drejtës private, dhe se kanë kompetenca autonome. Disponojnë me financat e tyre, të cilat në bazë të ligjit i jepen rrethit për t'i mbuluar shpenzimet e administratës dhe për përparimin e bujqësisë në rreth.

Administrimi i pronave të rrethit, enteve, si dhe përkujdesja ndaj shtresave në nevojë (të varfërve), të sëmurëve, zejtarëve, punëtorëve të punësuar në industritë, është detyrë e drejtpërdrejtë e administratës së rrethit.<sup>10</sup>

Ky ligj parashihte edhe organet e zgjedhura me votë, të cilët ishin: Kuvendi i rrethit dhe Këshilli i rrethit. Kuvendi i rrethit zgjidhje me votim të përgjithshëm, të "barabartë", "të fshehtë" dhe të dretpërdrejtë me mandat katër vjeçar. Zgjedhjet bëheshin në bazë të listave të njëjta sipas të cilave bëhej zgjedhja për Kuvendin krahinor. Llogaritej qënëçdo 1500 banorë të zgjidhej një përfaqësues në Kuvendin e rrethit. Numrin e anëtarëve e caktonte për çdo zgjedhje gjykata administrative, në afat prej tetë ditësh, pas shpalljes së zgjedhjeve. Për anëtar të Kuvendit të rrethit mund të zgjidheshin vetëm personat që i plotësonin kushtet për deputet popullorë sipas nenit 72 të Kushtetutës së Vidovdanit. Këshilli i rrethit përbëhej nga kryetari dhe anëtarët. Kryetari i Kuvendit të rrethit njëkohësishtë ishte edhe kryetar i Këshillit të rrethit. Këshilli merrte vendime në mbledhjet e veta, në prani të 3 anëtarëve, kurse vendimet mirreshin me shumicë absolute të votuesve. Ky këshill ishte një mini ekzekutiv që zbatonte vendimet e Kuvendit të rrethit; mbikqyrte funksionimin e administratës; mbante disiplinën mbi organet e veta, etj.<sup>11</sup>

Sipas nenit 98, të kësaj Kushtetute organet Administrative të krahinës janë: Kuvendi Krahinor dhe Këshilli Krahinor, ndërkaq neni 135 parashihte që qarqet si njësi administrative shtetërore të ngelin, përderisa këto nuk hiqen me ligj. Kushtetuta e Vidovdanit nuk dha zgjidhje definitive në lidhje me ndarjen e vendit në krahina. Por, një

---

<sup>10</sup> Almanah Krlevine SKS, 1927-1928, 39.

<sup>11</sup> Almanah Krlevine SKS, 1927-1928, 36.

ndarje e tillë do të bëhej më vonë me ane të legjislaturës së rëndomtë. Mirëpo, autonomia e krahinave ka egzistuar normalisht nga viti 1921- 1925.<sup>12</sup>

Fillet e organizimit të sistemit gjyqësor nën pushtetin e Mbretërisë së Serbisë, i gjejmë me rregulloren e 17 shkurtit 1914 për rregullimin e gjyqeve dhe procedurave gjyqësore. Për këto treva të aneksuara, në shkallën e gjykatës së apelit ekzistonte i ashtuquajti “Veliki Sud” (Gjyqi i Madh), me qendër në Shkup. Ai përbëhej nga kryetari i gjyqit, katër gjyqtar, sekretari dhe nëpunësit e administratës.

Me të njëjtën rregullore në krahinat e aneksuara nga Serbia ishin formuar nëçdo rreth nga një gjykatë e rrethit, ku duhej të kishte të punësuar më së paku nga dy gjyqtar, ndërsa sipas nevojës edhe tre apo më tepër gjyqtar. Gjyqi mundej por nuk e kishte patjetër të ketë kryetar të gjyqit. Çdo gjykatë e rrethit kishte nga një sekretar. Organizimii gjykatave, pas bashkimit të serbëve, kroatëve dhe sllovenëve në Mbretërinë SKS (1 dhjetor 1918), nuk ishte i unifikuar kunë të gjithë krahinat deri në vitin 1929 vlenin ligjet dhe organizimi i gjyqeve, të cilat ishin në fuqi deri në krijimin e kësaj mbretërie.<sup>13</sup>

Mbretëria SKS ka qenë burgu i popujve në kuptimin e plotë të fjalës, ku pozita kryesore kanë qenë kryesishtë në duart e elementeve më reaksionarë serbomadhi, e cila ka shtrembëruar mentalitetin shqiptar me qëllim që të krijohet një opinion publik se ato janë të rrezikshëm për unitetin territorial të këtij shteti.<sup>14</sup>

Vetë përfaqësuesi i borgjezisë serbe Punisha Raçiq, shkruan se nëpunësit dhe sekretarët e komunave poplaçkisin popullsinë, përfaqësuesit e komunave janë njerëz të paaftë, xhandarët të ndarë nëpër stacionet e xhandarmërisë, më shumë i bëjnë dëm se sa i sjellin shtetit autoritet dhe dobi, ruajtësit e tyre janë element për të krijuar pakënaqësitë me veprimet e tyre, ndërsa organet policore, me ndihmën e sekretarëve të komunave thurin intriga të ndryshme, duke bërë shantazhe ndaj njerëzve.<sup>15</sup>

---

<sup>12</sup> Limon Rushiti, *Regullimi administrativ i Kosovës 1918-1929*, 256.

<sup>13</sup> Çlirim Dervishi, *Fushëgropa e Ohrit në vitet 1918- 1941*, gusht, 2011 (temë magjistrature), 76-77.

<sup>14</sup> Ali Hadri, *LNC*, në Kosovë 1941-1945,, Prishtinë, 1971, 26.

<sup>15</sup> Sarac Nedim, *Politicka istorija naroda 1878 – 1945*, Sarajevo, 1967, 241.



## I.2. Gjendja ekonomike e shqiptarëve në Shkup me rrethinë

Të gjitha viset e Shtetit SKS nuk kishin zhvillim të njëjtë ekonomik, Shkupi si qendër e Zonës së III-të ushtarake ishte vend i prapambetur në pikpamje ekonomike, me industri të pazhvilluar, ishte me karakter agrar bujqësor, me një teknikë mjaftë të vjetëruar agrare. Kjo është si pasojë jo vetëm e politikës së padrejtë serbe por edhe prapambetjes ekonomike të trashëguar nga sundimi osman, Luftrave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore.<sup>16</sup>

Borgjezia serbe nuk ishte e interesuar për zhvillimin e industrisë kapitaliste.<sup>17</sup> Politika kolonizuese që ndërmoren në tokat shqiptare pushtetëmbajtësit serbe të Beogradit në periudhën midis dy luftrave botërore, sikurse tregojnë të dhënat, pati pasoja të rënda për popullsinë shqiptare në përgjithësi e sidomos në qytetin Shkupit dhe periferinë e saj. Shqiptarët e Shkupit u shpronësuan në masë dhe u varfëruan si kurrë ndonjëherë më parë. Dhjetra e mijëra familje shqiptare u detyruan të shpërnguleshin nga qyteti i Shkupit dhe priferisë së saj, për ti hapur vend kolonistëve serb, etnikisht të huaj, kurse ekonomia pësoi një goditje me rrjedhime të këqija dhe afatgjate.<sup>18</sup>

Me një politikë të tillë, Mbretëria SKS 1918-1929, u shëndrua në burg të vërtetë të popujve, në veçanti të popullit shqiptar. Format dhe metodat e shtypjes dhe të skllavërimit ishin koloniale, ndërsa urrejtja, vjedhja dhe konfiskimi u shëndrua në dukuri të përditshme. Me akte dhe dekrete të veçanta mohonte dhe zhdukte të drejtat elementare dhe individuale të shqiptarëve. Mbretëria SKS, i emëronte shqiptarët si popull i egër. Dhuna dhe terrori i përditshëm i detyruan shqiptarët të shpërngulen në mënyrë masive dhe ti lishojnë vendet e tyre shekullore, të lodhur nga plaçkitjet dhe metodat e egra që përdornin e që nxitin vetëm urrejtje. Shumë tregtarë dhe zejtarë të imët ndajnë ditët në trotuaret e qytetit duke pritur punë dhe mezi sigurojnë të ardhurat për një bukë. Ka zejtarë që nuk fitojnë më shumë se 10 denarë në ditë.<sup>19</sup>

---

<sup>16</sup> Јанка Вукичевица, *Приведа Јужне Срвије*, 523.

<sup>17</sup> Ali Hadri, *LNÇ në Kosovë (1941-1945)*, Prishtinë, 1971, 16.

<sup>18</sup> Marenglen Verli, *Politika e kolonizimit sllav te trevave shqiptare në periudhën midis dy luftrave botërore (1918-1941)*, në: Shqiptarët e Maqedonisë, Shkup, 1994, 357.

<sup>19</sup> Marenglen Verli, *Reformat agrare kolonizuese në Kosovë 1918-1941*, 29.

Gjatë viteve 1918-1929, pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare të Shkupit jetonin në fshat. Fshatarët merreshin me bujqësi dhe me blektori, në viset ku nuk kishte arritur të zbatohet reforma agrare, në tokat që nuk kishin kualitete pjellore. Në Shkup veprimtari kryesor ekonomik ishte bujqësia dhe blektoria (bujqësia që ajo që e formoi pjesën më të madhe të të ardhurave kombëtare dhe në të cilën gjente egzistenë 75% të popullatës në rrethin e Shkupit), marrëdhëniet prodhuese, produktiviteti dhe veglat e punës nuk ishin kudo të njëjta, 80 % e popullsisë ishin fshatarë. Kjo popullsi pas vitit 1918, nuk pati mundësi të merret me prodhimtari të caktuar të mallit, sepse prodhimtaria në masë të madhe kishte karakter prodhues konsumues. Pjesa tjetër e popullsisë që jetonte në qytet, merrej me zejtari si vorbëtar-poçarë, kujunxhi, bukëpjekës, këpuctarë, dhe disa inkuadroheshin në disa objekte të vogla ekonomike të ndërtimit si muratorë, marangozëve, gurgdhendës, drugdhendës, etj. Borgjezia serbe gjithmonë i ka shikuar interesat e veta të ngushta për fitim, prandaj në asnjë mënyrë nuk që e interesuar për të ndihmuar zhvillimin ekonomik të vendit.<sup>20</sup>

Kurse prej rajoneve Banoines së Vardarit, me të kolonizuar që qyteti i Shkupit dhe rrethi i saj, me këto fshatra: Mirkovci, Lubanci, Poboze, Kuçevisht, Rashtak, Bollaçan, Çreshevo, Orman, Ajvatovci, Marshevc, Çolija etj.<sup>21</sup>

Në Shkup dhe rajonettjera përreth, zejtaria ishte degë e rëndësishme e ekonomisë. Që në vitin 1913, në Shkup, Mbretëria e Sërbisë kishte themeluar Inspektoratin tregtar, përmes së cilës në mënyrë të regullt do të lajmëroheshin për çmimet në tregun botëror dhe mundësohet që prodhimet e tyre ti dërgojnë për ti shitur me qmime më të larta. Në qytetin e Shkupit ra në mënyrë të ndjeshme zejtaria dhe tregtia si rezultat i humbjeve të tregjeve fqinje, sepse qeveria e Beogradit me urdhrin e ministrisë së ekonomisë e ndaloi tregun me Selanikun (që merreshin me shitblerje), prej nga furnizoheshin me mallra të ardhur nga Evropa Perëndimore.

Zejtarët gjatë periudhës së Mbretërisë SKS, punonin me mjete primitive dhe nuk mund të konkuronin punëtorive të mëdha që punonin me mjete më të mira - perfeksionuara dhe me shumicë. Konkurenca e tyre i detyronte zejtarët të hyjnë në radhët e proletarëve. Puna e zejtarëve si e tillë që primitive, që patjetër duhej të bjerë.

---

<sup>20</sup> *Historia e popullit maqedonas*, Shkup, 1983, 227.

<sup>21</sup> *История на македонскиот народ*, Скопје, 1972, 235.

Tregtarët gjatë situatave të turbullta ritnin çmimet e artikujve të domosdoshme. Tregtarët spekulues me produktet e drithrave dhe prodhimeve tjera mbisundonin në tregje. Çmimet e artikujve ushqimorë ishin në këto shënime të tregtarëve për prodhimet e caktuara konsumatore. Shtrejtimi i artikujve ushqimorë më së shumti i prekte masat e gjëra popullore gjegjësisht, fshatarët, punëtorët e thjeshtë, peshkatarët, zejtarët e thjeshtë. Maqedonia pas Luftës së Parë Botërore, nuk kishte të zhvilluar ekonominë por duhej një kohë e gjatë për ta ringjall ekonominë e këtij vendi. Mandej me politikën ekspansioniste që e zbatonte Qeveria me ndihmën e të gjithë ministrive shtetërore, qenë të orientuar në pasurimin e tyre. Banorët e Shkupit nisën prodhimtarinë e tyre duke qenë të pafuqishëm dhe duke qenë në mungesë të lëndës së parë dhe tregut ku do ti shisnin prodhimet e tyre. Pra në vitet e para pas luftës secili luftonte vetëm që të sigurojë bukën e gojës për familjen. Tek zejtarët mungonte lënda e parë, për punë të përhershme. Fitimi ditor i zejtarëve, në vitin 1920 ishte 15 deri në 20 denarë dhe këpuctarët që fitonin 40 deri në 50 denarë në ditë.<sup>22</sup>

Për këtë, tregon edhe revista “*Занатлија*” në vitin 1924 publikon se se zejeve në Maqedoni nuk i kushtohet rëndësi dhe se nga ndihma që duhej të shpërndahej zejtarëve të varfër në provinca pas luftës, që me kohë u kujdesën mjeshtrit më të pasur nga rajoni i Beogradit, me miqësi e proteksion të marrin sa më shumë, duke i lënë në këtë mënyrë zejtarët e tjerë me duar bosh, sikur ato të mos jenë bijtë e këtij shteti.<sup>23</sup>

Njëra nga shkaqet që Shkupi mbet me një ekonomi të pazhvilluar, sepse rrezikoheshin nga konkurenca e prodhimeve industriale që vinin nga popujt tjerë të Mbretërisë SKS, që ishin me nivele më të larta zhvillimi. Nga zejtarët vendas filloi të humbë veprimtaria orientale dhe të riorientohen sipas mënyrës sllave. Në Maqedoni përvoja historike e shqiptarëve ishte e njëtrjatshe. Gjatë gjithë kohës ata kanë qenë të përjashtuar nga rrjedhat ekonomike si kolektivitet.<sup>24</sup>

---

<sup>22</sup>Милана Чемериќича, *Трговина, Занатство, Индустија, Кредитне Установе од 1875-1937*, 709-712.

<sup>23</sup>Стефан Фртулиќ, *Тежак живот занатлија Јужне Србије*, në: “Занатлија”, г. IV, бр. 3, Београд, 1924, 1-2.

<sup>24</sup> Gazmend Kadiu, *Rrjedhat ekonomike te shqiptarët e Maqedonisë*, në: Shqiptarët e Maqedonisë, Shkup, 1994, 602.

### **I.3 Gjendja politike e shqiptarëve dhe aktiviteti politik i Xhemijetit në Shkup me rrethinë gjatë viteve 1918-1929**

Gjendja politike e shqiptarëve te Shkupit në këtë kohë (1918-1929) ishte shumë e vështirë. Partitë dhe organizatat politike zhvillnin luftë politike njëra me tjetrën e sidomos Dinastia e Karagjergjoviqëve nëpërmjet Partisë Radikale, luftonte me tërë qenien e vet për të dominuar në mbarë jetën ekonomike dhe politike brenda shtetit. Pas Luftës së Parë Botërore, veprimtaria e partive politike serbe ka qenë shumë e gjerë, sidomos deri në vitin 1929. Popujt që nuk ishin konstitutiv në shtet, duhej të gjenin forma për formimin e partive politike, që të mund lirisht të marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare, që të përgatiten drejt zgjidhjes së çështjeve të tyre nacionale dhe fetare, por edhe ta shfrytëzojnë partinë si instrument për ndryshime në jetën shoqërore.<sup>25</sup>

Me formimin e Mbretërisë SKS, përkaj partive të lartpërmendura politike, u themeluan edhe disa parti qytetare, parti nacionale, parti me orientime fetare, por edhe parti me orientime ideologjike djathtiste dhe majtiste. Në partitë dhe organizatat politike, ndikim të madh kishin liderët e tyre, të cilët ishin dominues, dhe e diktonin orientimin politik. Në Mbretërinë SKS nuk ishin rregulluar të drejtat e pakicave kombëtare: rregullimi i çështjeve sociale, fetare dhe nacionale. Këto tre çështje e karakterizojnë jetën politike në Mbretërinë SKS.<sup>26</sup>

Në trevat shqiptare të ngelura në Mbretërinë SKS, vepronin dy parti më të mëdha politike: Partia Radikale dhe Partia Demokratike, të cilat pa pengesa e praktikonin pushtetin shtetëror dhe vendimet e tyre u shndërruan në politikë shtetërore. Qeverisja e dy partive politike ishte e pakufizuar dhe nën ndikimin e tyre ishte i gjithë aparati shtetëror. Dy partitë politike dëshironin që në radhët e tyre të përfitonin numër sa më të madh të popullatës, pa dallim nga orientimi i tyre politik, ideologjik apo fetar. Organizata politike e myslimanëve Xhemijeti, ishte përkrahur nga Partia Radikale, e cila përmes saj e shfrytëzoi mundësinë për ta kontrolluar popullatën myslimane dhe për t'i shërbyer asaj në

---

<sup>25</sup> Надежда Цветковска, *Политичките партии во парламентарните изборни борби во вардарскиот дел на Македонија (1919 – 1929)*, Скопје, 2004, 20.

<sup>26</sup> Skender Asani, *Veprimtaria e Organizatës Politike Xhemijeti në Trevat Lindore (1919 – 1925)*, Shkup, 2017, 40-41.

momente të caktuara politike, siç ishte ndërprerja e hovit të Partisë Komuniste.<sup>27</sup>

Organizimi politik i myslimanëve në trevat lindore, më tepër ishte iniciuar nga interesat e bejlerëve dhe agallarëve, të cilët në periudhën e Perandorisë Osmane ishin të privilegjuar dhe zotëronin me prona të mëdha, dhe të cilat përmes organizimit politik dëshironin që me çdo kusht t'i mbrojnë interesat e tyre.<sup>28</sup>

Intelektualë të dalluar dhe personalitete të njohura myslimane në trevat lindore, të cilët deri atëherë ishin anëtarë të partive të tjera politike (Partisë Radikale, Partisë Demokratike dhe Partisë Komuniste), paralajmëronin që do të anëtarësoheshin dhe do të angazhoheshin në subjektin e ri të myslimanëve në këto treva. Organizata e re politike ishte në proces të përgatitjes së statutit dhe programit politik, që të mund të dilte në zgjedhjet parlamentare dhe lokale.<sup>29</sup>

Në këtë periudhë, si në aspektin legjislativ, poashtu edhe krijimin e programit dhe statutit të Xhemijetit, ndihmuan përvojat e organizatës së myslimanëve të Bosnjë e Hercegovinës – Organizata Myslimane Jugosllave (OMJ). Në takimet e shpeshta të iniciativës politike të myslimanëve nga trevat lindore, Kosova dhe Sanxhaku, u formua Këshilli, i cili kishte për qëllim që të bëjë një anketë për formimin e organizatës politike, ndërsa vëmendje e posaçme iu kushtua edhe reagimit të partive tjera politike rreth kësaj iniciative. Për këtë çështje u dërguan ftesa për delegimin e përfaqësuesve nga komunat e tjera nga brendia e trevave lindore, Kosovës dhe Sanxhakut, në Shkup, që të arrihej një marrëveshje e përgjithshme dhe të konkretizohet formimi i kësaj organizate politike. Nga këto takime, doli edhe thirrja për mbajtjen e një mbledhjeje konstituive të kësaj organizate politike<sup>30</sup>, këtë nismë e mbështetën të gjithë imamët që i përfaqësonin besimtarët nga trevat lindore, Kosova dhe Sanxhaku, dhe pritej të dominojë rregullimi i çështjes së vakëfit<sup>31</sup>, kjo nismë ishte një hap përpara për organizimin politik të popullatës myslimane në trevat lindore, Kosovës dhe Sanxhakut.<sup>32</sup>

---

<sup>27</sup> ИНИ, *Историја на Македонија*, Скопје, 2009, 209; Branislav Gligorijević, *Parlament i političke stranke u Jugoslaviji 1919 1929*, Beograd, 1979, 83.

<sup>28</sup> АИНИ, фонд: *Трека Армска Облас*, ред.бр. 201, број на инв.5012, 14.09.1919, 1.

<sup>29</sup> Архиви i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej AMPJSH ), Viti.1922, dosja.50, *Raport i Legatës së Shqipërisë në Beograd dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë*.

<sup>30</sup> *Муслимански Конгрес*, në: “Мисао“.

<sup>31</sup> АИНИ, фонд. Миладин Стојадиновиќ, К.ХХХХХ, 1.

<sup>32</sup> Skender Asani, *Veprimtaria e Organizatës Politike Xhemijeti në Trevat Lindore (1919 – 1925)*, 42.

Partia e Xhemijetit (Bashkimi) u themelua në Shkup më 18 dhjetor 1918, si parti politike shqiptare me Status dhe program të saj, si shprehje e aspiratave për pushtettë borgjezisë shqiptare për pushtet të borgjezisë shqiptare me synim të theksuar për të ruajtur interesat e veta nëpërmjet saj. Kryetar i këshillit qëndror ishte Nexhip Draga nga Mitrovica, nënkryetar Sheh Sabedini nga Tetova dhe sekretar Aqif Bluta nga Pazari i Ri. Në atë kohë Shtabi i Armatës së Tretë, lajmëroi ministrinë e ushtrisë “se në Shkup po mbahej Kongresi i muslimanëve të Jugut në praninë e 64 pjesëmarësve”.<sup>33</sup>

Deri tash janë paraqitur vlerësime të ndryshme lidhur me këtë organizatë politike. Është shfaq mendimi se Xhemijeti është paraqitur për të penguar diferencimin klasor në pakicat në Maqedoni.<sup>34</sup>

Mendimi se kjo organizatë ishte nacionale turke dhe se ishte e formuar në baza fetare, nuk mund të qëndrojë meqë më së miri këtë e demanton fakti se Nexhip Draga, kryetar i saj, ishte luftëtar i denjë i lëvizjes kombëtare shqiptare.<sup>35</sup>

Tendenca që ajo quhet turke nuk është asgjë tjetër veçse nënçmim i lëvizjes çlirimtare shqiptare, e cila në literature sërbe u quajt rebele. Edhe pse Partia Xhemijeti dhe gazeta e saj Hak kishte emërtime në turqishte, shumica e antarëve të Xhemijetit ishin shqiptarë. Xhemijeti në gjithë veprimtarinë politike që zhvilloi, ai luftoi për të drejtat e popullit shqiptar.<sup>36</sup>

Në Kuvendin themelues u aprovua programi i punës, i cili kryesisht koncentrohej në pikat të cilat ishin në kundërshtim me përpjekjet e politikave partiake qeveritare (Partisë Radikale dhe Partisë Demokratike), për kolonizimin dhe reformën agrare, dhe me pikat të cilat ishin të lidhura me çështjet e arsimit.

Programi politik i Xhemijetit ishte i përbërë nga gjithsej 10 pika:

1. Autonomi arsimore - fetare. Bashkimi i Drejtorisë Fetare në të gjithë vendin, dhe me ligj të sigurohet lidhja me Kalifatin;
2. Gjyqe të Sheriatit për kurorëzimet, familjen dhe çështje të tjera;
3. Ruajtja e vakëfit dhe të mirave të tjera materiale;

---

<sup>33</sup> Marenglen Verli, *Politika e kolonizimit sllav te trevave shqiptare në periudhën midis dy luftimeve botërore* ..., 358.

<sup>34</sup> *Historia e Maqedonisë*, 214.

<sup>35</sup> Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941*, 132.

<sup>36</sup> *Historia e popullit shqiptar*, v. III, Tiranë, 2008, 470.

4. Gjuhë amtare për popullatën josllave, përkatësisht myslimane në arsimin fillor, dhe autonomi në funksionimin e shkollave;
5. Largimi nga shkollat shtetërore i leximit të lutjeve sipas ritualeve krishtere, rishqyrtimi i librave shkollorë, nga të cilat duhet të largohen njësitë arsimore me karakter fetar;
6. Përcaktimi i deputetëve myslimanë në Kuvendin popullor, në proporcion me numrin e përgjithshëm të popullatës myslimane, dhe themelimi i një organizate të veçantë të myslimanëve;
7. Përjashtimi i vakëfit nga sekuestrimi ose kompensimi me marrjen e të mirave materiale;
8. Përjashtimi i pronave të bejlerëve nga reforma agrare, me përkushtim në përcaktimin e rregullimit të çështjes së reformës agrare;
9. Pagesa joplotësuese e bejlerëve për të hyrat e çifligarëve;
10. Nga viti 1912, pa pëlqimin e pronarëve, ishin marrë pronat e bejlerëve, dhe ishin vënë nën pushtetin serb dhe nën administrimin e dhunshëm të armiqve. Organizata angazhohet për kthimin e pronave në gjendjen e para vitit 1912.<sup>37</sup>

Me këtë program politik, Xhemijeti hyri në bisedime me partitë parlamentare në Kuvendin popullor, dhe me programin e njëjtë u prezantua në fushatat zgjedhore para elektoratit në zgjedhjet parlamentare dhe lokale (komunale). Edhe pse qarqet sunduese serbe u përpoqën që ta largonin nga programi kombëtar, duke ia imponuar Xhemijetit një platformë sociale-humanitare të veshur me petkun fetar. Në thelb Partia Xhemijeti veprroi si një parti e ligjshme e shqiptarëve, bëri përpjekje për të siguruar me rrugë ligjore të drejtat politike-kulturore të popullsisë shqiptare. Ajo kishte një program të vetë për mbrojtjen e të vetave politike të popullatës Muslimane. Përkrahja dhe qëndrimi i Xhemijetit ndaj partive qeveritare, ishte precizuar me Programin e saj, nga i cili nuk kishte largim. Këto përpjekje dilnin nga vendimet e sjella në kongreset dhe konferencat e Xhemijetit, por ishin edhe kusht për bashkëpunim me Partinë Radikale, që të paraqitet para elektoratit mysliman nga trevat lindore.<sup>38</sup>

---

<sup>37</sup> Skender Asani, *Veprimtaria e Organizatës Politike Xhemijeti në Trevat Lindore (1919 – 1925)*, 52.

<sup>38</sup> *Po aty*, 51.

Organizata politike “Xhemijeti”, e botoi zyrtarisht gazetën “Hak”, si organ të saj partiak. Pas një viti e dy muaj të veprimit të saj, Xhemijeti e nxori numrin e parë të gazetës “Hak” (arabisht “Häk”: drejtësi, e drejtë), me mjaft kredibilitet. Kjo gazetë edhe pse botohej në gjuhën turke me shkronja arabe dhe në gjuhën serbe me shkronja qirilike, ishte dhe mbeti zëri më autentik i kohës për lirinë e popullsisë myslimane nën regjimin e Mbretërisë. Drejtor dhe pronar i gazetës “Hak”, ishte H. Halidi, kurse redaktor përgjegjës Hasan Sabri Ibrahim. Ky organ shtypi në gjuhën turke dhe serbe për herë të parë doli më 23 janar (e hënë) 1920. Numri i fundit 954 i gazetës “Hak” në gjuhën serbe dhe turke, që mund të shihet nga koleksioni i vetëm dhe jo i plotë e gazetës që gjendet në Zagreb, doli më 10 dhjetor 1924.<sup>39</sup>

Gazeta “Hak” përmes shkrimeve të ndryshme, para opinionin të gjerë e prezantoi Programin politik me 10 pika të sjellë në Kuvendin themelues të Xhemijetit. Programi politik në faqet e gazetës, në fillim ishte paraqitur në mënyrë më të butë, me qëllim që të adaptohej para masave të gjera popullore, kurse më vonë ky koncept ishte radikalizuar. Kjo gazetë, theks të veçantë i dha autonomisë arsimore-fetare, me qëllim që të arsimohen gjeneratat e reja dhe masat e gjera popullore me përkatësi fetare myslimane. Gazeta “Hak”, që në numrat e saj të parë, i kushtoi rëndësi çështjes së hapjes shkollave në gjuhën amtare për myslimanët e trevave lindore, për shkak se arsimimi në gjuhë të huaj (serbe), nuk mund t’i arrinte qëllimet e duhura. Në lidhje me këtë, gazeta “Hak”, në numrin e saj të tretë publikoi një letër të hapur deri te Ministri i Arsimit, ku thuhej se shkollimi dygjuhësh mund të sillte deri në konfuzion tek fëmijët e moshës shtatëvjeçare, për shkak se në klasën e parë ata e zotërojnë vetëm se gjuhën e vetë.<sup>40</sup>

Programi i Xhemijetit prej dhjetë pikave, ishte një nga shtyllat kryesore të veprimit politik, arsimor dhe kulturor të myslimanëve nga trevat lindore, si një element kompakt dhe i organizuar në Mbretërinë SKS. Gjithashtu kjo gazetë një rëndësi të veçantë i kushtonte çështjeve kulturore-arsimore të myslimanëve nga trevat lindore, ku potencohej se nëse pushteti e njeh ekzistimin e një populli, kjo domethënë se duhet t’i pranojë edhe traditat kombëtare dhe gjuhën e tij, për shkak se, sikurse nuk ka pushtet pa popull, po ashtu nuk mund të ketë pushtet mbi popullin i cili nuk ka gjuhë.

<sup>39</sup> Bogumil Hrabrak, D. Janković, *Srbija 1918*, Beograd, 1968. 90.

<sup>40</sup> Љилијана Чолић, *Партија Цемјет како парламентарна странка у Кралевини СХС*, në: *Историјски часопис*, књ. XLVII (2000), Београд, 2002, 154 - 155.



Nga Xhemijeti ishte kërkuar që nga ana e deputetëve të partive tjera politike në Kuvendin popullor, të sqarohet synimi programor për mësimin e gjuhës amtare të myslimanëve, për shkak se askund nuk përmendej se për cilin popull bëhej fjalë ose për çfarë gjuhe flitej, kurse në faqet e gazetës shpeshherë përdorej sintagma se gjuha amtare dhe kombëtare duhet të përdoren si gjuhë fetare e myslimanëve në trevat lindore dhe në Sanxhak. Gazeta “Hak” shpeshherë u kritikua se manipulon me numrin e banorëve të këtyre vendeve, dhe se atje jetojnë dy milionë banorë myslimanë. Në këtë drejtim, kërkesa e tyre fitonte në peshë, për shkak se pa dallim nga fakti që bashkësia ishte me përkatësi fetare islame në këto hapësira, sipas kritikëve të mediave, bëhej fjalë për tri grupe nacionale: shqiptarë, boshnjakë dhe turq.<sup>41</sup>

Kongresi i Dytë i Xhemijetit mbahet në Shkup nga 20–26 korrik 1920 me moton: “Të gjithë myslimanët e Jugut në një front nacional për të drejta popullore”. Në këtë Kongres ndryshoi nominalisht e tërë strategjia politike e Nexhip Dragës, i cili fizikisht mungonte. Prandaj, para se të fillojë punimet, Kongresi e transformoi emrin e Xhemijetit në “Organizata Myslimane e Serbisë Jugore të Mbretërisë SKS”. Të gjitha pësjtjellimet nominative i krijoi Qenan Zija, i cili zgjidhet për një kohë të shkurtër edhe drejtues i Xhemijetit. Dokumentacioni i kohës argumenton se kemi të bëjmë me një puç politik destruktiv, i cili nuk do të ndalet si kahe deri në ndalimin e veprimtarisë politike, fakt ky që e kërkonte Mbreti dhe të gjitha partitë serbe si në orkestër. Kongresi u kushtoi rëndësi zgjedhjeve parlamentare që u mbajtën më 28. XI. 1920. Kongresit do t’i paraqet pengesa kryemiftiu (Suprem) i Mbretërisë SKS, Abdyl Bej Efendia, një serbofil dhe mik i N. Pashiqit. Me gjithë këtë, nga shumica e të pranishmëve në Kongres, u kërkuar që shkolla shqipe të pranohet, që reforma agrare t’i përfshijë të gjitha shtresat e shoqërisë. Vendasve u kërkuar mos t’u grabitet toka e t’u dhurohet kolonëve sllavë, të cilët armatoseshin dhe me armë i grabitnin tokat e familjeve kaçake dhe atyre që ishin të pasura, krejt me qëllim që viset shqiptare të sllavizohen. Për këtë qëllim, u tha në Kongres, pushteti po sjellë mercenarë rus dhe sllavë tjerë, të cilët nuk janë bujq, por xhandarë dhe vrasës ordinerë të popullit, e ku po ndihmohen edhe nga ushtria dhe administrata.<sup>42</sup>

<sup>41</sup> Љиљана Чолић, *Partija Цемидет како парламентарна странка у Кралевини СХС*, 155.

<sup>42</sup> Hakif Bajrami, *Partia politike “Xhemijet-i” (Bashkimi) në Shqipërinë kontinentale krijon histori kombëtare*, në gazetën “Scupi”, nr. 20, Shkup, 2018, 96-97.

Organet qeveritare të Mbretërisë SKS, shpallën zgjedhjet Komunale që do të mbaheshin më 22 gusht 1920. Zgjedhjet komunale të 22 gushtit të vitit 1920 në Shkup, sipas parashikimeve të politikës serbe, duhej të jepnin aso rezultatesh, në mënyrë që shqiptarë të mënjanohej nga ndikimi në pushtetin lokal, sepse në këtë mënyrë do të sigurohej baza solide për dominim në pushtetin e qarqeve sërbomadhe. Hegjemonistët sërb, bënë përpjekje që t'u sigurojnë Partive Radikale dhe Demokratike pozita zotëruese në këtë rajon. Në rrethin Shkupit, për shembull, thuhet në një raport sekret, nuk ka asnjë njeri që di shkrim e lexim, në mënyrë që të vihet në krye të trupit elektorat.<sup>43</sup>

Edhe ata shqiptarë që kanë arritur të kandidoheshin për ndonjë funksion është dashur ti plotësojnë disa parakushte, siç është gjendja e mirë e tij ekonomike, pajtimi me politikën e qeverisë, të njohë shkrim-leximin e gjuhës serbe-shtetërore, me alfabet qirilik si dhe ti takojë asaj partie borgjeze që ishte përkrahëse e programit ose program përafërisht me idetë e borgjezisë në pushtet.<sup>44</sup>

Prej gjyqit të komunës së Shkupit më 5 gusht të vitit 1920, me numër 12983 në Shkup,<sup>45</sup> Komuna e Shkupit kishte 6.656 votues, qyteti është ndarë në 5 vendvotime ku do të kryhen zgjedhjet, votuesit që do të jenë në listë do të shkojnë të votojnë atje ku është i caktuar vendvotimi i tyre.

Komunistët	Xhemijeti	Demokratët	Radikalët	Gjithsej
296	68	152	122	638
364	46	89	109	605
140	41	196	486	863
129	5	18	442	594
237	6	36	257	534
<b>1166</b>	<b>166</b>	<b>491</b>	<b>1413</b>	<b>3234</b>

Partia e Xhemijetit mendohej që përmes votës të vë në dukje etnitetin e veçantë të shqiptarëve, por në zgjedhjet komunale të 22 gushtit 1920, Partia e Xhemijetit nuk arriti të paraqitej si parti me profil të veçantë politik kombëtar shqiptar, si duhej.<sup>46</sup>

<sup>43</sup>Историцки Архив- Скопје, *Деведесет денови на Скопската црвена Општина*, 39.

<sup>44</sup> Limon Rushiti, *Rregullimi territorial dhe administrativ i Kosovës 1918-1941*, 154.

<sup>45</sup>Историски Архив-Скопје, *Деведесет денови на Скопската црвена општина*, 54.

<sup>46</sup>*Historia e popullit shqiptar*, v. III, 470.

Partia Radikale e vazhdoi veprimtarine e vet te pavarur edhe ne shtetin e ri, duke bere riorganizim dhe zgjerim edhe ne regjione tjera, jo më si parti e vjetër politike serbe. Në shtator 1920, në Konferencën e vet, nxorri disa përfundime për programin e vet. Ajo në programin e ri ia adaptoi rrethanave politike të reja, dmth. Shtetin e bashkuar kuptojmë shtetin me një parlament, të cilit i përgjigjet një qeveri shtetërore e që me kurorën ka pushtet të pandarë sovran dhe ligjdhënës në tërë vendin.<sup>47</sup>

Në tubim u vendos që organet e partisë Radikale të ishin: Këshilli Qendror, këshilli i qarkut dhe këshilli i rrethit. Këshilli kryesor të udhëheq tërë veprimtarinë në kuadrin e programit. Sipas programit, 12 antarë e përbënin këshillin kryesor, të cilët jetonin në Beograd e zgjidheshin prej këshillave qarkor. Kryetar i Këshillit kryesor ishte njëkohësisht edhe shefi i partisë Nikolla Pashiq. Sipas dokumenteve partiake, shihet se mbledhjet e këshillit parashikoheshin të mbaheshin çdo muaj, ne çdo komunë themelonin këshillin e rrethit. Aktiviteti partiak i Partisë Radikale edhe ne Shkup zhvillohej në tubime dhe mitingje të organizuara në komunën e Shkupit si dhe rrethin e Shkupit. Aty u fol edhe për problemet aktuale të arsimit, të ekonomisë të financave dhe të politikës sociale për Shkupin dhe rrethin e saj. Në çdo komunë ku ishin të regjistruar më së paku 10 vetë në Partinë Radikale, sipas statusit kishte mundësi të themelohej Këshilli i vendit. Këshilli i rrethit përbëhej prej kryetarëve dhe nënkryetarëve të këshillave të vendeve që mblidheshin në çdo tre muaj. Aktiviteti partiak i Partisë edhe në Shkup themloj Këshillin e rrethit të përbërë prej 10 antarë.<sup>48</sup>

Xhemijeti shpalli krimet e Qeverisë e të Partisë Demokratike ndaj shqiptarëve, kur demokratët ishin në pushtet më 1919. Xhemijeti u formua prej qarqeve borgjeze dhe në shumë raste ai kishte qëndrime identike me Komitetin e Kosovës.<sup>49</sup>

Mandej thuhet se bashkpunonte me Partinë Radikale, por mund të themi se ishte organizatë borgjeze, duke mos lënë anash të drejtat dhe obligimet e popullit shqiptar. Për Xhemijetin kishte rëndësi ajo pikë e programit të Partisë Radikale që parashihte vetëadministrim në komunë, rrethe dhe krahina.

---

<sup>47</sup> Vebi Xhemaili, *Zgjedhjet parlamentare në Mbretërinë SKS dhe partitë politike borgjeze në Tetovë*, në: Shqiptarët e Maqedonisë, Shkup, 1994, 203.

<sup>48</sup> Миливоје Павлович, *После двадесетнет година*, Скопје, ..., 1051.

<sup>49</sup> Lush Culaj, *Komiteti "Mbrotjja Kombëtare e Kosovës" 1918-1924*, Prishtinë, 1997, 45.

Pra antarët e Xhemijetit, duke pasur parasysh numrin e popullsisë që përfaqësonin shpresonin se në Kosovë do të kenë autonomi lokale ku ato do të jenë në pushtet. Antarët e partisë së Xhemijetit disa herë e njoftuan opinionin me gjenocidin fizik që po zbatonin xhandarmëria serbe kundër shqiptarëve. Prej në fillim të vitit 1920, Partia e Xhemijetit filloi të mbajë tubime në tërë rajonet shqiptare, me qëllim që populli të njihet për së afërmi me programin e Partisë i aprovuar në Shkup. Në të gjitha këtotubime dolën kërkesat për të drejtat e plota për kombësinë shqiptare si në aspektin e arsimit ashtu edhe atë në aspektin kombëtar. Ndikim të madh në këtë parti ka pasur Hasan Prishtina, i cili përpiquej të bëjë organizimin shqiptarëve, por ky ishte kundër bashkpunimit me Partinë Radikale. Për të qënë kjo parti legale, ishte e nevojshme që Xhemijeti në fillim ti jepet petku musliman, duke e shrytëzuar këtë, si organizatë borgjeze, të dalë më vonë me kërkesa më të avansuara për çlirimin e shqiptarëve nga shtypja serbomadhe. Me qëllim që Partia Xhemijet të organizohet u mbajtë mbledhje në Shkup, ku kishte përfaqësues nga rrethi i Shkupit, u njoftuanme programin e partisë së re politike Xhemijet. Në të gjitha këto dolën kërkesa për të drejtat e plota për kombësinë shqiptare si në aspektin e arsimit dhe të edukimit, ashtu edhe në aspektin e veçorive të tjera kombëtare për liri dhe autnomi.<sup>50</sup>

Zgjedhjet parlamentare për Kuvendin ligjvënës, ishte vendosur që të mbahen më 28 nëntor të vitit 1920, dhe u parapa që ato të zhvilloheshin në të gjithë territorin e Mbretërisë SKS. Në këto zgjedhje, aktivisht do të merrnin pjesë 22 parti politike, të cilat ishin legale në Mbretërinë SKS, kurse në këtë kontekst edhe në trevat lindore. Në mesin e tyre ishte edhe organizata politike Xhemijeti.<sup>51</sup>

Me shpalljen e zgjedhjeve parlamentare dhe fushatës parazgjedhore, partitë politike shihnin mundësinë që përmes tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë të komunikonin me votuesit (popullatën), që t'i shpalosin programet e tyre zgjedhore, ta përfitojnë besimin e popullatës dhe të vijnë në pushtet. Më 2 shtator të vitit 1920, u soll Ligji zgjedhor. I gjithë territori i Mbretërisë SKS, ishte ndarë në gjithsej 56 qarqe zgjedhore. Kurse trevat lindore, ishin ndarë në 7 qarqe zgjedhore, të cilat ishin në korrelacion me qarqet administrative, kurse këto ishin të ndarë nëpër rrethe zgjedhore.

---

<sup>50</sup> *Besa shqiptare*, në: Hak, nr. 5, Qershor 1920.

<sup>51</sup> Historia e popullit maqedonas, Shkup, 1983, 205; Турђе Јеленић, Нова Србија и Југославија (1788-1921), Београд, 1923, 421.

Numri i deputetëve popullor nuk ishte përcaktuar me Kushtetutë, por numri i tyre varej nga numri i popullatës, kurse për numrin e deputetëve të cilët zgjidheshin nëpër qarqet zgjedhore, vendoste Këshilli shtetëror. Numri i deputetëve të cilët do të zgjidheshin në Kuvendin Ligjdhënës në gjithë territorin e Mbretërisë SKS, ishte 419, kurse në trevat lindore do të zgjidheshin 33 deputetë.<sup>52</sup>

Partitë politike të radikalëve dhe demokratëve, dëshironin të përfitonin më shumë mandate në pjesën e Maqedonisë së Vardarit, për shkak se kjo u mundësonte atyre fitimin e më shumë deputetëve, kurse me fitimin e tyre, mundësohej që të jetë dominues elementi politik serb në Kuvend. Në këto zgjedhje parlamentare, organizata politike Xhemijeti bëri koalicion me Partinë Radikale, kurse këto dy parti poashtu bënë edhe fushatë të përbashkët parazgjedhore.<sup>53</sup>

Organizata politike Xhemijeti u përgatit për këto zgjedhje, dhe për këtë rast, disa herë ishte publikuar Ligji zgjedhor në gazetën “Hak”. Në këtë gazetë ishte shpallur edhe Proklamata e Xhemijetit ku theksi kryesor ishte vënë në nevojën që të gjithë myslimanët e trevave lindore, të mobilizohen nën ombrellën e organizatës së tyre politike, për shkak se kjo ishte mënyra e vetme që të fitohen të drejtat fetare, kombëtare, arsimore, intelektuale, etj. Ajo i përmbante arsyetimet nga vendimet e sjella nga organizata, e cila ishte mbrojtëse e të drejtave të myslimanëve. Në Shkup, fushata zgjedhore e Xhemijetit u realizua nëpërmjet takimeve, tubimeve, pamfleteve dhe thirrjeve publike. Një thirrje e këtillë ka qenë e përbashkët për kandidatët e Partisë Radikale dhe të Xhemijetit. Në zgjedhjet parlamentare të 28 nëntorit 1920, organizata politike Xhemijeti në trevat lindore i ka theksuar listat e veta votuese në 6 rrethe votimi.<sup>54</sup>

Në rrethin e Shkupit është verifikuar lista zgjedhore e radikalëve dhe Xhemijeti, të cilët kanë dalë me lista të përbashkëta. Bartës i listës së parë ka qenë Milenko V, ndërsa në listën e dytë ka prirë Emini Jashar Kumbara, Bora Milanoviq, Hasan Shukri Mustafiu, etj. Shfaqja e listave të përbashkëta zgjedhore ka qenë në dobi të interesave të kryesisë së Xhemijetit, si edhe të partisë Radikale.

---

<sup>52</sup>Надежда Цветковска, *Политичките партии во парламентарните изборни борби...*, 20.

<sup>53</sup>Александар Апостолов, Предизборната кампања за изборите на Уставотворната Скупштина на Кралството на СХС и теророт во врска со овие избори во Вардарскиот дел на Македонија низ необјавени документи, „Историја“ Списание на Сојузот на Друштвата на историчари на СР Македонија, год.XVI, бр.2, Скопје, 1980, 165.

<sup>54</sup>Надежда Цветковска, *Политичките партии во парламентарните изборни борби...*, 68.

Në këto zgjedhje në trevat lindore, në Kosovë dhe në Sanxhak për partinë e Xhemijetit votuan 30.039 votues dhe fituan 8 mandate në Kuvendin Ligjdhënës: Emin Jashar nga Shkupi, Qenan Zija beu nga Manastiri, Ali Shefik Haxhi-Murtezani nga Shtipi, Husein Ali Rizabegović nga Kavadari, Mustafa Shehzade dhe Sherif Bajram nga Prizreni, Mahmud Jumerović nga Presheva për rrethin e Kumanovës, dhe Ismet bej Qamili nga Gjakova. Fitimi i tetë deputetëve nga ana e Xhemijetit, pasqyronte sukses të madh, sepse me këtë do të bëhet subjekt i rëndësishëm në Kuvendin Kushtetues të Mbretërisë SKS. Zgjedhjet e 28 nëntorit 1920 për Kuvendin Kushtetues në trevat lindore u zbatuan në 7 qarqe zgjedhore, 31 rrethe zgjedhore. Në këto zgjedhje konkurruan disa parti politike: Partia Radikale, Partia Demokratike, Partia Republikane, Partia Komuniste dhe Xhemijeti.<sup>55</sup>

Në jetësimin e programit dhe ngritjen e organizatës politike Xhemijeti, rol të rëndësishëm kishte lideri i saj Nexhip Draga, e pastaj edhe Ferhat Draga. Xhemijeti dinjitetshëm përmes disa deputetëve të saj në Parlamentin e Mbretërisë SKS, i përfaqësoi interesat e myslimanëve (shqiptarëve dhe turqve), në këtë shtet, duke kundërshtuar në radhë të parë kolonizimin dhe reformën agrare, si dhe ndërprerjen e shpërnguljes në Turqi dhe Shqipëri. Përkaj shkollave me mësim në gjuhën serbe, kishte shkolla edhe në gjuhën turke. Duke u bazuar në programin politik, ishte edhe angazhimi permanent i deputetëve dhe aktivistëve të Xhemijetit për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe dhe atë turke<sup>56</sup>.

Paraqitja e gazetës “Hak” në skenën mediale me shkrimet për turbullirat politike dhe gjendjen shoqërore, tentonte të tërhiqte vëmendjen edhe të partive politike dhe pushtetit, për të mos bërë presion dhe për të mos censuruar tekstet në këtë organ shtypi të vetëm të myslimanëve në këtë territor. Shumëllojshmëria e temave të cilat u përpunuan në gazetën “Hak”, ishin tërësisht në përputhje me vendimet e sjella në Kongresin e organizatës, dhe e zbatonte në tërësi programin dhe platformën e saj politike. Gazeta “Hak” në faqet e saj, publikoi një numër të madh të teksteve dhe informacioneve për aktivitetet e organizatës Xhemijeti, kurse i publikonte edhe raportet e plota të korrespondentëve të gazetës për vrasjet dhe gjenocidin e shkaktuar nga xhandarmëria dhe ushtria jugosllave mbi popullatën myslimane në trevat verilindore.

<sup>55</sup> Skender Asani, *Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore* (dokumente), v. I, Shkup, 2015, 33.

<sup>56</sup> AMPJSH, Viti 1923, dosja. 206, fleta. 7, *Raport i Legatës së Shqipërisë në Beograd dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë*.

Këtë e vërejtën organet shtetërore, kurse shtypi i cili ishte nën ndikimin e pushtetit, këtë e shihte si një tendencë të Xhemijetit për prishjen e rendit kushtetues. Pikërisht temat që trajtoheshin në këtë gazetë, shpeshherë ishin cak i gazetave të ndryshme, e sidomos të atyre që botoheshin në gjuhën serbe në Shkup.<sup>57</sup>

Gazeta “Hak” mbronte qëndrimet politike të Xhemijetit, që binin ndesh me Partinë Radikale Serbe. Autoritetet shtetërore ishin hidhëruar me botimin e numrit 938 të gazetës ‘Hak’ të 19 nëntorit 1924, ku ishte botuar një artikull me titull “*Në kohën e absolutizmit korruptiv*”. Sipas organeve shtetërore, me veprimin e këtyllë të redaksisë së gazetës “Hak” dhe në artikull me shprehje inkriminuese, shkohet në atë që të shkelet rendi dhe qetësia publike dhe të rrezikohet rregullimi shoqëror, duke nxitur popullin kundër veprimeve të pushtetit, me urdhërdhënësia e rrënimit në Shkup të Burmalit xhamisë, edhe pse ky urdhër nga ana e pushtetit ishte i arsyetuar me ligj, sepse vendimi për rrënimin e të gjitha xhamive ishte miratuar edhe nga ana e Ministrisë së Ndërtimit. Organet shtetërore me këto akte represive arsyetonin masat e dhunshme ndaj gazetës myslimane “Hak”.<sup>58</sup>

Rasti që i ndodhi Ferhat bej Dragës në Shkup, mund të quhet mungesë e ligjit vetëm atëherë nëse ai ishte burgosur me të vërtetë pa arsye, me qëllim të pengimit të aktiviteteve parazgjedhore, për t’i shkaktuar sa më shumë dëme në radhët e tij. Ferhat bej Draga ishte i privuar nga liria në Shkup dhe ishte dërguar në Mitrovicë me kërkesën e kryetarit të qarkut. Pas burgosjes së Dragës, ndër akuzat më të rënda me të cilat u përballë ishte se: “*Kishte të dhëna se Ferhat Draga ka qenë në lidhje me Komitetin e Kosovës, por edhe kjo ishte heshtur*”.<sup>59</sup>

Xhemijeti jo vetëm që kundërshtoi dhe dënoi me fakte politikën kolonizuese sllave ndaj trojeve shqiptare, por edhe u bëri thirrje shqiptarëve që të mos i lëshonin viset e tyre me asnjë çmim. Midis Xhemijetit dhe Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës dhe Lëvizjes Kaçake, kishte bashkëpunim të vazhdueshëm.<sup>60</sup>

---

<sup>57</sup> Љиљана Чолић, Лице и наличје политичких слобода у Јужној и Старој Србији током доба парламентаризма Кралевина СХС, „Баштина“, IX – X, Приштина, 1991, 203.

<sup>58</sup> Љиљана Чолић, *Партија Цемјет како парламентарна странка у Кралевини СХС*, 153-154.

<sup>59</sup> Skender Asani, *Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore (dokumente)*, v. I, 37.

<sup>60</sup> Fjalori enciklopedik shqiptar 3, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2009, 2951.

Kongresi i Tretë i Xhemijetit mbahet më 14-18.IV. 1922 në Shkup. Temë kryesore ishte çështja e pengimit të kolonizimit të viseve shqiptare me sllavë dhe respektimi i një reforme agrare të drejtë. Para se të fillohet me çështjen e arsimit të myslimanëve (shqiptarëve), në Kryesinë e Xhemijetit në Kongres, përpos Ferat Dragës dhe Qenan Zijait, zgjidhen edhe: Rifat Rushidi I Mitrovicës, Fehmi Gjylbegu i Shkupit, Ismil Kemali i Manastirit, Hysen Hyseni i Prilepit. Njëherit Kongresi zgjedh një Këshill për arsim, ku hynin: Aqif Blyta, Qenan Zija, Bajram Ajvazi. Për herë të parë shumë anëtarë jo vetëm të Kryesisë, fillojnë t'i mësojnë gërmat e alfabetit kombëtar, edhe pse ishin persona me fakultet. Në vijim diskutohet për pacenueshmerinë e banesës, lirinë e lëvizjes dhe tregtisë, për kthimin e të gjithë muhaxherëve në pronat e veta si dhe hynë në konkluzë se “kolonët sllavë nuk po merren me bujqësi”. Në fund do të diskutohet dhe programohet që Xhemijetit të merret me çështje sociale (me çështjen e varfërisë së 85% të anëtarësisë). Me propozimin e Ferat Dragës, aprovohet një dokument që kishte për bazë sigurimin e të drejtave elementare për qytetarët myslimanë në viset jugore, sepse shqiptarët po ndiqeshin dhe po internoheshin për asgjë, por faji ishte vetëm i llojit, pse ishin shqiptarë.<sup>61</sup>

Në fund të vitit Nikolla Pashiqi, duke menduar se është forcuar politikisht, më 16. XII. 1922, do të shpallë zgjedhjet parlamentare për 18 mars 1923. Kongresi shpalsi një strategji politike që krijoi famë në komb, por jo njohje që të frymojë shqip, sepse pushteti po e pengonte me çdo mjet.

Në ditët e para të vitit 1923 dhe në prag të zgjedhjeve parlamentare, partia e djathtë myslimane i kishte drejtuar një letër të hapur z.Nikolla Pashiqit: *“Ne jemi kundër çdo veprimi të njëanshëm edhe ndaj irredentizmit të paraqitur në trevat jugore. Por, sa ne e njohim popullatën myslimane në atë vend, mund të konkludojmë se revoltat nuk qëndrojnë tek irredentizmi i myslimanëve, por tek administrimi i keq i administratës, e cila kërkonte që të ushtronte pushtet në të gjitha nivelet. Në pjesën jugore duhet të ndalohet politika partiake dhe ajo të zëvendësohet me politikë shtetërore. Ne nuk mund në asnjë mënyrë t’u shmangemi interesave të gjera të popullatës që na voton dhe nuk do të lëvizim asnjë pëllëmbë nga programi ynë zgjedhor.*

---

<sup>61</sup> Hakif Bajrami, *Partia politike “Xhemijet-i” (Bashkimi) në Shqipërinë kontinentale ...*, 96-97.



Agjitimi zgjedhor ishte shumë i gjallë në tërë viset jugore, ndonëse ende nuk ishin publikuar listat e kandidatëve. Te myslimanët e Shkupit ndjehet gatishmëri për bashkëpunim me radikalët. Ky disponim vërehet te prijësit e Xhemietit. Vendimi përfundimtar do të aprovohej në punimet e Kongresit. Në këtë drejtim, ditën e nesërme do të vazhdojë të botohet edhe organi medial i Xhemietit, gazeta “Hak“. Këshill Qendror për kandidimin e deputetëve para vetes kishte një punë të vështirë të seleksionojë kandidatët e mundshëm për deputetë. Mbledhja kishte zgjatur dy ditë me radhë dhe pastaj ishte kaluar në diskutime rreth kandidatëve të mundshëm. Këshilli miratoi kandidatët që do jenë bartës të listave zgjedhore nëpër rrethe, për rrethin e Shkupit Qemal bej Kumbara. Si bartës të listave nëpër rrethe, por edhe kandidatëve që u propozuan nëpër qarqe, vendimin përfundimtar do të sjellin konferencat që do të mbahen nëpër rrethe. Vendimet që do të sjellin konferencat nëpër rrethe do t’i miratojë Këshilli Qendror i Xhemietit. Pastaj Kongresi kaloi në zgjedhjen e këshillit qendror. U vendos që këshillit qendror t’i vazhdohet mandati edhe për dy muaj. Ndërsa në postin drejtorit të gazetës Hak, u caktua Fahri Gjullbegoviç.

Kongresi i Katërt i Xhemijetit mbahet më 20-29 janar 1923 në Shkup, në praninë e 100 delegatëve. Kongresin e hapi Rifat Ruzhdi Aga, kryetar i degës së Xhemijetit në Mitrovicë. Fillimin e Kongresit e drejton Qenan Zija, duke sjellë një fjalim të shkurtër se çfarë kishin biseduar Ferat Draga dhe Q.Zija me Nikolla Pashiqin më 4 janar 1923, në Beograd. Kongresi punën dyditore në fillim do t’ia kushtojë çështjes pse Xhemijeti e kishte votuar Kushtetutën e Vidovdanit më 28 VI 1920. Në vijim do të debatohet për pjesëmarrjen e Xhmijetit në zgjedhjet parlamentare me listë të veçantë. Qenan Zija, si jurist, të pranishëmve do t’ua përkujtojë Ligjin Elektorale, të aprovuar më 27 qershor 1922. Kongresi u mbajt në prani të 61 delegatëve. Këshilli i Përgjithshëm (Hejeti Feale) debatoi për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare. Për paraqitje të Xhemijetit as me radikalë e as me demokratë, votoi Këshilli i Ekzekutiv (Hejeti Teftishije), duke i kandiduar deputet për secilin qark administrativ. Pas nëntë ditësh të punimeve, Kongresi IV i Xhemijetit i përfundoi me sukses punimet e tij, duke dalë me vendimin për zgjedhjet parlamentare. Në këtë vendim thuhej: *“Të gjithë myslimanët të dalin në zgjedhjetparlamentare si subjekt i veçantë politiko – fetar dhe si tërësi nacionale.*

*Paszgjedhjeveparlamentare deputetët e Xhemietit të ishin pjesë e përbërëse e Klubit tëRadikalëve*". Ky vendim shihej si kompromis i dy koncepteve të të dy grupimeve që kishin mbretëruar në debatet e punimeve të Kongresit. Po ashtu, një ndër vendimet ishte edhe financimi i gazetës "Hak".<sup>62</sup>

Reaksionet e medimeve të shkruara edhe nga partitë e tjera rreth punimeve të kongresit të Xhemijetit ishin të ndryshme, duke vlerësuar se kalimi nga një organizatë e pastër fetare në një organizatë me synime politike, drejtpërdrejt shihej si rrezik për shtetin. Kishte një pakicë që ishin ithtarë të mendimit ndryshe nga shumica e hierarkisë partiake. Kongresi debatoi edhe për organizatat terroriste të pushtetit si: Bella Ruka, Crna Ruka, etj, të cilat ndihmoheshin tinëzisht nga ushtria, kisha dhe xhandarmëria, për likuidimin e lëvizjes së armatosur shqiptare, të cilën e drejtonte Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës.<sup>63</sup>

Në thirrjen për zgjedhësit potencohen synimet e Xhemijetit:

*1. Zhvillimin arsimor – kulturor të myslimanëve të Serbisë së Jugut, meqë edhe qytetarët e këtij regjioni janë qytetarë të drejtë e luajalë të shtetit.*

*2. Të zgjidhet çështja e reformës agrare në Serbinë e Jugut, siç është rregulluar në htetet e ngritura kulturore me principe moderne dhe sisteme të ndërtuara juridike.*

*3. Të jepen lehtësitë dhe mundësitë prodhuesve të duhanit, në këtë mënyrë të ngrihet njëra e më e rëndësishmja e prodhimtarisë në Serbinë e Jugut, të cilës tash nuk i kushtohet vëmendje e duhur.*

*(Pika e tretë ishte futur në proklamatë, sepse pjesa më e madhe e myslimanëve në Serbinë e Jugut merren me prodhimtarinë e duhanit).*

*4. Edhe myslimanët e Serbisë së Jugut, si qytetarë të barabartë me të tjerët e këtij shteti, ndjeheshin si qytetarë të lirë dhe u garantohen të gjitha të drejtat parashikuara me ligj si qytetarët tjerë.*

*5. Të hiqet anarkia dhe parregullsitë ligjore, të cilat në Serbinë e Jugut ishin përditshmëri.*

---

<sup>62</sup> Skender Asani, Aktiviteti zgjedhor i Xhemijetit gjatë vitit 1923, Studime Albanologjike, nr. 7, 83-89; Hakif Bajrami, *Partia politike "Xhemijet-i" (Bashkimi) në Shqipërinë kontinentale ...*, 96-97.

<sup>63</sup> Skender Asani, Aktiviteti zgjedhor i Xhemijetit gjatë vitit 1923, 84-85, Hakif Bajrami, *Partia politike "Xhemijet-i" (Bashkimi) në Shqipërinë kontinentale ...*, 96-97.

6. *Ndjehet opitimizmi e shpresa që edhe për myslimanët e Serbisë së Jugut do të kenë ditë më të mira.*<sup>64</sup>

Por, edhe pas shpërbërjes së Xhemijetit, udhëheqësit e saj nuk ishin shumë larg regjimit, dhe as që u ndalën t'i "udhëheqin" masat popullore myslimane. Në çdo rast kur Xhemijetit i ofrohej bashkëpunim ose kërkohej nga ajo përkrahje me anë të votave, ajo e shfrytëzonte momentin që të të impononte zbatimin e programit të saj politik. Gjatë kohës në skenën politike, ajo ishte në konflikt të hapur me ideologjinë e majtë (komuniste), dhe këtu qëndron edhe shkaku i përkrahjes nga ana e Partisë Radikale gjatë kohës së themelimit të Xhemijetit, me qëllim që të luftojë kundër Partisë Komuniste.<sup>65</sup>

Menjëherë pas ngadhënjimit të Revolucionit të tetorit në Rusi, në Shkup bëhen përpjekje për formimin e organizatës socialiste. Iniciator për formimin e organizatës socialiste në Shkup (në tërë Maqedoninë) ishte politikani i dalluar Dushan Cekiq, i cili e udhëhiqte Partinë Komuniste në tërë Maqedoninë, Kosovë dhe Sanxhak, por suksesin më të madh siç shkruante gazeta *Socialistička Zora* e arriti në qytetin e Shkupit dhe rrethinën e saj. Organizatorët e Partisë Socialiste në Shkup e hapën shtëpinë komuniste dhe mbajtën Kuvendin e Parë duke zgjedhur udhëheqësinë.<sup>66</sup>

Partia Komuniste në forma të ndryshme mendohej tek shqiptarët të tregonte interesim të dukshëm për çështjen nacionale e në rend të parë për fshatin, "Kush ua merr tokën fshatarëve" duke shfytëzuar gjendjen e vështirë ekonomike, dhunën dhe qëndrimin e padrejtë të administratës ndaj masave të gjëra popullore. I tërë ky aktivitet ndikoi dukshëm që partia të ketë mjaft simpatizues nga rradhët e shqiptarëve të qytetit të Shkupit me rrethinë.<sup>67</sup>

Për shkak të kushteve të vështira ekonomike, dhunës dhe qëndrimit të padrejtë të administratës ndaj popullit shqiptarë, po rekrutoheshin gjithnjë e më tepër të pakënaqur shqiptarë të tjerë ndaj gjendjes egzistuese dhe po këta shqiptarë të pakënaqur hynin në radhët e Partisë Komuniste. Në pozitë të keqe ishin edhe mësuesit përparimtarë, jovetëm në Shkup por edhe në qytetet tjera të Maqedonisë, se arsimit ishte lënëpas dore dhe arsimtarëve nuk u jepeshin rrogat dhe po mbretëronte pasiguri e përgjithshme. Shumë

---

<sup>64</sup> Skender Asani, Aktiviteti zgjedhor i Xhemijetit gjatë vitit 1923, Studime Albanologjike, nr. 7, 83-89.

<sup>65</sup> Надежда Цветковска, *Просветна прилика Вардарска Македонија*, Скопје, 1999, 256.

<sup>66</sup> *Двдесет денови на Скопската Црвена општина*, Скопје, 1970, 14.

<sup>67</sup> *Po aty*, 15-18.

shqiptarë të Shkupit dhe rrethinës ishin antarë Këshillin qendror të Partisë Komuniste si: Ferit Bajrami, Abedin Ymeri, Ekrem Halimi dhe shumë të tjerë si antar të kësaj Partie.<sup>68</sup>

Ferit Bajrami në Shkup kreu detyrën e redaktorit “Socialistička Zora”, po ashtu u mundua për të themeluar organizata socialiste në shumë fshatra të Shkupit, kuptohet në ato vende ku hasi mirkuptim. Sipas veprës monografike “*Дведесет денови на Скопската Црвена Општина*”, Partia Socialiste në Mbledhjet e saj në Shkup dhe rrethinë u bëri thirrje puntorëve që të qëndrojnë në luftën e tyre deri në fund, sepse ka ardhur dita për çlirimin e klasës puntore, prej masave shtypëse të borgjezisë. Pra kjo tregon që edhe populli maqedon dhe shqiptar nuk ishin të kënaçur nga situata e asaj kohe.

Historiografia maqedonase thekson se Partia Socialiste në Shkup shënoi fitore me votat dhe përkrahjen sllavo-maqedone duke mohuar mohojnë se kjo parti fitoi me votat e shumë fshatrave shqiptare të rrethit të Shkupit si dhe qytetit: Qajlanë, Bllacë, Asan Beg, Gazi Babë, vetë rezultatet gjatë votimeve dëshmojnë për pjesmarrjen e shqiptarëve.<sup>69</sup>

Në janarin e vitit 1921 të zgjedhur të Partisë Socialiste nga Aleksandër Bukoviq dhe antarë të saj në komunën e qytetit të Shkupit ishin këto shqiptarë ( nga 36 antar gjithsej të Partisë Socialiste në Shkup 18 ishin shqiptarë): Ahmet Sulejmani poet nga Rashçja, Hasib Sulejmani poet, Beqir Esmeni mulligji, Hajit Ajdini bujk, Mustafa Ameti tregtar, Sadik Nusreti farmacist, Fahri Ismaili industrialist, Zeqirë Aliu arsimtare, Beqir Tefiku ndërtimtar, Rauf Isaku tregtar, Ajrie Jusufi puntore në bankë, Musafije Saliu, mësuese, Ejup Shukriu puntor i muzeut, Mahmud Shukriu këpuctar, Besim Rexhepi puntor në dyqanin e orëve, Asnim Elmazi bujk dhe Ahmet Mehmeti bujk, Beqir Sulejmani tregtar.<sup>70</sup>

Shqiptarët u deshtë që t’u përgjigjen në mënyrë adekuate formave represive që ushtronte sistemi shtetëror: duke vepruar legalisht nëpërmjet Xhemijetit, duke rezistuar nëpërmjet çetave kaçake, dhe duke propaganduar e sensibilizuar çështjen shqiptare në arenën ndërkombëtare nëpërmjet Komitetit të Kosovës me seli në Shkodër. Nga organet zyrtare, Nexhip Draga - president i organizatës myslimane Xhemijeti, cilësohej si njeri me karakter dhe veprimtari antishtetëror. Ndërsa, vëllai i tij, Ferhati, që pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, kishte filluar të punojë hapur për krijimin e Shqipërisë Etnike.

<sup>68</sup> “Социалистичка Зора”, бр.59, 17. VIII. 1920.

<sup>69</sup> “Социалистичка зора”, бр. 64, 25.VIII. 1920.

<sup>70</sup> *Дведесет денови на Скопската црвена општина*, 186-187.

Deputeti i Xhemijetit, Halim bej Deralla, pasqyronte shkaqet dhe motivet e daljes së njësiteve kaçake. Sipas tij, së pari kjo vinte si pasojë e politikës jo të drejtë të pushtetit, përkatësisht për shkak të qëllimit të Reformës Agrare që kolonistëve t'u ndahet toka që ishte pronë e shqiptarëve e që shqiptarët e mbetur pa tokë lehtë u bashkëngjiteshin kaçakëve. Pastaj si shkak tjetër thekson maltretimet, burgosjet nga ana e pushtetit. Shkaqet që i kishte parashtruar deputetit Halim bej Deralla, ishin masa represive që nuk u mbetej fshatarëve alternativë tjetër, të shpërngulen në Shqipëri apo Turqi, apo t'i bashkëngjiten rezistencës së armatosur duke u inkuadruar në Lëvizjen Kaçake.<sup>71</sup>

Lëvizja Kaçake ka pasur çeta të armatosura në rrethin e Shkupit nën udhëheqjen e Adem Bulkut, i cili ishte prej Radushë të Dërvenit. Kjo lëvizje kaçake ishte në kontak të përhershëm me lëvizjet kaçake të Kosovës dhe lëvizjen kaçake të Maqedonisë Perëndimore. Forcat ushtarake në Shkup morrën masa për kryengritësit dhe vendet e përfshira nga kryengritja, në Sfillaren e Epërme në vitin 1921, forcat ushtarake serbe vranë disa fshatarë, shkatëruan disa shtëpi dhe e zunë kurth kryetarine çetës së armatosur Adem Bulku ku e vranë dhe i detyruan që shumë kaçakë të kësaj lëvizje të dorzohen dhe internohen. Me këtë rast ato shkatëruan sa mundën pasuritë e këtij vendi dhe disa kaçakë që arritën të shpëtojnë u larguan.<sup>72</sup>

---

<sup>71</sup> Halim Purellku, *Lëvizja Kaçake në Maqedoninë Perëndimore (1919 – 1927)*, Zvicër, 1991, 9.

<sup>72</sup> Limon Rushiti, *Lëvizja Kaçake në Kosovë (1918-1928)*, në: E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë, 1990, 291.

## Kapitulli II

### II. Pozita e shqiptarëve gjatë Mbretërisë Jugosllave 1929-1941, Shkupi qendër administrative e Banovinës së Vardarit

#### II.1. Ndarja administrative dhe territoriale dhe shqiptarët në Shkup me rrethinë

Situata politike në Mbretërinë SKS gjatë viteve 1918-1929 ishte shumë e paqëndrueshme. Mesatarisht nëçdo pesë muaj ndërrohej një qeveri. Vetëm dy qeveri u shkarkuan si rezultat i humbjes së shumicës parlamentare, kuse 22 qeveri u shkarkuan me dekrete mbretërore të mbretit Aleksandër Karagjergjeviç.<sup>73</sup>

Vlimi mëi madhë popullor kulmin e arriti në vitet 1927-1928 si rezultat i krizës ekonomike dhe politike që kishte pllakosur në këtë mbretëri. I ndodhur në këto kushte dhe duke shfrytëzuar ndikimin e madh që kishte në ushtri, mbreti organizoi grusht-shtet, duke e rrëzuar qeverinë dhe duke vendosur të ashtuquajturën Diktaturë e 6 janarit 1929. Tashmë shteti e ndërroj edhe emrin dhe u quajt Mbretëria e Jugosllavisë. Pasi përkrahësit e tij kryesor ishin oficerët ushtarak dhe borgjezia serbe, mandatin për formimin e qeverisë e mori Gjenerali Zhivkoviç, i cili në 13 janar 1929 formoi qeverinë dhe në paraqitjen e parë deklaroi: “qeveria e re ka për qëllim kryesor të sjell rregullin, rendin dhe diciplinën në administratën shtetërore, që në periudhën më të shkurtër kohore të bëjë sundimin e ligjit në mënyrë të njëjtë në tërë hapsirëne Jugosllavisë, duke vendosur rregull dhe qetësi”.<sup>74</sup>

Me aprovimin e Diktaturës së 6-të Janarit. Atëhere Mbretëria e SKS-së, e ndërroi emrin në Mbretëri Jugosllave, ndërsa teritori i saj, u nda në njësi të reja administrative e territoriale, në banovina, në krye nga një Banin. Kjo ndarje, u bë në harmonizim me Ligjin e datës 03.10.1929. Viti, kur i gjithë shteti u nda në 9 bane. Territori i banovinave në mes të cilave u copëtua vilajeti i Kosovës, sipas Ligjit mbi emrin dhe ndarjen e

<sup>73</sup> Uçesnici i Svedoci, “Zbornik”, Seçanje odelatnosti naprednog učitelstva Jugoslavije do 1914, Tom I-II, Beograd, 1974, 81.

<sup>74</sup> Gezeta “Novosti”, Zagreb, 14.01.1929, 2.

Mbretërisë në njësi administrative ishte i ndarë në mes Baneve të Vardarit, Zetës dhe Moravës.<sup>75</sup>

Mbreti formoi qeverinë e parë, në krye me Gjeneral Zhivkoviçin, i cili më 13 janar 1929, deklaroi se “Qeveria ka qëllim kryesor, të sjell rend, rregull dhe disiplinë në administratën shtetërore, që në përdhë më të shkurtë, të bëjë barazimin Ligjit në tërë hapësirën jugosllave, dhe me te, të siguroj kushte të plota të sigurisë dhe të sistemit”.<sup>76</sup>

Mbreti miratoi Kushtetutën e vitit 1931, ndërsa aparati shtetëror u nda në tri pjesë, pushteti organizohej sipas parimeve të burokratizmit-centralist, ndërsa, Çështjen Nacionale nuk e ceku as kushtetuta e tij, ngjashëm si Kushtetuta e Vidovdanit 1921. Me themelimin e Mbretërisë Jugosllave, shteti u nda në 9-të Banovina, kurse banovinat në rrethe dhe komuna.<sup>77</sup>

Sipas kushtetutës së vitit 1931 shteti ndahej në 9 njësi të reja administrative territorial të quajtura Banovina, kurse pushteti ishte i ndarë në tre pushtete legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori. Banovinat ndaheshin në rrethe e komuna. Në krye të Banovinave qëndronin Banët, të cilët emëroheshin drejtpërdrejt nga mbreti.

Në krye të Banovinës së Vardarit me qendër në Shkup, u emërua bani Zhika Llaziqi<sup>78</sup>, i cili me origjinë ishte nga qarku i Tetovës dhe më pare kishte provuar thujtë të gjitha postet udhëheqëse në administratën shtetërore. Banovina e Vardarit, kishte një sipërfaqe të përgjithshme prej 36.672 km<sup>2</sup> me 1.574.243 banorë me dendësi mesatare të popullsisë prej 42.9 banorë në 1 km<sup>2</sup>.<sup>79</sup>

Ndërrimet më të mëdha, sa i përket territorit të Kosovës, u bënë me Ligjin e datës: 09.09.1931, që nga shteti ishte proklamuar si ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për ndarjen e shtetit në banovina të datës: 03.10.1929.<sup>80</sup>

Për strukturën e popullsisë së këtij viti, nuk mund të bëhej fjalë, ngase në regjistrim jepeshin të dhëna vetëm sipas përkatësisë fetare. Gjithashtu relative, ishte edhe numri i popullsisë, nga shkak se, në një anë bëhej shpërngulja e popullsisë shqiptare nga Kosova, kurse në anën tjetër shtohej elementi sllav si rezultat i kolonizimit. Sipas të

<sup>75</sup> Branko Petranoviç-Momçillo Zeçeviç, *Jugoslovenski federalizam idje i stvarnost*, 1914-1943, Beograd 1987, 287. Proklamacioni i Mbretit Aleksandër, më 6 njanar 1929.

<sup>76</sup> “Novosti Zagreb, 14 sijeçna 1929.

<sup>77</sup> Almanah, *Vardarska banovina*, Beograd, 1931, 9.

<sup>78</sup> Македонски Архив, Скопје, Материали јужни преглед, бр. 19, кут.9,30.

<sup>79</sup> Statistički Godinskiak 1931, Beograd, 1934.

<sup>80</sup> “Sluzbene Novine”, *Kralevine Jugosllavije*, 5.X.1929.

dhënave të vitit 1930, Banovina e Vardarit me sipërfaqe të përgjithshme prej 36.672 km<sup>2</sup> me 1.574.243 banorë me dendësi mesatare të banorëve prej 42,9 në një km<sup>2</sup>.<sup>81</sup>

Me ndryshimet e fundit territoriale-administrative, sipas Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit të vitit 1929 u bë edhe ndarja e teritoreve të banovinave në rrethe e komuna. Në rregullimin dhe pushtetin e organeve të brendshme shtetërore të Mbretërisë së Jugosllavisë, merrnin pjesë policia dhe xhandarmëria. Këto organe ishin të vendosura me seli në Shkup. Policia ishte organ dhe institucion nën kontrollin e kësaj ministrie. Xhandarmëria ishte organ i themeluar nga personeli ushtarak nën kontrollin e MPB, por të gjitha urdhrat i merrte dhe i'u nënshtrohej ligjeve të Ministrisë së Mbrojtjes. Pas shpalljes së Diktaturës, bëhet ndërimi i rregullimit të këtij organi. Sipas ligjit në fjalë, ky ishte organ për sigurinë publike dhe organ ndihmës i pushtetit të brendshëm për mbajtjen e rendit dhe ruajtjen e barazisë së interesave të rendit ekzistues shtetëror.<sup>82</sup>

Xhandarmëria ishte pjesë përbërëse e ushtrisë. Në pikëpamje të disiplinës së marrëdhënieve personale të edukimit i nënshtrohej Ministrisë së Ushtrisë. Sipas këtij Ligji, Xhandarmëria ishte organ policor, vepronte në suazat e komunës, rrethit, banovinës etj, e nënshtroar para organeve gjegjëse administrative, dhe kishte karakter ushtarak. Përveç xhandarmërisë, në Shkup ekzistonte edhe policia komunale. Ky organ shtetëror shërbente për sigurimin e rendit publik brenda në qytete, të cilin pjesërisht e financonte komuna, që ligjërisht ishte e detyruar t'ia sigurojë të gjitha mjetet për punë të suksesshme. Kjo çështje rregullohej me nenin 66, paragrafi 57 i ligjit në fjalë Mënyrën e bashkëpunimit, vëllimin e saj në mes të policisë komunale dhe xhandarmërisë e caktonte organi më i lartë se komuna e rrethit bani, përfaqësuesi i Banovinës.<sup>83</sup>

Për rregullimin e brendshëm, respektivisht, për mbajtjen e rendit publik, me dekretligjin e 4 nëntorit 1929, me numër protokoli 49106, ishin themeluar drejtoritë e policisë së qyteteve. Në Banovinën e Vardarit, drejtori të tilla u formuan: në Prishtinë dhe Prizren. Veprimtaria e drejtorisë të policisë së qyteteve e përcaktonte Dekretligji i MPB të dates 8.10.1929, të cilin organ së shpejti e shujtën vetë pushtet mbajtësit, e abroguan me Ligjin e dates 31.10.1929, me ligjin mbi drejtorisë së Banovinës.<sup>84</sup>

---

<sup>81</sup> *Staticki Godisnjak 1931*, Beograd, 1934.

<sup>82</sup> "Sluzbene Novine", 6.I.1929.

<sup>83</sup> *Zakon o unutrashnjoj upravi 1929*, Beograd 1932.

<sup>84</sup> "Sluzbene Novine", 17. XI. 1929.



Në kuadër të banovinave, themeloheshin drejtoritë e policisë, të cilat paraqitnin pushtetin e përgjithshëm të shkallës së parë. shtrirja territoriale rregullohej me nenin 85 të Kushtetutës së vitit 193 me nenin 50 të Ligjit mbi rregullimin e brendshëm.

Funksionet e kësaj Drejtorie, ishin të shumëllojshme si: funksioni reprezentativ, drejtues, mbikëqyrës, funksionimi dënues-policor, funksionimi përfaqësues i pushtetit në rrethe, organ i administratës shtetërore, përfaqësues i pushtetit në popull dhe njëkohësisht ndërmjetësues në mes popullit dhe shtetit. Ky funksionim i tillë, kishte për detyrë të përcjellë gjendjen e popullit dhe kërkesat e tij në lidhje me çështjet ekonomike, sociale dhe kulturore, krejt këto ishin dhe qëllimet e tyre politike, të përcjellin dhe situatën politike të popullit ndaj organeve të pushtetit. Drejtoritë policore në qarqe, ishin organ kolektiv, veç punëve të përgjithshme, kishin edhe tribuna të posaçme të ndara si p.sh. për politikën sociale, teknike, arsimore, veterinari, ekonomi, pylltari etj. Kurse në rrethe me territor më të gjerë, mund të themeloheshin përfaqësitë e tyre, sipas propozimit të Banit. Vendimin për formimin e këtyre përfaqësive e merrte Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e financave, Vendimin duhej ta aprovonte Këshilli Ministror.<sup>85</sup>

Drejtoritë e policisë, gati menjëherë më vitin 1931 filluan të abrogohen në disa vende. Abrogimin e tyre e para shihte neni 55 i Ligjit mbi Rregullimin e Brendshëm. Me vendimin e Këshillit Ministror, në kërkesën e MPB, më dhjetor 1931, u abroguan disa drejtori të policisë, së pari në zonat kufitare, ku konsiderohej se regjimi nuk ishte në rrezik, ku kishte numër të madh të xhandarmerisë dhe të ushtrisë. Funksionin, derisa këtyre drejtorive, iu ngarkua xhandarmerisë, në bazë të Rregullores e cila u proklamua për këtë çështje.<sup>86</sup>

Inspektoratet u themeluan në bazë të Vendimit të MPB, paragrafit 20-22, të Ligjit për emërimin dhe ndarjen e mbretërisë në krahina sunduese-banovina e shpallur më 23.X.1929. Ishin këto organe ndihmëse të Banit, në të gjitha punët e sigurisë publike, në lëmin e inspektimit. Si organ i lartë shtetëror inspektoratet ishin të obliguar të kujdesen për sigurinë publike, të bëjnë kontroll në kryerjen e detyrave në të gjitha organet shtetërore, nga banovina e deri në komunë, të japin udhëzime për kryerjen e detyrës, kishin të drejtë, kurdo të bëjnë kontroll, për të gjitha ato organe që ishin nën kontrollin

<sup>85</sup> “*Sluzbene Novine*” 250, 25.II.1929.

<sup>86</sup> “*Sluzbene Novine*”, 29.I.1932; 17. II.1932.

e tyre. Si organ shtetëror kishte për detyrë të inspektoi-kontrolloi punën e organeve të punëve të brendshme, financave dhe të ndihmojë në kryerjen e kësaj detyre, nga banovina e deri në komunë.

Si organ kontrollues i organeve të punëve të brendshme, puna e tij që e përkohshme, analoge me drejtoratet e policisë. Kështu me pëlqimin e kontrollit kryesor MPB, në mars të vitit 1934 miratoi Vendimin për anulimin e disa inspektorateve në disa banovina. Vendimi i përmendur më parë u miratua në bazë të nenit 20 të Ligjit për ndarjen dhe emërimin e mbretërisë së Jugosllavisë në banovina.<sup>87</sup>

Nga viti 1930, filloi nderimi i toponimeve të vendbanimeve fshatrave, të selive të komunave dhe më gjerë, duke e paraqitur çdo veprim të tyre, si dëshirë e popullit. Rëndësia historiografike e emërtimeve të rij, të në faktin se edhe sot disa toponime shqiptare, i njohim sipas ndërrimeve të tyre, ndërsa në popull edhe tash ruhen emrat e vjetër. Në anën tjetër, rëndësia e emërtimeve të reja ishte se synohej zhdukja e emrave të lashtë të toponimisë shqipe. Procesi i ri emërtimeve dhe i emërtimeve kishte rrugën e tij normative-ligjore. Në arsyetime gjithnjë paraqitej si dëshirë e popullit. Këto aprovoreshin në bazë të Rregullores së datës: 12 Shkurtit 1929, së cilës iu dha dekreti i Ligjit më: 14 Maj 1931, kur u publikua në nr. 107 të “Gazetës Zyrtare” në vitin 1933, hyri në fuqi si paragraf i veçantë në Ligjin për Rregullimin e Komunave.

Riemërtimet e reja me kuptim sllav, fillojnë në mënyrë të organizuar administrative, kryesisht nga viti 1930. Pra, para kësaj periudhë të përmendur më lartë, nuk kishte ndonjë normë ligjore për këtë qëllim. Riemërtimet para vitit 1929 mund të konsiderojmë se ishin vepër për qëllime politike të caktuara, sepse bëheshin sipas dëshirës dhe vullnetit të personave administrativ. Organ kompetent për inicimin dhe paraqitjen e kërkesës, për ndërrimin, riemërtimin e ndonjë vendbanimi, ishte MPB, e cila kërkesën ia dorëzonte Komisionit shtetërorë pranë kësaj ministrie.

---

<sup>87</sup> “*Sluzbene Novine*”, 21.III.1934.

## II.2. Gjendja ekonomike e shqiptarëve në Shkup me rrethinë

Mbretërinë e Jugosllavisë karakterizonte zhvillim jo të barabartë ekonomik në të gjitha krahinat, posaçërisht për vendet jugore në Banovinën e Vardarit ishte vend i prapambetur në pikëpamje ekonomike, edhe pse ishte, vend agrar, ngjajshëm karakterizohej Kosova dhe Maqedonia. Terrori policor ishte drejtuar para së gjithash kundër forcave demokratike, në radhë të parë ishte kundër Partisë Komuniste. Në Mbretërinë Jugosllave, bartës kryesor i diktaturës, ishte ushtria dhe policia, përmes tyre ndalohej çfarëdo lëvizje edhe të partive borgjeze në Mbretërinë Jugosllave.

Borgjezia serbo madhe, nuk mbante llogari për problemet sociale, as për zgjidhjen e kësaj çështjeje por në mënyrë të pa ligjshme pasurohej në llogari të saj duke shfrytëzuar djersën dhe vobektësinë e masave të gjëra popullore, ndërsa rrethanat e popullsisë së kësaj ane si në aspektin ekonomik-politikë, ishin jashtëzakonisht të rënda. Mbretëria Jugosllave, kishte qëllime ekspansioniste, prandaj fare nuk donte të kujdesej për këto anë, me pretekst “*viset jugore*”, klika jugosllave, këto treva i trajtonte si koloni të Mbretërisë së saj. Prandaj edhe kujdesi i saj, për përmirësimin e kushteve ekonomike ishte në nivel shumë të ulët, faktë që dëshmon edhe fakti se gjatë periudhës (1929-1938) profiti industrial në Serbi u rrit për 44%, kurse në Banovinën e Vardarit vetëm 8%.<sup>88</sup>

Bujqësia, në kontinuitet, mbeti veprimtaria kryesore ekonomike e popullsisë në Banovinën e Vardarit edhe pse ajo ishte dega kryesore, teknika e punës ishte klasike, me parmenda të vjetra që tërhiqeshin nga kafshët. Lëvrimi i tokës, bëhej cekët, ndërsa plehu artificial, akoma ishte, mjet kimik i panjohur për fshatarët, karakteristikë e një produkti prodhimi tepër të ulët të prodhimeve bujqësore. Edhe pse për punët bujqësore, angazhoheshin të gjithë anëtarët e familjes të aftë për punë, në të shumtën e rasteve drithi nuk u mjaftonte. Një numër i madhë i popullatës, nuk mund ta siguronte ushqimin, detyrohej të emigroj në vendet e jashtme, përmes një migrimi, të brendshëm ekonomik në Maqedoni “kurbeti”. Prodhimi kryesor në Banovinën e Vardarit ishte duhani, i cili arriti sasinë, mbi rreth 50% të prodhimit global prodhuar në Jugosllavi.<sup>89</sup>

<sup>88</sup> Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë 1918-1941*, 14.

<sup>89</sup> *Historia e popullit maqedonas*, 229.

Ajo për kultivimin e kësaj kulture, parashifte masa rigoroze, gjoba të larta për prodhuesit e duhanit, që tentonin të fshehin prodhimin e përgjithshëm. Me këtë veprim rigoroz të organeve në pushtet gjithnjë e më shumë vështirësohej jeta e fshatarit nga kontrollimet e shpeshta, nga gjobat drastike që aprovonte xhandarmëria. Kjo politikë e dëmshme e monopolit shtetëror, lidhur me këtë prodhim duhanor të rëndësishëm, paraqitej në disa sanksione kufizonte sipërfaqet e mbyllura me duhan, ku çmimin e caktonte Monopoli shtetëror. Çmimin blerës për 1 kg duhan në vitin 1929, kishte vlerë në sasi prej 38,61 dinarë, në vitin 1932, vlersohej 1.kg 8,15 dinarë, në vitin 1933, 1kg duhan me çmim prej 7,24 dinarë. Duhanhinjtë, nga prodhimi i duhanit nuk pritnin profite të mëdha, por kultivuesit, kishin, vetëm profit sa përmbajtjen e familjes. Por masat e ashpra kontrolluese nga pushtetarët, i shtyri prodhuesit shqiptarë që pas vitit 1937, ta zvogëlojnë prodhimin duhanor në Banovinën e Vardarit. Në një sipërfaqe prej 7 mijë hektar ose për 31%, të kultivuar me të gjitha prodhimt industriale të "Serbisë së Jugut". Me prodhimin e duhanit, më tepër merrej popullsia fshatare, pasi posedonin parcela të vogla të tokës. Në rend të dytë vinin banorët qytetas, të cilët prodhonin duhan, se prore ishin të varfëruar ekonomikisht të shkatërruar. Në këtë grup hynin, pjesa dërmuese e zanatlinjëve dhe tregtarëve të imtë, dhe një numër jo i vogël i atyre e kishin gjendjen e mirë ekonomike, si mbjellës të duhanit, kurse fshatarët globalishtë, nuk e kishin gjendjen e lakmueshme ekonomike.<sup>90</sup>

Prodhimi duhanit, ishte veprimtari tejet e rëndë sepse kërkonte angazhim gjithë familjar. Ky prodhim i rëndë, paguhej 3 denarë për 1kg, kurse atë kohë me 3 denarë, mund të blihej vetëm 1kg bukë. Monopoli shtetëror, i diktonte çmimet, përcaktonte kualitetin e mallit, kushtet e mbledhjes, kështu ishte i lirë që të manipulojë në dëm të prodhuesit kur të dojë.<sup>91</sup>

Vetë Monopoli kur nuk mund ta plasonte mallin qoftë në tregjet e jashtme, ose plasohej dobët, të njejtin prodhim edhe në tregun e vendit nuk mund ta shpenzonte, prandaj pronari kryesor mu për këtë Monopoli shtetëror tepër i vështirësoi kushtet dhe i zvogëloi çmimet sa që duhani blihej gati pa para, pa çmimi të volitshëm.<sup>92</sup>

---

<sup>90</sup> "Glas Polloga", 18.IX.1937, 4.

<sup>91</sup> Uçesnici i svedoci, v. II, 576.

<sup>92</sup> "Tetovske Novine", 15.XI.1934, 1.

Situatën ekonomike, e keqësonte më shumë situata e vështirë politike, pa kujdesia e shtetit ndaj prodhuesve bujqësor, mbjellja e prodhimeve pa planë, pasiviteti ekonomik, obligimet e tepruara pa kontroll, ndaj të dhënave fshatare (taksa-paguese). Në gjendjen e vështirë ekonomike të popullsisë, ndikonin tishitë si shtypja nacionale, ndjekjet, zvogëlimi i parcelave të tokës, rritja e numrit të njerëzve të patokë, punëtorë me mëditje etj. Toka të punëshme kishte shumë pak, në krahasim me livadhet, kullotat që kishin përfshirë një sipërfaqe prej 56,25% hektar. Pas bujqësisë, blegtoria si degë kryesore e popullsisë të kësaj ane, edhe pse kushtet kanë qenë të volitshme për ruajtjen e kafshëve të imta dhitë, posaçërisht dhentë, të cilët deri diku ishin të zhvilluar. Treva e Sharrit e njohur me eksportimin e mishit, leshit dhe lëkurës. Prej drithërave, më tepër mbjellëshin gruri, thekri dhe misri. Këto prodhime me kualitet tepër të dobët, në sipërfaqe kaq të vogël e tokave të poseduara, nuk mund të furnizonte as gjysmën e popullsisë të këtyre treve.<sup>93</sup>

Fuqia e tepërt punëtore, që nuk kishte ku të punësohej, çdo ditë dilnin në qendër të qytetit me lopata ekazma në dorë dhe pritnin, kush do ti angazhoj, që të shkojnë argat, për të nxjerr kafshatën e bukës, bile pajtoheshin të punojnë në vreshta për 6-10 dinarë në ditë.<sup>94</sup>

Në kushte të vështira, të pa durueshme pune, pasi punonin me mëditje shumë të ultë, orari i punës ishte tepër i gjatë, jashtë dipozitave të parapara, kurse kushtet e banimit dhe ato higjienike ishin në nivel.

Sipas disa të dhënave të revistës "Grafiçar" për standardin e punëtorëve në të cilën gazetë citohej: "Sipas disa grupeve mëditjet e punëtorëve kishin rënie në vitin 1935 në krahasim me vitin 1931 gati 100%".<sup>95</sup>

Qarqet sunduese të borgjezisë serbomadhe, ishin të vetëdijshëm, se eliminimi i kushteve materiale të jetesës, përmes politikës së diskriminimit ekonomik, ishte mënyra më e përsosur e presionit ndaj masave shqiptare. Prandaj ato merrnin në mënyrë permanente, masa të presionit ekonomik, me qëllim që shqiptarët si element jo sllav të largohen nga toka e Jugosllavisë.

---

<sup>93</sup>Pançe Kirovski, *Tetovo i tetovsko niz isorijata*, Tetovo, 1982, 16.

<sup>94</sup>*Uçesnici i svedoci*, 209.

<sup>95</sup>Gazeta "Grafiçar", Beograd, 24 V. 1938, 7.

Për këtë varfëri, që kishte kapluar popullsinë e kësaj ane, borgjezia serbe, mundohej të bind opinionin dhe tua hedh fajin shqiptarëve dhe turqve për kokëfortësinë dhe mentalitetin e pa ndryshuar. Kështu gazeta borgjeze "Radikal" shkruante: *"te shqiptarët shumë nën nivel të ulët, është i zhvilluar koncepti i jetës kolektive, në një shtet te ata mbizotëron liria individuale, e cila është shumë e zhvilluar"*.<sup>96</sup>

Në frymën e politikës hegjemoniste të regjimit tendencioz ndaj shqiptarëve, këta punëtorë trajtoheshin si qenie e ultë dhe krahasoheshin me zezakët e vendeve imperialiste. Emri shqiptarë, për borgjezinë serbomadhe, ishte sinonim për punë të rënda fizike duke e krahasuar me të sharraxhiut, pastruesin e rrugëve dhe të kanalizimit. Një ndër metodat më të ashpra, nga ana e qarqeve sunduese, eksploatuese, realizohej me politikën tatimore dhe tatimet shtesë. Me zbatimin e kësaj politike, bëheshin keqpërdorime duke shfrytëzuar paditurinë dhe varfërinë e shqiptarëve. Tagrambledhësit, i shtonin tatimet në mbështetje të regjistrimit të rrejshëm të kualitetit të tokës.<sup>97</sup>

Karakteristikat e përgjithshme të administratës shtetërore, në trevat ku jetonin shqiptarët, ishte korrupsioni, gati asnjë lutje apo kërkesë e qytetarëve nuk zgjidhej pa dhënë ndonjë denarë. Në këtë periudhë, qarqet sunduese borgjeze shpresonin se me presion politiko-ekonomik ndaj popullit shqiptar, me kolonizimin permanent të vendeve ku banonte, ajo arriti të ndërroj strukturën nacionale të popullsisë, në dëm të popullatës shqiptare, me anë të asimilimit, pritnin të bënin nacionalizimin e tokës së popullsisë shqiptare. Ky terror, praktikohet në sundimit të Mbretërisë Jugosllave. Gjorgje Krstiq, ideolog i reformës agrare për Kosovë dhe Maqedoni, flet haptazi për esencën nacionaliste dhe shoviniste të Reformës agrare, dhe për kolonizim. Ai, vë në dukje, se sa ka ndihmuar kolonizimin, për ndërrimin e strukturës nacionale të popullsisë në Kosovë e Maqedoni.<sup>98</sup>

Ekonomia, ishte pjesa më e ndërlikuar mes shoqërisë ndaj raporteve natyrore gjeografike, të cilat në mënyrë të drejtë, ndikoj në zhvillimin e hapësirave të caktuara. Ekonomia paraqitej prodhimin dhe vlerat e zhvillimit bashkë me mjetet që posedonte Shkupi me rrethinë.

---

<sup>96</sup> Gazeta "Radikal", Beograd, 6.I.1922.

<sup>97</sup> Hajredin Hoxha, *Elemente të presionit ekonomik ndaj shqiptarëve në Jugosllavinë e vjetër*, në: "Përparimi", nr. 4 viti XVI, Prishtinë 1970, 309-312.

<sup>98</sup> Милован Обрадович, *Аграрна реформа и колонизација на Косово 1918-1941*, 175.

**Bujqësia:** Ligji mbi kolonizimin e krahinave të jugut më 11 qershor 1931, në pjesën dërmuese, ruajti të njëjtën strukturë. Drejtoria e Lartë Agrare e Shkupit, mbeti organi kryesor Ministrisë së Bujqësisë në trevat shqiptare, gjatë viteve të 30-ta, funksiononin 12-të Drejtori, 6-të Drejtori qarqesh, të cilat kishin Komisionet e tyre në terren, merreshin me konfiskimin, ndarjen të tokës për qëllim kolonizimi. Ky Ligj i 11 qershorit, u hoqi atyre të drejtën, për të qenë anëtarë me kompetenca të njëjta krahas të mëshmit, andaj në këtë mënyrë fshatrat e rrethinës së Shkupit, dhe të krahinave: Derven, Karshiakë, Mali i zi i Shkupit, humbën edhe mundësinë ligjore, që me anë të përfaqësuesve të tyre, qoftë edhe formal, të mund të kenë ndikim në pronat tokësore. Në vitin 1933, pas miratimit të Ligjit mbi rregullimin e marrëdhënieve agrare në Banovinën e Vardarit, nuk ndryshoi aspak në pronësinë e tokave, në duart e bujkut për vitin 1934. Gjykata e lartë, me qendër në Shkup, themeloi Gjykata agrare të rretheve, të cilat nuk ishin të qëndrueshme, duke realizuar kërkesat e tyre, në komunat përkatëse, duke bërë verifikimin e pronave tokësore, të cilat toka i klasifikonin, dhe i kategorizonin. Kjo metodë reformuese e ligjeve të miratuar, vepronin në anën e kundërt ndaj popullatës shqiptare, me qëllim që përmes kësaj forme tu merrej josllavëve toka.<sup>99</sup>

Fshatrat e rrethinës së Shkupit, në përgjithësi dominonte prodhimi natyror ku shihej qartë, se ishte një regres i madh ekonomik, por nuk duhet harruar faktin, se kishte kushte të përshtatshme natyrore e demografike për zhvillimin ekonomik të Shkupit me rrethinë. Qyteti i Shkupit dhe rrethinë, pati bujqësi të regressive, sipas të dhënave mbi 90% e popullatës fshatare merreshin me bujqësi, por produktiviteti i punës, ishte në nivel të ulët. Degë kryesore e ekonomisë kishte bujqësinë, ky vend prodhonte drithëra, me sasi shumë të vogël, me një zhvillim të vogël në Shkup me rrethin gjatë periudhës (1929-1940). Për lëvrimin e tokës, bujqit ruanin kafshë shtëpiak qe, kuaj për tërheqjen e plugut. Këto, ishin mjetet primitive me të cilat punohej toka dhe mbjelljet, bëheshin në çdo pëllëmbë të tij. Mbjellja e tokës, paraqite sigurinë familjare të kafshatës së bukës, dhe më së shumti mbjellnin të lashtat: misër, grurë, elb, tërshërë, thekër.<sup>100</sup>

<sup>99</sup> Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë 1918-1941*, 110-111.

<sup>100</sup> Baki Bakiu, *Derveni i Shkupit ndër shekuj*, Shkup 2011, f.82; Jovan Trifunovski, *Skopski derven*, Skopje, 374-378

Punimi i tokës ku mbjellin misër, kultivimi i tij bëhej me shatë, ndërsa korrja e grurit, bëhej me drapër, ndërsa tokat pjellore të mbjella, shtriheshin në anën e majtë dhe të djathtë të lumejnjëve Vardar, Treskë, dhe Lepencë. Bujqësia, ishte profesioni kryesor i fshatrave të Shkupit, se mbijetesa e tyre varej prej saj, mirëpo, siguria bujqësore, asnjëherë nuk ishte e siguruar, shkas nga dhuna, terri serb, nga një terror i tillë, kishte familje që tokën e linin të mbjellur, dhe iknin në Turqi, familje të tëra shqiptare nga gjithë rajoni i Shkupit.<sup>101</sup>

**Pemtaria:** Zhvillimi i pemëtarisë edhe vreshtarisë, si degë të ekonomisë, më së shumti kultivonin kumbulla, dardha, qershia, vishnja, arra, ftonj, mushmolla dhe man. Këto pemë janë përdorur si ushqime të freskëta, janë konservuar ndërsa vreshtaria në territorin e Shkupit me rrethinë, ishte fare pak e kultivuar, edhe pse kishte kushte të përshtatshme për këtë degë ekonomike. Atëhere, rrallë familje posedonin vreshta, kjo kulturë u zhvillua pas Luftës së Dytë Botërore, ndërsa, prodhimtari industriale në periudhën (1929-1941), filloi të kultivohej duhani.

**Blegtoria:** Degë tjetër e veçantë e ekonomisë ishte blegtoria. Shkupi me rrethinë, kishte kushte të përshtatshme dhe të mira, për zhvillimin e blegtorisë, andaj krahinat e Shkupit kanë pasur profesion kryesor blegtorinë, sepse Shkupi me rrethinë, i mbuluar me male siç janë: Mali Zheden, Mali i Thatë, Mali Vodno, Mali I Zi i Shkupit dhe Kodrina tjera malore, që janë të pasura me kullota të pasura, me kushte të volitshme, edhe në Mbretërinë Jugosllave. Qysh më herët, popullata është marrë me blegtori, nga bagëtitë ruanin: kope dhensh, lopë dhe dhi, e ato që i ruanin quheshin barinj ose çobanë, por kur kishin numër të madh të lopëve, ato paguanin çobanë shtesë, kurse gjatë stinës së dimrit ato i ruanin në shtëpi, ndërsa në pranverë i dërgonin në stane, pas larjes së dhëve, bënin edhe qethjen e tyre dy herë në vjet, ndërsa ato që ruanin lopë nëpër fshatra, blegtoria, bëhej në aspekt të organizuar, ata paguanin një person, i cili ishte tejet i varfër, që ti ruante lopët, i cili quhej Lopar “Govadarë”. Fshatarët blegtoral, nga ruajtja e dhëve edhe lopëve, ato përfitonin qumështin dhe prodhimet tjera qumështore, mishin, leshin dhe lëkurën që përdreshin për veshmbathje ndërsa shitja e qingjeve në muajin prill kishte fitime të mira.

---

<sup>101</sup> Александер Апостолов, *Колонизацијата на македонија во стара Југославија*, 114-117.



**Tregtia:** Në jetën e përditshme, rëndësi të veçantë ka pasur tregtia në Shkup me rrethinë, e cila përfshinte shpërndarjen dhe këmbimin e mallrave në qytetin e Shkupit, në pikëpamje të shumtë, tregtohej edhe pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, të cilën ja mundësoi Çarshia dhe tregu i Bit Pazari. Aty vinin tregtarët nga fshatrat e rrethit të Shkupit, shitnin mallrat e tyre edhe në dyqanet modeste, prej të cilëve, fshatarët furnizoheshin me artikujt e tyre ushqimor dhe higjienikë me sapuna, gazë, vaj llambe, kripë, sheqer, vajguri për ndriçim etj. Por në këto dyqane mund të shitnin gjithçka edhe nga prodhimet e tyre bujqësore si: drithë, groshë dhe vezë, ndërsa gjatë stinës së verës shitë-blenindomate, speca, patate etj. Tregtia çdo herë ishte prezente në qytetin e Shkupit edhe me tregtimin bujqësor-blegtoral, rëndësi kishin edhe prodhimet industriale, ku ishte bërë tregti me duhan si fshatra të njohur të duhanit ishin: Rashçe, Kopanicë, Luboten, Nakushtak, Studeniçan, ndërsa tregtarët e largëm, vendoseshin nëpër hanet më të njohura: Kurshum-Han dhe Kapan-Han.<sup>102</sup>

**Zejtaria:** Qyteti i Shkupit dhe çarshia e tij, ishin baza kryesore e zhvillimit të zejtarisë për rrethinën e tij, por edhe më gjërë. Çarshia e Shkupit, kishte shumë dyqane dhe qyteti ishte i ndërtuar me rrugë të ngushta të shtruara me pllaka guri dhe me mure të thjeshta, nëpër çarshi kishte pastërti, ndërsa lokalet e zejtarëve të Çarshisë së tij, ishin locuar aty ku janë dhe sot, ku shitnin prodhimet e tyre nga metali, për nevojat e përditshme shoqërore si: plug, shatë, dara, shoshë, dermane, nga prodhimet e drunjtja blenin: bishta për mjetet e punës dhe mjetet tjera bujqësore. Zejtarët shitnin stoli ari dhe argjendi, për nevoja fejesash e martesash. Fal pozitës strategjike të Shkupit, këtu vinin blerës nga anët tjera singa Kosova, Presheva, Tetova, Velesi etj. Tregtarët zejtarët shkupjanë, u shërbenin me materiale, me profite jo aq të mëdha, se politika dhe ekonomia nuk ishte stabile në periudhën e lartë shënuar (1929-1941). Zejtarët ishin esnaf dhe kishin të emëruar kryetarin e esnafëve, këto zejtar, kishin edhe çirakun apo çirakët e tyre, për të mësuar zanatet e zejtarisë.<sup>103</sup>

---

<sup>102</sup> Baki Bakiu, *Derveni i Shkupit ndër shekuj*, 87; Алла Качева, Славица Христова, Татјана Ѓорѓиовска, *Животот во Скопје 1918-1941*, Скопје, 2002, 111-128.

<sup>103</sup> Свето Стаменов, Искра Чоловиќ, Хорбај Драшко, Киро Попов, *Погледа врз стара Скопска Чаршија*, Скопје, 1997, 20-24; Јован ХаћиВасињевиќ, *Скопје и негова околина*, Београд, 1930, 84-124

**Kopshtaria:** Kopshtaria (pemëtaria) në pjesën dërmuese, u zhvillua rreth luginës Vardar e Lepencë, një ndër aktivitetet bujqësore në Shkup me rrethinë, posaçërisht në krahinën e Dervenit të Karshiakës, të Malit të Zi (Shkup) në disa vendbanime buzë lumit Vardar e Treskë dhe në anën tjetër të Lepenecit, kishte zhvillim kultivimin e perimtarisë. Perimet që i ka kultivuar Shkupi me rrethinë, ishin: patatja domatja, speci, lakra, qepa, hudhra, preshi, kungulli, shalqiri. Kjo degë e ekonomisë, më së shumti kultivohej për nevojat personale, për t'i ngrënë të freskëta dhe të konservuara dhe turshi për dimër. Fshatrat e krahinës së Shkupit, kultivonin edhe për qëllime komerciale, ata prodhonin me tepriçë, andaj këto i shitnin në tregun e qytetit, kurse profiti i fituar u shërbente sa për nevojat familjare.

### **II.3. Pozita politike e shqiptarëve në Shkup me rrethinë gjatë viteve 1929- 1941**

Mbreti Aleksandër, bëri grusht shtet, më 6 janar 1929 anuloi Kushtetutën e vitit 1921, shpërndau Kuvendin Popullor, dhe Mbreti u bë pushtetmbajtës kryesor, duke zbatuar ekzekutivin diktatorial. Ekzekutivi i tij në histori, njihet si periudha më e vështirë për popullatën shqiptare të Shkupit me rrethinë, atë vit, partitë e hegjemonisë serbe, si Partia Radikale, Partia Demokratike, të cilat shprehnin qartë idenë për krijimin e Serbisë së Madhe. Gjatë kësaj periudhe, vepruan edhe Partia Katundare Kroate, Partia e Pavarur Demokrate, Partia e Klerit Slloven, u krijuan dy qendra të mëdha opozitare, njëra në Beograd e tjetra në Zagreb. Kjo diktaturë, solli gjendjen më të rëndë, si në aspekt politik, ekonomik dhe në aspektin social në Shkup me rrethinë, gjendjen e rëndë, e përjetoi tepër popullata shqiptare.<sup>104</sup>

Pas vrasjes së tij pushtetin e trashëgon djali i tij Petri II-të, i mitur, ndërsa mbikëqyrës mbretëror ishte Pavle Karagjergjoviqi. Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 1935, në krye të qeverisë së saj, erdhi Millan Stojadinoviqi dhe Dragash Cvetkoviqi, në qeveri, u aprovua Programi i tretë, për shpërnguljen e popullatës shqiptare, i krijuar nga

---

<sup>104</sup> Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë 1918-1941*, 246-260; *Historia e popullit maqedonas*, 178.

Vasa Çubrolloviqit të vitin 1937, ndërsa ngjarje me rëndësi ishte se, kjo qeveri nënshkroi Marrëveshjen jugosllave-turke, në vitin 1938 për shpërnguljen e popullatës shqiptare nga të gjitha trevat e Mbretërisë Jugosllave.<sup>105</sup>

Po ashtu gjendje të vështirë e përjetoi Krahina e Dervenit, Karshiakës, Malit të Zi (Shkup) vet qyteti Shkup, si qendra kryesore e shpërnguljes së popullatës shqiptare, kjo ishte qeveria, që realizoi projektin, që vazhdoi edhe pas Luftës së Dytë Botërore. Atëhere, Partitë Jugosllave posaçërisht Serbia, tentonte zgjerim territorial mbi tokat shqiptare, duke i përdor të gjitha forcat shtetërore nga administrata, policia, ushtria, duke shkaktuar: dhunë, terror, vrasje me qëllim që në tokat shqiptare, të vendoset element sllav (B.R), ndërsa gjatë periushës (1939-1941) u bë Marrëveshje e krijuar në mes Serbisë dhe Kroacisë, u themelua Qeveria e Cvetkoviç-Macekut, të cilat qeveri, prore rrezikonin vende dhe përkrahnin qeveritë fashiste.

Në fillim e Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1939, u ndryshuan rrethanat politike, gjendja nuk ishte stabile. Të gjitha partitë politike në kuadër të Mbretërisë Jugosllave ato serbe, shikonin interesat individuale, ndërsa popullata shqiptare përjetoi dhimbjet më të mëdha në rajonin e Shkupit me rrethinë, ku fati i tyre ngeli në duart e Zotit, presioni i madh, vuajtja, robëria, shpërngulja masovike, ishte një kaos i rendit shoqëror, duke vepruar masovikisht, presioni i politikës së Beogradit mbi popullatën shqiptare në Kosovë dhe Maqedoni, andaj kjo shpërngulje u ndërpre me sulmin e Gjermanisë kundër Jugosllavisë, më 6 prill 1941.

Pakënaqësia kishte arritur kulminacionin, situata ekonomike dhe politike ishte në gjendje të pa durueshme, në anën tjetër kishin intervenuar Fuqitë e mëdha Franca dhe Anglia, situatë të pa lakueshme Mbreti Aleksandër, duke mos pasur rrugëdalje tjetër, për ta qetësuar popullin serb, më 3 shtator 1931, shpalli Kushtetutën pa miratimin e Parlamentit. Kushtetuta parashihte dy dhoma: Senatin dhe Kuvendin Popullor, gjysmën e senatorëve i emëronte mbreti, kurse gjysma tjetër zgjidhej nga populli.

Zgjedhjet për organet përfaqësue, u caktuan më 8 nëntor 1931. Sipas Ligjit zgjedhor, në zgjedhje mund të merrte pjesë vetëm ajo organizatë politike, e cila do të kishte kandidat në të gjitha rrethet zgjedhore të shtetit. Me këtë dispozitë ligjore, u eliminuan të gjitha

---

<sup>105</sup>*Historia e popullit shqiptar*, v. III, 318-331.

partitë kryesore qytetare të opozitës, ngeli vetëm lista e kandidatit qeveritar Petar Zhivkoviç.<sup>106</sup>

Lista e kandidatëve, që do fitonte më shumë zgjedhës, (2/3) e numrit të përgjithshëm të deputetëve popullor, do të merrte pjesë në ndarjen e mandateve sipas sistemit proporcional. Zgjedhjet u realizuan nën presionin e policisë, me qëllim që të mos agjitohet lista e vetme e gjeneralit Petar Zhivkoviç, ajo përsëri u agjitua në tërë vendin. Në shumë qytete të Banovinës së Vardarit u bojkotuan zgjedhjet, ndërsa në Qarkun e Tetovës mbi 9.000, veta nuk dolën në votim.<sup>107</sup>

Edhe pse partia qeveritare, fitoi në këto zgjedhje me ndihmën e policisë dhe mbushjen e kutive, ajo së shpejti, shkarkohet nga detyra me urdhrin e Mbretit, më prill 1932, u zëvendësua me Qeverinë Vojislav Marinkoviçit, e cila qëndroi në pushtet vetëm tre muaj, dhe u zëvendësua nga qeveria Millan Sershkiçit.<sup>108</sup>

Gjatë periudhës (1932-1934), u ndërruan shtatë qeveri, që dëshmon qartë për krizën e thellë politike dhe ekonomike, të kapluar nga Diktatura monarko-fashiste e mbretit Aleksandër. Pas shumë kritikave, nga jashtë dedikuar Mbretit Aleksandër, ai i dha urdher Qeverisë së Nikolla Uzonovit të shpallte zgjedhjet vendore. Në Banovinën e Vardarit, zgjedhjet u realizuan, më 15 tetor 1933. Pushteti aktual, mori masa speciale përmes organeve policore, që mos të lejohen lista opozitare, ndërsa lista kishte vetëm partia në pushtet. Me këtë Partia Demokracia Radikale-Fshatare Jugosllave (PDRFJ), mbeti e vetmja në zgjedhjet. Në krye të listës në Banovinën e Vardarit, ishte çetniku i njohur Vasilije Trbiqi. Partia e tij në Banovinën e Vardarit fitoi me ndihmën e policisë, e cila bëri gjithçka, që partia e regjimit të dalë fituese Listat e përcaktuara të saja, në emër të DRFJ, morri 98,3% të komunave të Banovinës së Vardarit, ndërsa listat e pa përcaktuara, fituan 1.1% nëpër komuna, kurse opozita, ngeli vetëm me 0,5%.<sup>109</sup>

Anti shqiptarizmi dhe veprimet e saja politike, vazhduan që nga Mbretëria SKS-së, duke shtuar presionin më fuqishëm, me Diktaturën e 6 janarit 1929, kur gjithë pushteti kaloi në duart e Mbretit Aleksandërit të Parë Karagjorgjeviç, andaj mbi territorin e Kosovës dhe në krahinën e Shkupit me rrethinë, vepruan partitë politike serbe si: Partia

---

<sup>106</sup> *Historia na makedonskiot narod*, SKOPJE, 1988, 240.

<sup>107</sup> *Statistika Izbora Narodnih Poslanika*, 8.XI. 1931, Beograd, 1935.

<sup>108</sup> *Historia e popullit maqedonas*, 239.

<sup>109</sup> *Po aty*, 239.

Radikale e Nikolla Pashiqit dhe Partia Demokrate Serbe, përmes forcës shtetërore duke vepruar me polici, ushtri, institucione shtetërore të përkrahura edhe nga mbreti, mbi këto hapësira ku jetonin shqiptarët, vepruan partitë hegjemoniste serbe, duke votuar popullata shqiptare asaj politike mashtruese, që ushtronte Qeveria e Beogradit me kushtetutën e 3 shtatorit 1931, me ndarjen territoriale në Banovina, ku teritori i Kosovës, u nda në tre pjesë: në Banovinën e Zetës, Moravës dhe Vardarit.<sup>110</sup>

Edhe gjatë kësaj kohe, u krijuan dy tabore, që zhvillonin një luftë të brendshme, kur ministri i punëve të jashtme, Vojan Marinković, angazhohej që regjimin diktatorial ta zëvendësoj me regjim kushtetues, veprim politik i cili u prit në gjithë Jugosllavinë, ashtu edhe në Shkup me rrethinë. Pushteti kishte regjim policor anti parlamentar, mbreti s'pranonte asgjë, e shteti ishte gjithçka, ndërsa populli ishte i përbuzur tej mase. Në gjithë Banovinën e Vardarit, ku jetonin shqiptarët, nga ato banovina, në parlament dukshëm fituan 15 deputetë, pohohej sipas gazetës "*Proleter*" të 22 dhjetorit 1931, në artikullin "Pas komedisë elektorale", u publikua se, zgjedhjet, e fituara për Kuvendin e Mbretërisë Jugosllave, ishin njerëzit kapitalist, bankierë, fabrikantë, tregtarë e të korruptuarit, pronarët e mëdhenj, pa dyshim agjentët e oborrit mbretëror të Aleksandër Karagjorgjeviqit.<sup>111</sup>

Pas zgjedhjeve, më dhjetor, Shkupi me rrethinë, përjetoi një krizë të madhe në lidhje me tatimet e popullatës, kjo ishte e vetmja arsye kryesore, për shpërnguljen e popullatës shqiptare, kurse në tokat e tyre vendosnin kolonë sllav, të cilët i liroi nga pagesa e tatimeve. Millan Sershiqit, ishte armik i përbetuar i popullatës jo serbe, ai bëri terror dhe dhunë përmes forcave të xhandarmërisë dhe policisë.<sup>112</sup>

Kryetari i qeverisë së re, me mashtrimet e tija politike, u tregua si luftëtar i idesë së Jugosllavizmit integral, dhe i unitarizmit nacional, mbrojtës i centralizmit shtetëror, në favor të popullit serb. Rrol të rëndësishëm tek popullata shqiptare, në atë kohë kishte Ferat Draga, Sherif Voca dhe Asim Luzha. Më 5 janar 1935, u hartua Program politik i Qeverisë së Bogulub Jiftiviqit, si shtesë para deputetëve, si centralistë e absolutist i

---

<sup>110</sup> *Historia e popullit maqedonas*, 244-249; H. Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë 1918-1941*, 249-273.

<sup>111</sup> Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë 1918-1941*, 249-273.

<sup>112</sup> Александер Апостолов, *Колонизацијата на македонија во стара Југославија*, 165-190.

politikës së Mbretit Aleksandër, për të ruajtur tërësinë nacionale të Jugosllavisë integrale. Kjo qeveri, vazhdoi me tortura ndaj popullatës shqiptare kudo që ato jetonin dhe krijoi një acarim të madh politik në tërë vendin dhe në rrethana të pa sigurta politike. Qeveria e Jevtiqit shpalli zgjedhjet parlamentare, më 5 maj 1935, i bindur, se përmes forcës policore të presionit të madh të xhandarmërisë, falsifikimit zgjedhor, do të siguroj shumicën parlamentare.<sup>113</sup>

Qeveria e Bogolub Jevtiqit, vazhdonte kursin centralist e absolutist politik të Mbretit Aleksandër, i bindur se me presion politik do të sigurohet zbatimi i Kushtetutës 1931. Në zgjedhje, morën pjesë partitë opozitare, të cilat themeluan opozitë unitarte, të përbërë nga koalicioni fshatar-demokratik në krye me Vllatko Maçekun, i cili u bë bartës i listës së kandidatëve, pjesmarrës në krye me Luba Davidoviqin. Partisë së Bujqëve i printe Jovan Jovanoviqin, kurse Bashkësisë Myslimane Jugosllave, Mehmet Spaho. Opozita, nuk kishte program politik të caktuar, por ishte aleancë e përkohshme zgjedhore, kishte për qëllim të rrëzojë Qeverinë dhe të krijoj funksionim normal partive borgjeze. Qeveria e Jevtiqit, më 5 maj 1935 i shpalli zgjedhjet parlamentare, e bindur se me ndihmën e policies dhe falsifikimit zgjedhore, do sigurojnë shumicën në parlament, në këtë frymë u zhvillua gjithë fushata dhe vetë dita e zgjedhjeve. Sipas rezultateve zyrtare për listën e Jevtiqit në Maqedoni, votuan 60,6%, për opozitën e bashkuar 37,4%, kurse lista e Lotiqit fitoi 1,2%, ndërsa e Maksimoviqit 0,8%.<sup>114</sup>

Opozita, refuzoi të marrë pjesë në parlamentin e rikrijuar, koalicioni fshatar-demokratik, kërkoi menjëherë të ndërpritet Parlamenti dhe të shpallen zgjedhje e reja, dhe me ligj të ri zgjedhor, tu garantonte lirinë zgjedhësve. Me këtë u pa se sa i kalbur ishte sistemi jugosllav.<sup>115</sup>

Për të dalë nga kjo situatë e krijuar politike, oborri mbretëror në krye me Knjazin Pavle, e shkarkoi Qeverinë e Bogolub Jevtiqit dhe solli në pushtet Qeverinë e Millan Stojadinoviqit, me qëllim që i njëjti, sa më shpejt ta orientojë vendin kah Forcat e Boshtit.

Këto zgjedhje treguan, se sa e thellë, ishte pa kënaqësia në popull. Prandaj edhe populli i Banovinës së Vardarit me shumicë, votuan për opozitën, xhandarmëria së bashku me nëpunësit e borgjezisë, bënte shtypje në popull të votohej për listën e

<sup>113</sup> Hysen Terziu, *Gjenocidi Sërb*. Prishtinë 2005, 132-136.

<sup>114</sup> *Statistika izbora narodni poslanika*, 5.V. 1935, Beograd, 1938. 186.

<sup>115</sup> *Historia e popullit maqedonas, vep e cit.* 244.

Jevtiviqit, në anën tjetër Partia Nacionale Jugosllave në tërë vendvotimet në Banovinën e Vardarit, kishte kandiduar çetnikun e njohur serb, Vasilije Trbiq.<sup>116</sup>

Që në fillim të vitit 1938, filloi fushata për zgjedhjet e ardhme parlamentare. Opozita në Banovinën e Vardarit, kërkoi bisedime me opozitën serbe, por ata i refuzuan, më pas opozita maqedonase hyri në bisedime, me udhëheqësuesin e Partisë Fshatare Kroate Vlatko Maçekun, me qëllim, që të hynë në një listë të përbashkët në partinë e tij, por edhe ky refuzoi një bashkëpunim të tillë. Zgjedhjet parlamentare, filluan më 11 dhjetor 1938, u bënë me shumë mallëverzime zgjedhore, shumë kandidat deputetësh opozitar, u burgosën në prag të zgjedhjeve, bëheshin presione të mëdha mbi votuesit. Në zgjedhje morrën pjesë 74% e votuesve të regjistruar. Për listat e kandidatëve të partisë në pushtet JRZ, (Bashkësia Radikale Jugosllave) votuan 54%, për kandidatët e opozitës së bashkuar, votuan 44,9%, për listën e organizatës fashiste “Zbor”, votuan 1%, me bartës të listës Dimitar Lotiq. Zgjedhjet rrëfyan një evolucion të ndjeshëm në jetën politike të popujve në Banovinën e Vardarit. Pozita e bashkuar, fitoi 27,3% vota në 30 rrethe zgjedhore sa kishte Banovina e Vardarit. Opozita unitare, fitoi 30% të votave, kjo fletë qartë për përplasjet dhe ndjekjet e policisë në këtë Banovinë. Në këto zgjedhje, u lënduan disa individë, u vranë 2 qytetarë. Lista e Organizatës Fashiste e Dimitar Lotiqit “Zbor”, pësoi dështim të plotë, fitoi vetëm 113 vota.<sup>117</sup>

Rezultatet e përgjithshme të fituara në zgjedhjet e vitit 1938, dhanë këto rezultate: lista e Sojadinoviqit fitoi 306 deputetë, lista e Maçekut i fitoi 67 deputetë në Parlament, lista e Lotiqit nuk fitoi asnjë deputet në Parlament në zgjedhjet parlamentare të vitin 1938<sup>118</sup>, kurse votat e mjaftueshme për deputet i siguroi edhe Mehmet Spaho.<sup>119</sup>

Shqiptarët, në këto zgjedhje nuk përfaqsonin me asnjë parti. Në atë kohë, Ferat Draga, i përkrahur nga shumë politikan shqiptar, kërkonte me çdo kusht të ndërpritet zbatimi i Marrëveshjes së shpërnguljes së popullatës shqiptare me dhunë nga Kosova, e Shkupi me rrethinë. Prandaj Ferat Dragës i dha një përkrahje morale Mehmet Spahos, kjo dëshmohet nga raporti i banit të Banovinës së Vardarit dërguar Millan Stojadinoviqi, ku

---

<sup>116</sup> Александер Апостолов, *Колонизацијата на македонија во стара Југославија*, 180-189.

<sup>117</sup> *Historia e popullit maqedonas*, 253.

<sup>118</sup> Nadezda Cvetkovska, *Makedonskoto prashanje vo Jugoslovenskiot parlament ...*, 63.

<sup>119</sup> Mustafa Memiq, *Velika medresa i njeni učenici i revolucionarnom pokretu*, 73-75.

theksohet aktiviteti dhe angazhimi i Ferat Draga në mes popullatës shqiptare për zgjedhjet që do mbahen më dhjetor 1938.<sup>120</sup>

Në atë kohë Qeveria, bënte çmos ndaj popullatës shqiptare, duke iu mohuar të drejtat e votimit, sepse ato nuk kishin dokumente të Mbretërisë Jugosllave. Sipas të gjitha pregaditjeve, me fillimin e zgjedhjeve në Shkup e rrethinë, më nëntor 1938, ishin përpiluar të gjitha listat e kandidatëve, për Banovinën, asaj kohe u përpiluan tre lista: Lista e Qeverisë EJRZ-ES, Opozita unitare, e Maçekut, Lista e Zborit, përfaqësuesi Dimitria Lotiq. Si rezultat i këtyre përpjekjeve, më 26 gusht 1939, u themelua Qeveria e Cvetković-Maçek në harmonizim me borgjezinë serbe të asaj kroate. Mirëpo, edhe tek ajo qeveri, Serbia dominonte ndaj popullatës shqiptare në Shkup e rrethinë, e cila vazhdonte dhunë, terror, vrasje dhe shpërngulje. Ferat Draga, Shaban Mustafa, Pajazit Boletini, Asim Luzha, Sulejman Kryeziu, Bajram Ajvazi, Iljaz Agushi e shumë të tjerë, sipas disa të dhënave thuhet se në mënyrë ilegale, bënë ringjalljen e organizatës “Bashkimi” (Xhemijeti). Sipas Raportit të Komandës së Armatës së III-të, në Shkup, në seancën e kësaj Organizate në Vrajë, përveç Ferat Dragës, ishin të pranishëm: Qerim Zena, Jusuf Imeri, Sherif Voca, Jahja Daci, Sadik Kurti dhe Asim Luzha. Qëllimi i tyre ishte, të nxitej popullata shqiptare, të kërkojnë autonomi politike, për arsye se ishin me numër të mjaftueshëm.<sup>121</sup>

#### **II.4. Roli i Bashkësisë Fetare Islame 1929-1941**

Roli historik i feve në krahinën e Shkupit është i lidhur ngushtë me tërë historinë nëpër të cilën ka kaluar populli shqiptar, ndërsa kjo është e lidhur ngushtë me vazhdimësinë dhe ekzistencën e shqiptarëve deri në ditët e sotme në këtë qytet, që paraqet një proces shumë të ndërlikuar. Ky ndërlikim është i lidhur me pozitën e kombit shqiptar dhe qytetit të Shkupit, midis Lindjes dhe Perëndimit, si një hallkë e dobët ndërmjet botës greke e latine, si dhe ndërmjet botës sllave dhe muslimane. Banorët e parë të qytetit të Shkupit ishin ilirë, ndërsa besimi i tyre i parë ishte pagan. Më vonë ilirët e krahinës së Shkupit e pranojnë Krishterimin dhe ky qytet do të jetë qendër e kishës së

<sup>120</sup> Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë 1918-1941*, 267-273.

<sup>121</sup> Jusuf Buxhovi, *Kosova nga Konferenca e Londrës deri në protektoratin ndërkombëtar*, 220-224.



provincës së Dardanisë. Me okupimin e këtij qyteti nga sllavët e jugut, në këtë qytet fillon të jetë i pranishëm edhe ky element. Më vonë do të ketë ndikim edhe okupimi bullgar. Po ashtu do të ketë një tronditje edhe ndarja e kishës së krishtere në dy pjesë në shekullin XI (viti 1054), ku krahina e Shkupit do të përcaktohet t'i takojë kishës së Perëndimit.

Tronditjet më të mëdha për ta ndryshuar përkatësinë fetare, sipas termit të okupesit, ishin në periudhën e mbretërve serbë, një politikë që do të kulminojë me Kodikun e Mbretit Dushan, i cili nëpërmjet konvertimit e katolikëve shqiptarë në sllavo-ortodoksë rrezikonte ta ndërpresë vazhdimësinë iliro-arbërore të Shkupit. Te këto masa ndëshkuese sllavo-ortodokse qëndron edhe arsyeja se pse shqiptarët e pranuan aq shpejt fenë islame në krahinën e Shkupit. Siç dihet, në shekujt XV dhe XX shqiptarët fillojnë të konsolidohen në këtë qytet dhe në këtë drejtim Shkupi në këtë periudhë do ta ruajë peshën e ndikimit si qendër e Ispeshkisë Shkup-Prizren, kjo si vazhdimësi e kishës ilire. Ndërkaq shumica e shqiptarëve të krahinës së Shkupit që e pranuan fenë islame, dalëngadalë do të faktorizohen dhe gjatë shekujve XV-XVIII, Shkupi do të shndërrohet në qendër ekonomike e politike për tërë Shqipërinë dhe tërë Ballkanin.

Shkupi gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare do të ndërlidhet fuqishëm me elementin kombëtar dhe do të jetë piemonti i të gjitha lëvizjeve e zhvillimeve për çështjen kombëtare. Këtu është me rëndësi të theksohet se pikërisht feja islame do të jetë faktori kyç që shqiptarët i mbijetuan asgjësimit që e ushtroi hegjemonia serbe, gjatë luftërave ballkanike, Luftës së Parë Botërore dhe në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore. Ndërkaq elementi i shqiptarëve katolikë në krahinën e Shkupit do të jetë në shënjestër nga organet shtetërore serbe në shekullin XX-të duke e përdorë Krishterimin do të bëhet trysni për t'i asimiluar, ndërsa ata që nuk i pranonin këto masa u shpërngulën nga krahina e Shkupit dhe kështu u humb elementin katolik në këtë qytet, me çka synohej të ndërpritej vazhdimësia iliro-arbërore-shqiptare. Por, politika hegjemoniste serbe nuk arriti ta zhdukë elementin shqiptar nga Shkupi, sepse shumica dërrmuese e këtij qyteti tashmë i përkiste fesë islame. Prandaj ajo gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore do të shndërrohet në gardian të ruajtjes së vazhdimësisë së saj historike.

Pas formimit të Mbretërisë SKS për myslimanët do të fillojë një periudhë e vështirë, periudhë kjo e cila për Bashkësinë Islame sipas disave mendohet periudha më e

vështirë e organizimit të jetës fetare dhe myslimanëve. Në këtë periudhë do të vinë në shprehje një numër i madh i dobësive organizative të cilat do të vështirësojnë jetën fetare të myslimanëve në këto troje. Disa këto vështirësi mundohen t'ia hedhin sistemit të më hershëm organizativ të Bashkësisë Fetare Islame, por realiteti i paraqitjes të vështirësive duhet lypur në ndryshimet e rrethanave pas Luftës së Parë Botërore dhe ndryshimet politiko-shoqërore dhe shpirtërore të cilat seriozisht i kapluan myslimanët. Pas ndryshimeve politike dhe formimin e Mbretërisë Jugosllave edhe për myslimanët do të filloj një organizim i ri i mbështetur në norma dhe ligje ku do të përforcohet pozita e tyre dhe zhvillimi i jetës fetare. Mbretëria Jugosllave do të bëj unifikimin e të gjitha ligjeve, ku do të angazhoj organet shtetërore që të sjellin edhe Ligjin për Bashkësinë Fetare Islame, ky Ligj do t'i besohet Ministrit të drejtësisë, i cili pas miratimit do t'i dorëzohet Mbretit për verifikim. Më 31 Janar të viti 1930 u soll Ligji për Bashkësinë Islame të Mbretërisë Jugosllave.<sup>122</sup>

Gjatë sundimit të Perandorisë osmane në këto troje myslimanët nuk kishin bashkësi të veçanta fetare, por organizimi i jetës fetare edhe këtu ishte i njëjtë sikurse në pjesët tjera të Perandorisë Osmane. Me rënien e Perandorisë Osmane, shtetet e reja Ballkanike, veçanërisht Serbia dhe Mali i Zi shpallën krishterimin si fe shtetërore, kurse pranuan edhe islamin, por jo si fe shtetërore të barabartë me fenë krishtere dhe ushtruan kontroll të rreptë mbi të. Në krye të Bashkësisë Fetare Islame të Serbisë ishte Myftiu, selia e të cilit ishte në Nish. Pozita e pjesëtarëve të bashkësisë islame (myslimanëve) do të përcaktohet nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe atë: Marrëveshja ndërkombëtare e Bukureshtit e 28 Qershorit të vitit 1913, Stambollit 1-4 marsit të vitit 1914, e veçanërisht me nënshkrimin e marrëveshjes në Konferencën e Paqes, që u mbajt në Versajë pas Luftës së Parë Botërore më 10 shtator të vitit 1919 në mes të Austrisë në të cilën Mbretëria e Re (SKS) obligohet që t'u garantoj mbrojtje familjare dhe statut të plotë myslimanëve, emërimin e Reis ul-Ulemasë, mbrojtjen dhe sigurinë e xhamive, varrezave dhe institucionet tjera mirëbërëse. Organet shtetërore që mbikëqyrshin dhe udhëheqshin Bashkësinë Fetare Islame ishin: Ministria e Feve e cila u themelua në vitin 1919 dhe u anulua më 24 prill të vitit 1929, kurse kompetencat e mbikëqyrjes të kësaj ministrie i

---

<sup>122</sup> Shinazi Memeti, *Roli i Bashkësisë Fetare Islame dhe Myftinisë së Shkupit ndërmjet luftërave botërore*, në: SCUPI, nr. 12, Shkup, 2015, 76.

mori Ministria e Drejtësisë. Mbretëria serbe pas nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve disa herë i ratifikoi, por kurrë nuk i zbatoi në tërësi. Me fjalë të tjera, të gjitha këto “të drejta të mëdha” të myslimanëve Serbia asnjëherë nuk i zbatoi në praktikë.<sup>123</sup>

Pas formimit të Mbretërisë SKS për myslimanët filloi një periudhë e vështirë, e cila vlerësohet si periudha më e vështirë e organizimit të Bashkësisë Fetare Islame dhe myslimanëve në përgjithësi. Në këtë periudhë do të vinë në shprehje një numër i madh i dobësive të organizimit të pasurisë së vakëfit. Të drejtat të cilat ju garantuan popullatës myslimane në Konferencën e Paqes në Versaj, do të aprovohen edhe në Kushtetutën e Vidovdanit të miratuar më 28 Qershor të vitit 1921. Shteti duke pasur konsideratë ndaj myslimanëve, me këtë kushtetutë besimtarëve ju garantohet liria fetare kurse besimet janë të barabarta para ligjit. Besimet-fetë e pranuar tash ju lejohet që t’i rregullojnë obligimet fetare dhe të administrojnë me pasurinë e tyre në kufi me rregullat kushtetuese. Për çështjen e jetës familjare dhe të trashëgimisë të myslimanëve do të vendosin gjyqet e sheriatit. Aspiratat e Bashkësisë Fetare Islame në shtetin e riformuar, haptazi i shpalosi Reis ul-Ulemaja Xhemaludin Çausheviqi në deklaratën e tij zyrtare me rastin e “anketimit fetar” në nëntor të vitit 1921 në Beograd në organizimin e Ministrisë së feve. Ai theksoi se për organizimin e punëve të Bashkësisë Fetare Islame, nuk mundë të përdoret asnjë analogji me konfesionet tjera me të gjitha specifikat e islamit. Ai gjithashtu kërkoi bashkimin e të gjithë pasardhësve të islamit në një organizatë e vetme.<sup>124</sup>

Bashkësisë Fetare Islame gjatë periudhës (1929-1941), në kuadër të Mbretërisë Jugosllave në kohën e Mbretit Aleksandër, me diktaturën e 6 janarit dhe krijimin e Mbretërisë Jugosllave, u miratua ligji i ri për Bashkësinë Fetare Islame më 31 janar 1930. Ky ligj siguron aprovimin e Kushtetutës së Bashkësisë Fetare Islame në Seancën e përbashkët nën udhëheqjen e Kryesisë të Reis-ul-emas, në bashkëpunim mes dy Ul-ema Mexhliseve, të gjithë Myftive të gjithë anëtarëve të dy gjyqeve, të sheriatit. Kjo Kushtetutë e re, në kuadër të Mbretërisë Jugosllave iu besua ministrisë të drejtësisë, pas miratimit që e verikoi Mbreti Aleksandër.<sup>125</sup>

---

<sup>123</sup>Shinazi Memeti, *Roli i Bashkësisë Fetare Islame dhe Myftinisë së Shkupit ndërmjet luftërave botërore*, 77-78.

<sup>124</sup>*Po aty*,80.

<sup>125</sup> Muhamed Salkić, *Ustavi islamičke zajednice*, Sarajevo,1422-2001, 84.

Kjo kushtetutë e Bashkësisë Fetare Islame në kuadër të Mbretërisë Jugosllave, legalisht vepron së ekzistuarit me të gjitha të drejtat fetare, themelimi i saj u publikua në gazetën zyrtare të më qershor 1930. Me këtë kushtetutë u themelua Bashkësia Fetare Islame, ku pezulloi organizimi i atëhershëm më 9 gusht 1930. Bashkësia Fetare Islame, në kuadër të Mbretërisë, ishte kryesi të re me Reis-ul-ema me seli në Beograd. Ajo me Kushtetutë, posedonte, 119 Nene e ndarë në 4 dispozita themelore, organet e Bashkësisë Fetare Islame, administrate, financimi dhe dispozita e përgjithshme kalimtare. Me këtë kushtetutë BFI-ja, ishte e barabarë, në mesin e feve tjera në Mbretërinë Jugosllave, ku mbrohej me Ligjin e të gjitha feve tjera të pranuar. Kjo ruante, unitetin shpirtëror, duke i kryer të gjitha obligimet fetare shpirtërore duke zhvilluar jetë të pavarur fetare dhe arsimore. Andaj kishte të drejtë të plotë nën mbikëqyrjen e vakëfeve, parimi kryesor i kësaj Bashkësie ishte Ligji për Bashkësinë Fetare Islame bashkë me kushtetutën e saj.<sup>126</sup>

Bashkësia Fetare Islame ishte themeluar për gjithë myslimanët, që jetonin në gjitha banorinat e Mbretërisë Jugosllave me pjesën dërmuese të saj, ishte popullata shqiptare dhe përmes këtyre të drejtave fetare, tentonte të mbrohet interesi fetar dhe pronësia tokësore, organet më të larta fetare, përmes Kushtetutës definuan këto organe:

- Kryesia me Reis-ul-uleman,
- Ulema Mexhlisi dhe myftitë,
- Qendrat më të rëndësishme, të kontrollonin të gjitha qarqet fetare në Shkup dhe Sarajevë.

Me krijimin e Qeverisë së Stojadinoviç Bashkësia Fetare Islame, kishte shumë të drejta sepse koalicionit të kësaj qeverie ishte Mehmet Spaho, anëtar i Organizatës Myslimane Jugosllave. Gjatë kësaj periudhe u bë transferimi i selisë nga Beogradi në Sarajevë, kurse më 25 mars 1936, u miratua Kushtetuta e Re e Bashkësisë Fetare Islame në Mbretërinë Jugosllave, e cila u verifikua më 24 tetor, ndërsa u shpall në Gazetën zyrtare më 5 nëntor 1936. Kushtetuta e re, administratën e ndau në dy pjesë: Sarajeva me qarqet e saja banorinat, Shkupi dhe qarqet e saj.

Kjo kushtetutë ishte vuliminoze e përbërë më 22 paragrafe të ndara në 6-të pjesë:

1. Dispozita themelore dhe të përgjithshme.
2. Organet e Bashkësisë Fetare Islame.

---

<sup>126</sup>USTAV Islamske Vjerske Zajednice Kraljevine Jugoslavije, 9 Jula 1930.

3. Zgjedhja e organeve dhe trupave të Bashkësisë Fetare Islame.
4. Pronat e Bashkësisë Fetare Islame.
5. Arsimimi.
6. Dispozitat kalimtare.<sup>127</sup>

Gjatë gjithë Mbretërisë Jugosllave (1929-1941) Shkupi me rrethinë, ishte qendra kryesore e shqiptarëve të Kosovës edhe të Maqedonisë, në aspekt të çështjeve fetare islame, rëndësia më e veçantë ishte shkollimi. Andaj Shkupi me rrethinë ka luajtur rol të rëndësishëm për mbrojtjen e interesave kombëtare, që nga koha e Xhemietit të themeluar në Shkup. Kushtetuta e re e Bashkësisë Fetare Islame, qëllim kryesor kishte, rolin e arsimit, edukimit të myslimanëve në Mbretërinë e Jugosllavisë. Në rrethinën e Shkupit dhe më gjerë, rol të rëndësishëm luajti “Medreseja e Isa Beut” në Shkup si shkollë e mesme fetare dhe medresja shtetërore “Medreseja e madhe” e Mbretit Aleksandri Parë në Shkup, pasi thuajse të gjithë veprimtarët e mëdhenj të asaj periudhe nga Shkupi me rrethinë kanë mësuar në këto medrese. Për frymën dhe edukimin fetar, rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe mejtepet dhe xhamitë, ku ligjëronin mualimë dhe imamë profesional. Më 5 mars 1931, Ministria e Arsimit, miratoi vendim, që “Sibian Mektebet” të vazhdojnë me punët dhe aktivitetet e tyre, në të cilën do të mësojnë fëmijët mysliman nga mosha 5-7 vjeçe. Në vitin 1931, në Shkup dhe rrethinë ka dy “Sibian Mektebe”: mektebi “Qebir Mehmet Çelebi” dhe mektebi “Haxhi Balaban”.

Ulema Mexhlisi në Shkup përpiloi planprogramin për “Sibian Mektebe” ku mësohej shkrimi arab, leximi i Kur’anit me texhvid, mbi rregullat e etikës dhe pastërtisë, këto lëndë mësimore i ligjëronin mësues të kualifikuar të cilët i shërbenin populates shqiptare myslimane edhe jashta mësimet.<sup>128</sup>

Sipas të dhënave të bashkësisë fetare islame në vitet 1936/1937 Shkupi me rrethinë ishte e ndarë gjithsej në 19 xhemate, edhe atë në 7 xhemate të qytetit dhe në 12 xhemate të rrethinës, të cilët njëkohësisht paraqitnin njësi administrative.

#### ***Xhematet e qytetit të Shkupit:***

1. Xhemati Xhedid, në vitin 1936, numëronte 2.936 banorë, 1.436 meshkuj, 1.500 femradhe 508 familje.

<sup>127</sup> Muhamed Salkić, *Ustavi islamike zajednice*, 118.

<sup>128</sup> Muhamed Salkić, *Ustavi islamike zajednice*, 120; Mustafa Memiq, *Velika Medresa i njeni učenici u revolucionarnom pokretu*, Shkup 1984, 84-93.

2. Xhemati Kara Kapush, në vitin 1937, numëronte 2748 besimtarë muslimanë, 603 familje, imam ishte Alija Memedoviq.

3. Xhemati Haxhi Kasum, në vitin 1937, numëronte 3.011 besimtarë muslimanë, 572 familje, imam ishte Ifran Mehmedi.

4. Xhemati Tophanë, në vitin 1937, numëronte 3.962 besimtarë muslimanë, 698 familje, imam ishte Mahmud Baki.

5. Xhemati Xhami Atik, në vitin 1937, numëronte 3.638 besimtarë muslimanë, 783 familje, imam ishte Hamdi Nuhi.

6. Xhemati Haxhi Ballaban, në vitin 1936, ky xhematë numëronte 2.705 besimtarë muslimanë, 519 familje, imam ishte Nuhi Veli.

7. Xhemati Pazar Bashi, në vitin 1937, numëronte 2.490 besimtarë muslimanë, 507 familje, imami ishte Mamud Imer.

***Xhematet e rrethinës së Shkupit:***

1. Xhemati Zelenikovë, në vitin 1937, numëronte 2.685 besimtarë muslimanë, 420 familje, imam ishte Sherif Osmani, me seli në Zelenikovë.

2. Xhemati Krushopek, viti 1937 numëronte 3.710 besimtarë muslimanë, 462 familje, imam ishte Sejfulla Qamil, me seli në Krushopek.

3. Xhemati Pagarush, në vitin 1937, numëronte 3.047 besimtarë muslimanë, 477 familje, imam ishte imam Usein Uzeir, me seli në Pagarushë.

4. Xhemati i Drzhillovës, në vitin 1937, numëronte 2.406 besimtarë muslimanë, 355 familje, imami ishte Zejnel Azemi me seli në Dërzhillovë.

5. Xhemati Bojanë, në vitin 1937, numëronte 4.740 besimtarë muslimanë, 713 familje, imam ishte Mustafa Hasan me seli në Bojanë.

6. Xhemati Srednje Konjare, në vitin 1937, numëronte 1.985 banorë, 352 familje, imam ishte Ramadan Durmishi me seli në Konjare të Mesme.

7. Xhemati i Cvetovës, në vitin 1937, numëronte 2.332 besimtarë muslimanë, 308 familje, imam ishte Jakup Adil me seli në Cvetovë.

8. Xhemati i Batincës, në vitin 1937, numëronte 2.768 besimtarë muslimanë, 449 familje, imam ishte Uzeiri Llukman me seli në Batincë.

9. Xhemati në Hasan Beg, në vitin 1937 numëronte 2.101 besimtarë muslimanë, 315 familje, imam ishte Mahmud Sulejmanoviq me seli në Hasan Beg.

10. Xhemati i Lubetenit, në vitin 1937, numëronte 3.162 besimtarë muslimanë, 373 familje, imam ishte Ismail Abdurrahman, me seli në Lubeten.

11. Xhemati i Nikishtanit, në vitin 1937, numëronte 3804 besimtarë muslimanë, 490 familje, imam ishte Hajredin Ahmedoviq, me seli në Nikishtan.

12. Xhemati Bllacë, për këtë xhemat, kemi të dhëna për vitin 1931, ai numëronte 3.079 besimtarë muslimanë dhe 450 familje.<sup>129</sup>

Vakëfet janë paraqitur si një tërësi e veçantë, specifike, në Perandorinë Osmane dhe janë themeluar sipas rregullave të së drejtës së Sheriatit. Ato si prona muslimane kanë pasur rol të rëndësishëm në Bashkësinë Fetare Islame, ndërsa për herë të parë paraqiten në shekullin XV. Vakëfet janë themeluar nga themelues, emrin e të cilit më vonë e ka bartur vakëfi, ndërsa themeluesi vetë, me letërthemelimin e tij (vakëfname) e ka përcaktuar qëllimin e vakëfit. Të drejtën e menaxhimit me vakëfin më së shpeshti e ka mbajtur themeluesi dhe pasardhësit e tij ose, madje, me akt të veçantë (amanet) ai ka përcaktuar kujdestar nga ndonjë familje e njohur si muteveli<sup>8</sup> e vakëfit dhe më pas ai funksion ka mbetur trashëgimi në atë familje. Me kalimin e kohës, ashtu siç kanë ndryshuar kushtet në Perandorinë Osmane, edhe vakëfet kanë përjetuar ndryshime.

Prandaj ka filluar ndërtimi i vakëfeve për qëllime të ndryshme, si: për tregti, zejтари, hamame, hane, sahatkulla, kuzhina publike për ushqimin e popullatës së varfër etj. Këto vakëfe në aspektin material kanë qenë shumë të fuqishme dhe kanë qenë shtytës i rëndësishëm në Perandorinë Osmane. Pasi që vakëfet kanë disponuar me prona të mëdha të patundshme, shumë shpesh ajo pronë është dhënë më qira te popullata që ka pasur nevojë për qiramarrje.

Vakëfet hasen edhe në anët tona gjatë kohës së qeverisjes osmane, madje në zona të veçanta kanë qenë në mbikëqyrjen supreme të shtetit. Pas luftës ruso-osmane. Serbia e ka njohur Bashkësinë Fetar Islame dhe ia ka dhënë të drejtën që t'i administroje punët e saj fetare dhe pronësore nën mbikëqyrjen supreme të shtetit. Kjo e drejtë është verifikuar edhe pas luftërave ballkanike me dekretin e datës 07.06.1914 dhe Marrëveshjen e Paqes të Carigradit të vitit 1914, kur Serbisë bashkëngjiten zonat jugore: Maqedonia, Kosova dhe Sanxhaku. Menaxhimin me vakëfet e kanë bërë mutevelinjtë, por mbikëqyrjen mbi

---

<sup>129</sup> ДАРМ-Фонд 619, кутија 7- Окружни и обласни муфтијства, скопје 1921-1941.

administrimin e ka bërë Drejtoria e Vakëfit për kompetencat materiale dhe Myftinia për Çështjet Fetare.

Në këtë periudhë vakëfet kanë qenë në pozitë të pakëndshme dhe fuqia e tyre materiale ka qenë e barabartë me qiranë që e kanë fituar nga pronat e dhëna me qira. Drejtoria e Vakëfit ka qenë nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Fesë dhe praktikisht asnjë vendim nuk ka qenë e mundur të miratohet pa lejen e ministrit. Centralizimi i tillë i pushtetit ka qenë i nevojshëm që të vazhdojë mbijetesa e vakëfeve. Drejtoria e Vakëfeve e ka pasur drejtorin dhe këshillin e vet drejtues që e kanë formuar krerët e familjeve të njohur. Prej të ardhurave të vakëfit janë ndarë mjete për mirëmbajtjen e objekteve të vakëfit, procedurat fetare janë realizuar sipas të gjitha rregullave fetare, ndërsa familjet e varfra kanë përfituar ndihmë me para ose me vendosje në objektet e tyre etj.

Vakëfet, të cilat nuk kanë mundur vetë ta vazhdojnë veprimtarinë e tyre, rëndom i kanë bashkuar pronat me vakëfet e tjera dhe kështu janë bërë më të fuqishme, ndërsa ato vakëfe ku është shuar brezi i mutevelinjve janë dorëzuar te Drejtoria e Vakëfit dhe kështu është formuar Vakëfi i Përgjithshëm, i cili ka qenë nën mbikëqyrjen e jashtëzakonshme të Drejtorisë. Me qëllim të mbulimit të shpenzimeve, shumë shpesh Drejtoria e Vakëfit ose ndonjëri prej vakëfeve e kanë shitur pronën e vakëfit.

Organet e Drejtorisë Fetare të Vakëf-Mearifit kanë qenë: Kuvendi i Xhematit; Kuvendi i Qarkut të Vakëf-Mearifit dhe Këshilli i Qarkut; Myftinia; Parlamenti i Vakëf-Mearifit dhe Këshilli Parlamentar; Ulema Mexhlisi; Senati i Vakëf-Mearifit; Nijabeti dhe Këshilli i Nijabetit. Të gjitha organet e përmendura i ka zgjedhur popullata muslimane sipas rregullave të parashikuara me ligj.

Sipas mënyrës së menaxhimit të vakëfeve të veçanta, në këtë periudhë kohore, në territorin e Serbisë së atëhershme Jugore kanë ekzistuar 3 lloje të vakëfeve:

- Vakëfe të quajtura “Masbuta”, më të cilat ka udhëhequr shteti nëpërmjet Drejtorisë së Vakëfit.

- Vakëfet e quajtura “Gajri masbute” ose “Mulhaka”, me të cilat kanë menaxhuar mutavelinjët, të cilët janë emëruar nga ana e themeluesve të vakëfeve me akt të veçantë të trashëgimisë dhe ata kanë qenë të detyruar të menaxhojnë dhe disponojnë me të ardhurat prej vakëfeve, ashtu siç ka qenë e parashikuar me rregullat përkatëse (vakafname) ose sipas trashëgimisë (teamuli-kadin). Drejtoria e Vakëfit këtu ka kryer vetëm mbikëqyrje.



- Vakëfet e ashtuquajtura “Mustesa” ose të pavarura, të cilat drejtoheshin nga mutevelinj të që i kanë fituar vakëfet për t’i gëzuar dhe drejtuar pa asnjë mbikëqyrje.

## Kapitulli III

### III. Reformat agrare kolonizuese dhe pozita e shqiptarëve në Shkup me rrethinë

#### III.1. Reformat agrare dhe kolonizuese gjatë viteve 1918-1929

Në Luftërat Ballkanike, u pa qartë qëllimi i Serbisë për okupimin e tokave shqiptare, ndërsa trevat sllovene dhe kroate, ishin pjesë përbërëse e Perandorisë së Austro-Hungarisë, pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore më 1 dhjetor 1918, realizohej ideja e shtet formimit Sllav në mes Serbisë, Kroacisë dhe Sllovenisë. Serbia, përmes kësaj Mbretërie, tentonte ta realizonte zgjerimin e sipërfaqeve mbi tokat shqiptare, veçanërisht në Shkup me rrethinë, ku popull më i diskriminuar dhe që i përjetonte projektet eliminuese të sllavëve, duke vendosur mbi tokat shqiptare koloni sllave, me pretekst, pse për mbrojtjen e interesave kombëtare.<sup>130</sup>

Aleksandar Karagjorgjeviqi proklamoi manifestin e tij, në të cilin thuhej: *“Popullit tim, serbëve, kroatëve dhe sllovenëve, duhet t’u njihet barazia qytetare në mbretëri, dhe liritë fetare do të garantohen me ligj”*<sup>131</sup>.

Me këtë manifest, Karagjorgjeviqi dëshironte t’i përfitojë simpatinë e nënshtetasve, t’i qetësojë pakënaqësitë ekonomike e politike, dhe me këto hapa, atij iu mundësua konsolidimi i pushtetit. Ky manifest nuk ishte obligues për qeverinë, por partitë politike udhëheqëse, vepruan sipas dëshirës së mbretit, që ta zbatojnë të njëjtin. Për zbatimin e propozimit të Aleksandar Karagjorgjeviqit, u formua një komision i veçantë, që kishte për detyrë ta konkretizojë dhe zbatojë manifestin e proklamuar. Këtij komisioni i bëheshin presione nga të gjitha anët, për shkak se qëndrimet e partive politike për reformën agrare, ishin të ndryshme dhe secila dëshironte të impononte qëndrimet e veta. Në komision kishte edhe mosmarrëveshje rreth kompensimit të pronarëve të mëdhenj. Ky komision u formua shumë shpejtë, kurse synimi i tij kryesor ishte që të realizonte premtimet e Aleksandar Karagjorgjeviqit, duke mos marrë parasysh interesat e

<sup>130</sup> Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë 1918-1941*, 178-186.

<sup>131</sup> Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918 - 1941)*, 42.

atyre që kishin prona të mëdha, e të cilët ishin pjesë e reformës agrare dhe kolonizimit.<sup>132</sup>

Me miratimin e Dekretit për popullim (20.02.1914), e deri në fillimin e luftës në mes të Serbisë dhe Austro-Hungarisë, kishte mundësi të bëhen vetëm se përgatitjet e para për popullimin e trevave lindore. Dekreti për popullim ishte shembull i mbajtjes së vazhdimësisë në procesin e zbatimit të reformës agrare. Me këtë u bë vetëm se hapi i parë drejt zgjidhjes së problemeve të sferës së reformës agrare në Mbretërinë SKS. Presion të madh ndaj organeve shtetërore për zbatimin e reformës agrare dhe kolonizimit bënte fshatarësia, e cila ishte shumë e dëmtuar nga Lufta e Parë Botërore. Duke u frikuar nga pakënaqësia e masave fshatare, kërkesat të cilat u përkrahën edhe nga klasa punëtore, borgjezia u detyrua të bëjë kompromis vetëm për një shkak që të mos vijë në gjendje të prishet rendi i ri kushtetuese. Borgjezia nuk pati guxim të del haptas e t'i hedhë poshtë kërkesat e fshatarëve, por me premtimet politike, arriti që ta thyejë revoltën.<sup>133</sup>

Nga koha e sjelljes së këtij dekreti, e deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore, kishte vetëm se aq mundësi sa të bëhen përgatitjet e para për popullimin në trevat lindore<sup>134</sup>, me fillimin e Luftës së Parë Botërore, u ndërpreu edhe përgatitjet për kolonizimin e trevave lindore.<sup>135</sup>

Pas Luftës së Parë Botërore shqiptarët e Shkupit me rrethinë humbën çdo prespektivë ekonomike dhe politike, menjëherë filloj shpërngulja e tyre me plane të caktuara nga ana e pushtetit të rijë serb me qëllim që ti sllavizoj qytetin e Shkupit por edhe shumë vise tjera shqiptare. Kështu posa filloj të vendoset pushteti serb, po në të njëjtën kohë filloj një presion politik për shkombëtarizimin e shqiptarëve me metoda të ndryshme. Një ndër këto metoda ishte kolonizimi, ndërsa reforma agrare, e cila propagandohej si masë përparimtare e që në të vërtetë fshihte qëllimin e borgjezisë serbe “kolonizimin e viseve shqiptare dhe shkombëtarizimin e popullsisë shqiptare që ishte me shumicë”.<sup>136</sup>

Gjorgje Kerstiq, në Kosovë dhe Maqedoni, me politikën e tij zyrtare bëri ndërrimin e strukturës së popullsisë pra serbizimin e këtyre viseve. Gjithnjë sipas

---

<sup>132</sup> *Po aty*, 43.

<sup>133</sup> Александер Апостолов, *Колонизацијата на Македонија во стара Југославија*, 38 - 39.

<sup>134</sup> *Po aty*.

<sup>135</sup> Skender Asani, *Veprimtaria e Organizatës Politike Xhemijeti në Trevat Lindore (1919 – 1925)*, 32.

<sup>136</sup> Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1929*, 42.

Kërstiçit, kolonizimi i Serbisë Jugore është çështje shtetërore, sepse duke e rregulluar këtë çështje do të realizohet asimilimi i shqiptarëve dhe ngulitja e elementit sllav, që në praktikë, siç theksoi, do të thotë sigurim i kufijve dhe rendi politik në tërësi.<sup>137</sup>

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, vazhdoi procesi i kolonizimit në trevat lindore. Për atë qëllim, Qeveria e Mbretërisë SKS, më 25 shkurt 1919 e pranoi draftin e reformës agrare dhe e publikoi më 27 shkurt të atij viti me titull: “Dispozitat paraprake për përgatitjen e reformës agrare”. Këto dispozita paraqitnin bazë ligjore për zbatimin e reformës agrare në Mbretërinë SKS, si dhe për kolonizimin e trevave lindore shqiptare. Çështja e kolonizimit të rajoneve jugore (pjesës së Maqedonisë së sotme, Kosovës dhe Sanxhakut), ishte primare, dhe si e tillë u interesonte partive politike (Radikale dhe Demokratike), si dhe institucioneve shtetërore. Kjo çështje në vetvete ngërthente tre elemente kryesore: elementin politik<sup>138</sup>, elementin e nevojës së popullimit me njerëz të vendeve pasive<sup>139</sup>, si dhe elementin financiar.<sup>140</sup>

Që ta rregullojë gjendjen në trevat shqiptare, një nga qëllimet kryesore të Mbretërisë SKS, ishte zbatimi i reformës agrare dhe kolonizimit. Me këtë reformë, do të realizonte dy qëllime: e para, me likuidimin marrëdhënies feudale, do të krijoheshin kushte për zhvillimin normal të kapitalizmit, dhe e dyta, përmes sjelljes së kolonëve serbë, do të vendosej baraspesha etnike. Që të realizoheshin këto qëllime, kolonizimit do t’i paraprijë zbatimi i reformës agrare, e cila do ta trasojë rrugën e ndryshimit të strukturës së popullsisë.<sup>141</sup>

Marrjen e tokave shqiptare, pushteti borgjez serb e institucionalizoi me dhunë, ky pushtet uzurpues, dha urdhëresën për kolonizimin e viseve të çliruara dhe të aneksuara të Mbretërisë Serbe. Tokat e braktisura ishin ato sipërfaqe, pronarët e të cilëve kishin ikur nga dhuna në Turqi, në Shqipëri e vise tjera. Për të vazhduar kolonizimin, domethënë për ti zbatuar planet e mëtutjeshme të presionit ndaj shqiptarëve dhe për sjelljen e elementit

<sup>137</sup> Ali Hadri, *Mardhëniet agrare dhe lufta e PKJ në Kosovë e Metohi kundër reformës agrare të padrejtë të Jugosllavisë borgjeze*, në: Përpapimi, 1964, nr. 9-10, 589-599.

<sup>138</sup> *Населѡавање у Јужној Србији*, “Привредни гласник”, бр.247, дт.29.10.1923, Скопље, 1923, 1.

<sup>139</sup> Që me ardhjen e administratës serbe në Maqedoni pas luftërave ballkanike është konstatuar se në të ka “sipërfaqe toke të shkretë dhe të rabanuar”; Александер Апостолов, *Колонизација на Македонија во стара Југославија*, 34; *Населѡавање у Јужној Србији*, “Привредни гласник”, бр.247, дт.29.10.1923, Скопље, 1923, 1.

<sup>140</sup> *Населѡавање у Јужној Србији*, “Привредни гласник”, бр. 247, 29.10.1923, Скопље, 1923, 1.

<sup>141</sup> Димитрије Богдановић, *Књига о Косову*, САНУ, књига. DLXVI, Београд, 1986; Лазар Марковић, *Економско-финансијски програм народне радикалне странке*, Загреб - Београд - Љубљана, 1925, 12.

sllav duke filluar me Shkupin dhe viset tjera shqiptare. Karakteri i reformës agrare e goditi në radhë të parë fshatarësinë shqiptare, pra shpronësimi i familjeve të kryengritësve shqiptarë, që nuk pranonin të dorëzohen.<sup>142</sup>

U shfytëzuan shumë pronarë shqiptarë tokash, disa prej të cilëve banorë qyteti veçanërisht nga Shkupi, të larguar për shkak të situatës politike që krijuan pushtetëmbajtësit serbë të Beogradit, pas vitit 1918, nuk kishin asnjë mundësi për tu rikthyer në vatrën e veta. Çifçinjët dhe argatët shqiptarë, jo vetëm nuk u kthyen në pronarë të tokave që punonin, por u dëbuan prej tyre si mbajtës të paligjshëm dhe u detyruan të shpërnguleshin. Dokumentacioni i kohës vë në dukje shumë raste të shumta në qytetin e Shkupit dhe rrethin e saj që iu bënë shpronësimi i dhunshëm.<sup>143</sup>

Në fillim të vitit 1919, kolonizimi u zbatua pa asnjë koordinim, dhe nuk u udhëhoq si duhet nga ana e institucioneve shtetërore. Kolonizatorët në fillim populluan fushat, duke pritur të merrnin pronat ku toka ishte pjellore. Në fillim popullimi bëhej më shumë në mënyrë stihike, për shkak se ndihma dhe stimulimi nga ana e shtetit ishin më të vogla. Kolonët në atë periudhë u infiltruan në trevat lindore pa ndonjë plan të veçantë financiar, kurse qeveria siguronte transferimin e tyre përmes hekurudhës. Në atë periudhë, kolonët u lanë në mëshirë të politikanëve dhe spekulantëve. Në këtë drejtim udhëhiqnin radikalët, të cilët kishin një qasje arrogante ndaj popullatës vendase, por edhe ndaj kolonëve të rinj.<sup>144</sup>

Kjo periudhë karakterizohet me konsolidimin e rendit të ri shtetëror, me zgjedhjet lokale e parlamentare, si dhe me miratimin e Kushtetutës. Toka e konfiskuar me reformën agrare, si edhe toka tjetër e cila hynte në fondin e tokave (kullota, toka të papunuara, etj.), zakonisht u ndahej kolonëve, të cilët në numër më të madh ishin sjellë nga rrethet e tjera. Një pjesë e mirë e asaj toke iu dha “punëtorëve kombëtar”, si pensionistëve, xhandarëve, kryeshefave të rretheve, shërbyesve policorë, etj. Pastaj, një pjesë e parëndësishme iu dha bujqve e vendasve, ndërsa turqve dhe shqiptarëve kurrë nuk iu dha asnjë lloj toke.

Pushteti, kolonët i vendoste edhe në shtëpitë e fshatarëve vendas shqiptarë dhe të atyre të shpërngulur. Kolonëve, përveç tokës së dhënë falas, pushteti disave ua ndërtonte

---

<sup>142</sup> Marenglen Verli, *Politika e kolonizimit sllav te trevat shqiptare ...*, 351.

<sup>143</sup> Милован Обрадович, *Аграрна реформа и колонизација на Косово 1918-1941*, 123.

<sup>144</sup> Александер Апостолов, *Колонизацијата на Македонија во стара Југославија*, 82; *Досадашњи резултати и перспектива будићности колонијације у Јужној Србији*, në: „Стара наша Србија“, бр.1, 19.06.1927, Скопље, 1927, 1.

edhe shtëpitë, si dhe u jepte ndihmë në material ndërtimor, vegla pune, kredi, i lironte nga tatimet shtetërore për 10 vjet dhe nga ato komunale për 5 vjet, kurse të drejtën e plotë si pronarëme të drejtë për të shitur atë do ta merrni pas dhjetë vjetësh, transportin falas të tyre, të materialit ndërtimor, veglave të punës, bagëtime etj. deri të vendi i vendosjes etj. U formuan kooperativat agrare nga të cilat kolonët merrnin kredi pa kamatë, material ndërtimor dhe ndihma të tjera. Në mesin e kolonëve të ardhur, që shteti u kishte dhënë tokë, përveç fshatarëve bujq kishte edhe tregtarë, pensionistë, oficerë, nëpunës etj. Për t'i nxitur dhe për t'i tërhequr kolonët që të vijnë dhe të vendosen në Kosovë, makineria propaganduese serbe përdorte në forma të ndryshme propagandën se në Kosovë ka tokë më bollëk, shtëpi të lira etj. Kolonëve të ardhur sllavë, pushteti, përveç tokës “utrinë”, kullota e të tjerë, u ndante posaçërisht tokë të punueshme pjellore të marrë nga pronarët shqiptarë, të cilët ishin të detyruar të shpërngulen jashtë vendit ose të marrin nga kolonët e të punojnë tokën e vet përgjysmë ose me qesim dhe për të edhe të paguajnë më tutje tatimin. Tokën pronarëve shqiptarë pushteti ua merrte edhe me motivacion se është përfshirë në kompleksin agrar dhe për atë shpesh nuk jepte kurrfarë kompensimi, ose nëse jepte atë tokë e jepte të cilësisë së dobët.<sup>145</sup>

Puna e parë e organizuar për zbatimin e Reformës agrare filloi me themelimin e Drejtorisë Agrare në Shkup, më 12 shkurtit 1920. Por zbatimi i plotë i reformës agrare filloi me urdhëresën për kolonizimin e pjesëve jugore të 24 nëntorit 1924.<sup>146</sup>

Për të zbatuar kolonizimin me sukses në këtë vend, Ministria e Reformës agrare e kishte të angazhuar edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, që të intervenojnë menjëherë në raste të çregullimeve.

Drejtorati kryesor me seli në Shkup, sipas nevojës, formonte komisione që caktonin se në cilët vise do të popullzoheshin me sllav, kuptohet në ato vise ku popullsia shqiptare ishte kompakte. Nga shpronësimi arbitrar i autoriteteve të Beogradit nuk shpëtoi as prona e institucioneve fetare shqiptare. Kështu u sekuestruan tokat e disa xhamijave të Shkupit si por edhe të fshatrave perreth qytetit, disa vakëfe u shpronësuan, u shpronësuan edhe disa kisha katolike të shqiptarëve, tokat e varrezave katolike etj.<sup>147</sup>

---

<sup>145</sup> Jusuf Osmani, *Rezistenca e Xhemijetit kundër zbatimit të reformës agrare dhe kolonizimit të Kosovës*, në: SCUPI, nr. 20, Shkup, 2018, 68-70.

<sup>146</sup> Александер Апостолов, *Колонизацијата на Македонија во старата Југославија*, 102-103.

<sup>147</sup> Marenglen Verli, *Reformat agrare kolonizuese në Kosovë 1918-1941*, 101.

Kolonistëve serbe, përveç se u jepej tokë, atyre ju ndihmohej edhe me materiale ndërtimi për vendanimet, dhe i armatosnin kolonistët për siguri, i angazhonin të bëjnë punë spiunimi kundër shqiptarëve dhe nga ana tjetër ushtria çarmatosnin popullsinë shqiptare. Drejtorati agrar i Shkupit kishte marrë kredi nga Ministria e reformës agrare, që duhej përdorur përshpenzimet rreth barjtes së kolonistëve që popullsia e re në Shkup, të jetë më e sigurtë dhe më e qetë. Kolonistët që u vendosën në Shkup, gëzonin këto të drejta: të bartin pa pagesë të gjithë antarët e familjes dhe bagëtinë me hekurudhë. Poashtu gëzonin të drejtë të sjellin pa doganë bagëti, makina bujqësore, fare dhe drith për ushqim nga jashtë. Pra kolonistët liroheshin nga të gjitha tatimet për tre vjet. Vendasit shqiptarë jo vetëm që mbeteshin pa tokë por ishin të detyruar edhe tu shërbenin kolonistëve.

Sipas këtij dekreti kolonizimi bëhej duke u dhënë shteti vullnetarëve tokë për përdorim dhe banim dhe duke u mbështetur mund të shënoheshin si tokë koloniste. Në gazetën “Politika”, të asaj kohe, lidhur me qëndrimin e Punisha Raçiqit, thuhet: se ai vet personalisht vrau e masakroi shqiptarët duke bërë një gjenocid të paparë të në atë kohë, në rajonin e Shkupit kaloi në viset e Malit të zi të Shkupit dhe atje rrëmbeu 50 mijë hektarë tokë.<sup>148</sup>

Në vitin 1928, qeveria e Beogradit thotë se sipas tyre reforma agraree Beogradit nuk është zbatuar sipas tyre, sepse është dashur të vendosen në Kosovë dhe Maqedoni më shumë kolonistë serbë, malazezë etj. Sipas statistikës që është mbajtur në Seksionin teknik të Drejtoratit Agrar në Shkup deri më 1 janar 1928 janë caktuar 225397 hektarë tokë në 1923 komplekse.<sup>149</sup>

Për keqpërdorimet dhe masat antihumane ndaj popullsisë shqiptare, shkroi edhe shkencëtari frëng Zhak Ansel, i cili në veprën e tij shkruan, se: Çështja e kolonizimit në Krahinat shqiptare është mare me gjithë shpirt dhe se ai pat filluar zyrtarisht në vitin 1921, duke përdorur kolonistë nga viset e ndryshme të Jugosllavisë, në mënyrë që ato në vendet ku po vendoseshin, të ruanin autoritetin dhe tërësinë e Mbretërisë serbo-kroato-slllovene. Për këto qëllime ishin shpërngulur nga katundarë që në të vërtetë nuk kishin nevojë të lakmonin toka tjera, sepse kishin pasuri toksore mjaftë të mire në vendin e tyre, por shteti duke u premtuar tokat shqiptare i përshkruanin si parajsë toksore, ku do të

---

<sup>148</sup> Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë 1918-1941*, 64.

<sup>149</sup> Александер Апостолов, *Колонизацијата на Македонија во старата Југославија*, 209.

pasuroheshin edhe më shumë. Elementi shqiptar, sado i shtypur, i persekutuar dhe i varfëruar nga grabitjet sistematike të autoriteteve borgjeze jugosllave, ka treguar një gjallëri të atillë saqë ka mbetur i paprekur si në sasi ashtu edhe në fuqinë e tij morale.<sup>150</sup>

Reforma agrare në trevat lindore, u shfrytëzua si mjet për zbatimin e kolonizimit. Borgjezia serbe, në trevat lindore, Kosovë, Sanxhak e Vojvodinë, këtë e shihte si një masë ekonomike, por edhe si politikë sociale-nacionale për forcimin e rajoneve kufitare.<sup>151</sup>

Me reformën agrare dhe kolonizimin, synonte ndryshimin e strukturës etnike në trevat shqiptare, duke instaluar administratë politike asimiluese ndaj popullatës vendase. Mënyra e kolonizimit në këto treva ishte specifike dhe ndryshonte nga pjesët tjera të Mbretërisë SKS. Zbatimi i reformës agrare ishte vënë nga ana e pushtetit si “qëllim nacional” për kolonizimin dhe serbizimin e territoreve të trevave lindore. Ky synim shtetëror për kolonizim ishte inkorporuar edhe në programet e partive udhëheqëse.<sup>152</sup>

Në fillim, reforma agrare ishte në kompetenca të Ministrisë për Politikë Sociale, kurse me dekretin e datës 12.02.1920, ishte themeluar Ministria e Reformës Agrare, e cila në strukturën e saj organizative kishte nën kompetencë departamentin e përgjithshëm dhe atë agrar. Në nenin 27, departamenti agrar solli dekret që në Shkup të formohet Drejtoria Agrare, kurse për organet e saja ekzekutive u formuan rregullore, qarkore dhe komisione agrare.<sup>153</sup>

Shkupi ishte qendër e Komitetit Agrar, i cili kishte komitetet qarkore në trevat në Kosovë dhe në Sanxhak. Degë kryesore e ekonomisë në këto troje ishte bujqësia dhe 80% e banorëve merreshin kryesisht me përpunimin e tokës. Inspektori i Ministrisë së Reformës Agrare, Gjoko Bogojeviq, deklaronte se “pronësia duhet t’i takojë atij i cili e punon tokën” dhe se organet shtetërore, në plan të parë duhet ta kenë zbatimin e shpejtë të reformës agrare dhe kolonizimit, në territoret ku elementi serb është më i vogël.<sup>154</sup>

Marrëdhëniet feudale, ligjërisht u eliminuan me nenin 42 të Kushtetutës së Vidovdanit, me të cilën rregulloheshin disa parime, sipas të cilave kryepreqve, çifligarëve

<sup>150</sup> Jacques Ancel, *La Macedonie*, Paris, 1930, sipas: *Gazeta Kosova*, Konstancë, 1932, 3-4.

<sup>151</sup> Надежда Цветковска, *Македонското прашање во Југославенскиот парламент меѓу двете светски војни*, Скопје, 2000, 139.

<sup>152</sup> Чедомил Митриновиќ, *Колонизација Јужних Крајева*, Београд, 1939, 3-4.

<sup>153</sup> Александер Апостолов, *Колонизацијата на Македонија во стара Југославија*, 101-102.

<sup>154</sup> Токо Богојевиќ, *Аграрна реформа*, Јубиларни Зборник живота и рада Срба, Хрвата и Словенаца 1918 - 1928, број. 198, Београд, 1938, 299-306.



dhe në përgjithësi atyre që e punonin tokën në çiflig, i vërtetohej liria e pronës së tokës shtetërore, dhe për të nuk paguanin kurrfarë kompensimi. Bejlerët, çiflig-sajbitë, si dhe pronarët të cilët e kishin tokën në pronësi, nuk kishin kurrfarë përgjegjësie ndaj kryepleqve dhe çifligarëve. Dëmi nuk ishte i qartë deri në fund. Në Kushtetutë ishte potencuar që pronarët e rinj nuk do ta paguajnë dëmin; kush do ta paguante, si do ta paguante, sa do të ishte çmimi dhe si do të kompensohej, për këto çështje Kushtetuta nuk parashihte asgjëgjatë sjelljes së Kushtetutës, pati debat të ashpër për nenet e Kushtetutës që kishin të bënin me reformën agrare. Debati më i madh u zhvillua rreth pjesës së tretë. Vetë qeveria për këtë çështje nuk ishte homogjene. Qeveria nuk ishte e sigurt deri në fund se mund t'i siguronte votat për miratimin e Kushtetutës.<sup>155</sup>

Kjo gjendje ishte në llogari të politikës serbe, e cila përmes reformës agrare donte të zbatojë kolonizimin. Popullata vendase kritikonte praktikën e marrjes së tokës nga fshatarët dhe dhënies njerëzve që nuk merreshin me punimin e saj për shkak se të njëjtit u bënë rentierë. U kritikua edhe mbajtja e marrëdhënieve të çifligjeve dhe pagesa e hakut. Me politikën e keqe agrare dhe kolonizuese, u krijua një lloj padurimi në mes të popullatës vendase dhe kolonëve.<sup>156</sup>

Me krijimin e Mbretërisë SKS, dhe posaçërisht me proklamimin e reformës agrare, edhe bashkësitë fetare si zotëruese të pronave të mëdha duhej të viheshin në shërbim të zbatimit të kësaj reforme. Në këtë drejtim, Kisha Ortodokse Serbe, ishte e privilegjuar, dhe ajo u vu në shërbim të kolonizimit të trevave lindore. Kisha Katolike e përkrahte zbatimin e reformës agrare, dhe ishte në gjendje që një pjesë të pasurive që i zotëronte “për ndarje të drejtë”, t'i vë në shërbim të shtetit.<sup>157</sup>

Për dallim nga vendet e tjera, reforma agrare i dëmtoi vetëm se pronat e feudalëve, për shkak se shumica prej tyre kishin prona sipas rregullave ligjore maksimaliste. Fshatarët shpresonin se pas likuidimit të marrëdhënieve çifligare, do të fitonin tokë punuese nga pronat e bejlerëve e agallarëve, të cilat i punonin, dhe për këtë arsye edhe e përkrahën reformën agrare.<sup>158</sup>

---

<sup>155</sup> Уставни одбор о аграрној реформи, në: “Мисао“, књига. II, св. 41 -48, Београд, 1921, 134.

<sup>156</sup> Надежда Цветковска, *Македонското прашање во Југославенскиот парламент ...*, 140-141.

<sup>157</sup> Владислав Стакић, *Аграрни проблеми колонизација и њене тешкоће*, në: “Политички гласник“, година. III, број. 78, дт. 20.10.1927, Београд, 1927, 10- 11; Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918 - 1941)*, 41.

<sup>158</sup> Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918 - 1941)*, 53.

Në pjesën e Maqedonisë së Vardarit posaqërisht në Shkup, pronarët e mëdhenj të cilët kishin marrë me qira pronat e bejlerëve, pritnin që kjo çështje do të zgjidhet me ligj, i cili ishte vetëm se një kusht i përkohshëm, i cili zgjati në vitet 1931-1934, kur këto marrëdhënie filluan të zgjidheshin në gjykatat agrare. Këtë gjendje më së miri e shfrytëzuan feudalët e vjetër, të cilët këto prona ua shitën atyre që e punonin tokën. Në trevat lindore, Kosovë dhe Sanxhak, fshatarët e pasur nuk kishin ndonjë përfitim nga reforma agrare.<sup>159</sup>

Mënyra e zbatimit të reformës agrare, ishte shumë komplekse, e përcjellë me paqartësi në zbatimin praktik dhe e eksploatuar për përfitime politike nga ana e partive. Gjatë marrjes së tokës së myslimanëve, aspak nuk merrej parasysh fakti nëse për ta ajo tokë ishte minimumi për jetë ose jo, nëse bëhej fjalë për oborr, bahçe, etj. Neni 27 i “Dekretit për popullim” të rajoneve jugore, ishte si më poshtë: *„Kur do të matet toka për popullim, në atë rast merret parasysh edhe pronësia private, përkatësisht toka private, dhe nëse pronari dëshmon se është në të drejtë, toka megjithatë do t’i lihet kolonizatorit në shfrytëzim, kurse pronarit të tokës së konfiskuar do t’i jepet tokë në vend tjetër”*.

Sipas A.Urosheviq deri në vitin 1928, në Sërbinë e Jugut u vendosën 5000 familje, të ndarë në 6250 shtëpi. Po ashtu ai jep një statistikë të gjërë të kolonizimit sllav në Sërbinë Jugore deri në fund të vitit 1936.<sup>160</sup>

Dallimet për reformën agrare, ndërthureshin brenda në qeveri, ku ky debat i ashpër u transferua edhe në Kuvendin Ligjdhënës. Këto paqartësi dhe mangësi në nenet e Kushtetutës, të cilat kishin të bënin me reformën agrare, veçanërisht çështja e pronave të mëdha, do të shkaktonte kundërthënie të mëdha në mes të pushtetit dhe opozitës parlamentare. Partitë politike, në varësi nga interesi i tyre, kishin qëndrime të ndryshme për reformën agrare dhe kolonizimin. Këto dy procese, subjektet politike i shfrytëzuan që të përfitojnë sa më shumë vota në zgjedhjet lokale dhe ato parlamentare. Sidomos, Partia Demokratike dhe Partia Radikale i shfrytëzuan këto reforma për llogari politike. Në ato rrethana, Xhemijeti, dëshironte t’i ruajë interesat e saj politike, duke pritur më shumë mundësi që të rritej çmimi i pronave dhe që të prolongohej sa më tepër që të ishte e

---

<sup>159</sup> *Po aty*.

<sup>160</sup> Алексије Јелачич, Франце Масеснел, Атанасије Урошевич, *Скопје и Околнину*, Скопље, 1937, 830.

mundur reforma agrare.<sup>161</sup>

Qëndrimi i partive politike ndaj reformës agrare dhe kolonizimit, në mënyrë të drejtpërdrejtë u reflektua në zgjedhjet parlamentare dhe në fitimin e mandateve të deputetëve në Kuvend. Në këtë drejtim, Xhemijeti gjatë funksionimit të saj si parti politike, nuk arriti që ta ndërpresë zbatimin e reformës agrare dhe kolonizimit, por përmes kushtëzimeve, arriti që ngadalësojë zbatimin e saj në trevat lindore.

Ndikimi i deputetëve në jetën shoqërore politike në trevat shqiptare, ishte aq i madh, sa që organet shtetërore nuk ishin në gjendje që të reagojnë edhe ndaj mosrespektimit të Kushtetutës. Në këtë situatë, shkelësit më të mëdhenj të ligjit ishin deputetët e Partisë Radikale. Forcimi i ndikimit të deputetëve do të jetë edhe më i theksuar në periudhën e fitores së Partisë Radikale në vitin 1920. Përmes të ngarkuarve për zbatimin e reformës agrare, policia dhe organet shtetërore të cilat ishin të dirigjuar nga deputetët radikalë që kishin prona, bëhej presion ndaj shqiptarëve dhe turqve, të cilëve nga dita në ditë u keqësohej gjendja dhe ekzistenca.<sup>162</sup>

Qëndrimi i Partisë Radikale në lidhje me çështjen e reformës agrare, ishte në përputhje me veprimtarinë e saj politike. I njohur është angazhimi i saj me Kartën e Korfuzit. Me këtë kartë ishte vendosur që çdo emigranti, pjesëmarrës në luftë, t'i ndahen pesë hektarë tokë pjellore në vende të banueshme. Në këtë kartë poashtu parashihej që nëse një ushtar vullnetarë do të vritej, trashëgimtar të jetë familja e tij.<sup>163</sup>

Partia Radikale ishte e detyruar që të merr qëndrim më të fortë ndaj reformës agrare dhe kolonizimit, duke vlerësuar se ky qëndrim do t'i sillte vota në zgjedhjet për Kuvendin ligjvënës. Në konferencën qendrore të radikalëve më 28.09.1920, u konstatua se zbatimi i reformës agrare duhet të jetë në korelacion me kolonizimin. Në këtë konferencë u vlerësua se kolonizimi së pari duhet të zbatohet ndaj pronave shtetërore dhe komunale, e derisa ato prona nuk i plotësojnë nevojat e duhura, atëherë duhet të ndahen pronat private. Me këtë tentohej që kolonizimi të zbatohet në territoret e populluara me joserbë. Këto territore kryesisht gjendeshin në trevat lindore, në Kosovë dhe Sanxhak. Në

---

<sup>161</sup> Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918 - 1941)*, 55.

<sup>162</sup> Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918 - 1941)*, 68-69.

<sup>163</sup> Томо Миленковић, *Став Радикалне странке према аграрној реформи 1918 - 1929*, Историја XX века, Зборник радова - XI, Београд.

këto vende tentohej që nëpërmjet popullimit, të forcohej elementi serb.<sup>164</sup>

Këtu ishte edhe gabimi i radikalëve, të cilët bënëin padrejtësi të mëdha ndaj shqiptarëve, turqve dhe bashkësive të tjera, si gjatë reformës agrare, poashtu edhe në domenet e tjera shoqërore, meqë i llogaritnin për qytetarë të rendit të dytë. Në ato vende, u ndanë pronat e banorëve lokalë – autoktonë, pretendimet e bejlerëve u plotësuan me prona të tjera, derisa tokat më të mira iu ndanë kolonizatorëve.<sup>165</sup>

Në mbledhjen parlamentare të mbajtur më 29 korrik të vitit 1922, kur u diskutua për buxhetin, deputeti Millan Pribiqeviq e shfrytëzoi momentin për t'i parashtruar pyetje ministrit të Reformës Agrare, për atë se deri ku ka arritur popullimi dhe kolonizimi i trevave lindore. Ministri, Kërsta Miletiq, në pyetjen e parashtruar u përgjigj se kolonizimi jo vetëm që po zbatohet, por në trevat lindore, në Kosovë dhe Sanxhak, e ka arritur kulmin, duke argumentuar se nga pranvera e deri në korrik të vitit 1922, në këto vende u sollën 2000 familje me kolonizatorë, të cilat populluan tokat më pjellore të rajoneve jugore.<sup>166</sup>

Kolonizimi në territorin e fushës së Kosovës, fushës së Shkupit dhe Kumanovës, deri në gjysmën e vitit 1922, arriti që t'i plotësojë të gjitha parashikimet nga ana e organeve shtetërore.<sup>167</sup>

Në jetësimin e programit dhe ngritjen e organizatës politike Xhemijeti, rol të rëndësishëm kishte lideri i saj shpirtëror Nexhib Draga, e pastaj edhe Ferhat bej Draga. Xhemijeti dinjitetshëm përmes disa deputetëve të saj në Parlamentin e Mbretërisë SKS, i përfaqësoi interesat e myslimanëve (shqiptarëve dhe turqve) në këtë shtet, duke kundërshtuar në radhë të parë kolonizimin dhe reformën agrare, si dhe ndërprerjen e depërtimit të tyre në Turqi dhe Shqipëri.<sup>168</sup>

Qëndrimi i Xhemijetit për këtë çështje u paraqit në Kongresin e Tretë të mbajtur në Shkup, më 14.04.1922. Deputetët e Xhemijetit para kongresit e paraqitën qëndrimin e tyre se pronat nuk kanë asgjë të përbashkët me pronat e çiflig-sajbive, për shkak se

---

<sup>164</sup> Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918 - 1941)*, 65-68.

<sup>165</sup> *Колонизација Јужне Србије*, "Време", Београд, 28.02.1923, 3.

<sup>166</sup> *Стенографске белешке Народне Скупштине Краљевине Срба, Хрвата и Словенаца*, Редован сазив за 1921 – 1922 год, књига.V, Београд, 1922, 1092 - 1093.

<sup>167</sup> ДАРМ, фонд: Македонски Национален Комитет, inv. 26.9.932.2671, *Zakon o naslel javanju Južnih Krajeva*.

<sup>168</sup> Jusuf Osmani, *Rezistenca e Xhemijetit kundër zbatimit të refor,ës agrare dhe kolonizimit të Kosovës*, 75.

marrëdhëniet feudale u ndërpre në vitet e 40-ta të shekullit të 19-të.<sup>169</sup>

Me këtë qëndrim, Xhemijeti dëshironte ta eliminojë zbatimin e një neni të Kushtetutës, ku parashihej eliminimi i marrëdhënieve feudale, me çka do të legjitimohej kolonizimi i këtyre trojeve. Ferhat Draga në një intervistën për gazetën “Hak“, do të përgjigjet në pyetjen që kishte të bënte me kolonizimin: *“Ne nuk jemi kundër që kolonizimi të kryhet në ato vende ku ka pak banorë dhe tokë të mjaftueshme për ata. Por, konsiderojmë se më parësore është që të furnizohen me tokë vendasit tanë që janë bujqër dhe nuk kanë tokë të mjaftueshme, dhe më në fund të kryhet banimi i bujqve të vyeshëm nga viset pasive. Në mesin e kolonëve të cilët tani vijjnë, një pjesë e madhe janë ata të cilët nuk janë për punimin e tokës. Në Metohi ka raste qesharake, ashtu që kolonisti e merr pushkën dhe guslën dhe zë vend nën hije, ndërsa tokën ia punojnë shqiptarët nën presionin e autoritetit të pushkës. Ka raste kur i merret livadhi dhe ara bujkut shqiptar i cili me shekuj e ka punuar tokën dhe u jepet kolonëve. Ka raste kur kolonët e presin fqinjin e tij shqiptar që të mbjellë, të korrë, dhe bereqetin ta vendos në hambar, ndërsa pastaj ai shkon dhe e merr atë”*.<sup>170</sup>

Në datën 11 dhjetor 1923, “Politika” boton artikullin “Qeveria i lëshon pe Xhemijetit”, ku theksohej se në një mbledhje të Klubit të deputetëve radikal, u diskutua gjerësisht. Lidhur me agrarin u tha se nuk pajtohen që Xhemijetit t’i jepet ndonjë koncesion në aspektin e agrarit. U zhvillua një diskutim i gjerë. Xhemijeti, megjithatë nuk ka qenë aq optimist, i disponuar, z.Ferhat beg Draga ka deklaruar mbrëmë se ende nuk ka ardhur deri te prurja definitive e vendimit. Sepse, ka thënë z.Draga, atë që radikalët mendojnë për kërkesat tona, neve na janë të njohura vetëm nga gazetata. Zyrtarisht asgjë nuk na është thënë. Se a do të marrim pjesë në mbledhjen e Kuvendit ose jo, do të vendosim para mbledhjes. Se, siç deklarojnë deputetët e Xhemijetit, të cilët dje kanë ardhur në Beograd, me këmbëngulje kërkojnë që Qeveria të heqë dorë nga kolonizimi i Kosovës dhe Metohisë. Nëse nuk dëshiron që ta ndërpresë, atëherë që atë ta bëjë deri me sjelljen e ligjit agrar. Në mbledhjen e Këshillit financiar lidhur me Buxhetin e Ministrisë së Reformës agrare është diskutuar gjerësisht për çështjen agrare.<sup>171</sup>

<sup>169</sup> *Питање аграрне реформе*, në: „Јужна Србија“, књ.11, бр.9, Скопље, 16.07.1922, 32.

<sup>170</sup> *Изјаве г. Ферхад бег Драге*, “ХАК“, бр. 678, Скопље, дт.28.11.1923, 1.

<sup>171</sup> Jusuf Osmani, *Rezistenca e Xhemijetit kundër zbatimit të refor,ës agrare dhe kolonizimit të Kosovës*, 80-81.

Shumë deputet shqiptarë të Xhemijetit diskutojnë në Parlamentin e Mbretërisë SKS, përkatësisht jugosllave kundër zbatimit të reformës agrare. Kështu, Aqif Blyta, në mes tjerash thekson: “Nuk është e vërtetë se kanë marrë vetëm tokat e bejlerëve dhe të parisë. Ata (nëpunësit agrarë) marrin fushat e bujqve shqiptarë dhe ua japin të pasurve, funksionarëve dhe avokatëve serbë. Zotërinj, në Serbinë jugore ligji agrar ka çuar në uri vetëm shqiptarët. Asnjë serbi nuk i është marrë asnjë pëllëmbë toke”.<sup>172</sup>

---

<sup>172</sup>*Po aty.*

### III.2. Reformat agrare dhe kolonizuese gjatë viteve 1929-1941

Ngjarjet në Kuvendin Popullor të vitit 1928 ku u vra Stjepan Radiqi, e shfrytëzoj mbreti Aleksandër, i cili, më 6 janar 1929, aprovoi Diktaturën, shpalli Mbretërinë Jugosllave. Ai hoqi kushtetutën dhe ndërpreu punën e partive politike, dhe vendi u emërua Mbretëria e Jugosllavisë, e ndarë në dy njësi teritorial-administrative, duke e ndarë në Banovina. Kjo diktaturë, i keqësoi raportet ndëretnike në shtet, duke bërë vrasje politike. Bartës kryesor të diktaturës, paralel, u themelua ushtria dhe policia, e cila parandalonte çfarëdo përpjekje, angazhim dhe organizim të partive borgjeze, të cilat vepronin në kuadër të Mbretërisë Jugosllave. Sundimi i Mbretërisë Jugosllave, mbi hapësirën territoriale mbi Shkupin me rrethinë, bënte çmos vetëm e vetëm, këto territore, sipas projekteve të parapara të jenë serbe.<sup>173</sup>

Qarqet sunduese, e hedhin poshtë kolonizimin si mjet të tyre, dhe përqafojnë energjikisht shpërnguljen me masë të shqiptarëve. Prandaj qysh në vitin 1933, Mbretëria Jugosllave filloi bisedimet me Turqinë, për të mirat materiale të turqve në Jugosllavi. Me këtë Marrëveshje Qeveria jugosllave, detyrohet të ndërpresë në të ardhmen, të mirat që u kanë takuar qytetarëve turq-shqiptarë në Jugosllavi. Ndërsa Turqia, zotohet nga pala e tyre, se pas shpërnguljes së tyre në Turqi mendohet për shqiptarët ajo do tu mundësoj pushtet të lirë, sundesve jugosllav tërë pasurinë, të drejtën e interesave në tërë territorin, ku kishin banuar ata, ishte fjala për Kosovën dhe luginën e Vardarit. Marrëveshja për shpërnguljen e shqiptarëve kishte filluar qysh para vitit 1929, por mbaheshte sekrete nga të dy palët.<sup>174</sup>

Qarqet më të larta ushtarake të Mbretërisë së Jugosllavisë, synonin ta përfitonin pakicën turke në Jugosllavi, me pretekst të përshtatshëm, për të përligjur shpërnguljen me dhunë të popullsisë shqiptare, duke e paraqitur atë si turke. Komanda e Zonës së Armatës III-të kërkonte, që shpërngulja në Turqi, të përfshinte në radhë të parë, “shqiptarët e zonës kufitare” me shtetin shqiptar, më pas, rajone tjera, ndërsa shpërngulja, sado e vogël,

<sup>173</sup> Александер Апостолов, *Колонизација на Македонија во Стара Југославија*, 168-170.

<sup>174</sup> Rauf Fico, *Shtetar dhe diplomat shqiptar* (monografi), Tiranë, 2007, 93.

e popullsisë turke, do nevojitej vetëm “*për të lehtësuar, për të mbuluar shpërnguljen e shqiptarëve...*”.<sup>175</sup>

Gjenocidi serb i ushtruar mbi popullsinë shqiptare për të detyruarshpërnguljen e dhunshme të tyre në mënyrë të organizuarpërshkruhet edhe në “Promemorien” e tre famullitarëve të KishësKatolike Shqiptare të Kosovës: Don Jovan Bisaku, Don ShtjefanKurti dhe Don Luigj Gashi, dërguar më 5 maj 1930, Sekretarit tëLidhjes së Kombeve në Gjenevë, Erik Dramondit. Paralelisht me shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve, autoritetet eatëhershme serbe filluan edhe aksionin e kolonizimit të viseveshqiptare me serbë e malazez, që fillimisht do të zbatohet në emërtë “Reformës Agrare”.<sup>176</sup>

Qëllimi i tyre ishte që edhe në të ardhmen të vendosej kolonë sllav sipas Kërstiqit i cili pohonte se në Shkup me rrethinë, Kumanovë dhe Preshevë një kujdes i veçantë ju kushtua kolonizimit ose me të drejt pajisjes me më shumë tokë të elementit kombëtar vendas i cili nuk kishte qenë në marrëdhënie fqinjësore, kështu ju dhanë tokat pjellore banorëve të 10 fshatrave serb që gjendeshin në jug të Malit të Zi të Shkupit, mirëpo ky kolonizim u përhap edhe në Tetovë, Gostivar por më së shumti e përjetoi popullata e Kosovës.Në rrethin e Shkupit u vendosën 10 koloni, në 12 vendbanime që do të thotë se rreth 429 familje të vendosura në Shkup dhe rrethinë, gjatë periudhës së fazës së dytë, një theks i veçantë është të përmendet se 30 familjet e vendosura në Dushanovë, Shkup nga ministria e Bujqësisë dhe e ujërave morën u ha prej 250.000 dinarësh por kishte koloni që siguronin edhe forma kredia shumë tepër të mëdha që arinë deri më 100.000 dinarë gjatë periudhës së vitit 1929, kredit u shtuan gjithnjë e më shumë ku sipas kooperativës agrare në varësi të Drejtorisë së Lartë Agrare të Shkupit për të ndihmuar familjet e kolonëve nga viteve 1929-1933, u akordua një fond prej 52.423.000 dinarësh.<sup>177</sup>

Kjo ndihmë ndihmuar kolonëve sllav ishte qëllimi i shpërnguljes së popullatës shqiptare dhe në to të vendosen popullata serbe. Diktatura e 6 janarit e vitit 1929, në Shkup dhe rrethin, rriti edhe më shumë shpenzimet për mbarëvajtjen e kolonizimit, ku veproi përmes dhunës antishqiptare të organeve agraro-kolonizuese dhe xhandarmëria

<sup>175</sup>*Historia e popullit shqiptar*, v. III, 486-487.

<sup>176</sup> Qerim Lita, *Diplomacia shqiptare në Shkup (1935 – 1941)*, në: SCUPI, nr. 12, Shkup, 2018, 56.

<sup>177</sup> Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë 1918-1941*, 50-55.



udhëhiqej nga autoritetet qeveritare që çdo kolonë pa asnjë autorizim dhe plan u vendoseshin pa e pyetur për pronësinë e shqiptarëve.<sup>178</sup>

Në ligjin mbi kolonizimin e krahinave të jugut të 11 qershorit të vitit 1931, ruajti në përgjithësi të njëjtën strukturë të tyre ku drejtorja e lartë agrare e Shkupit mbeti organ kryesor vartësi e ministrisë së bujqësisë në trevat Shqiptare gjithashtu edhe në Shkup me Rrethinë. Këto kishin komisionet e veta për të kryer në derven funksionimin dhe ndarjen e tokës për qëllimin e kolonizimit të cilët ishin të ngjashëm si më parë.<sup>179</sup>

Drejtorja e Lartë Agrare e Shkupit do të kujdesej edhe për zbatimin e ligjit të ri ku qëllimi i saj ishte zgjidhja e çështjeve agrare të pronësisë së tokave që mbeteshin në duar të buqëve, si dhe të gjitha rastet e diskutueshme që lindnin nga zbatimi i ligjit, ju kaluan gjykatave agrare Ardhja e kolonëve serbë nga Dalmacia (Mali i Zi), Hercegovina, Vojvodina e vise tjera të Mbretërisë Jugosllave, vendosja e tyre në tokat shqiptare, ishte me pasoja tejet të rënda si në aspektin ekonomik poshtu edhe në aspektin shpirtëror, social, politik, nacional, kulturor e tradicional. Shqiptarët, gjatë sundimit mbretëror-jugosllav, jo që nuk gëzonin të drejtat më elementare, por ndaj tyre udhëhiqej një politikë diskriminuese, e veçantë në aspektin politikë, ekonomik social dhe kulturor.<sup>180</sup>

Kolonizimi, ushtrohej drejtpërdrejtë me iniciativën e mbretit Aleksandër, i cili përmes Nikola Pashiqit dhe sidomos përmes: Punisha Raçiq, i cili, realizonte qëllimet e veta më të errëta. Në rastet kur shqiptarët kundërshtonin kolonizimin, apo diç tjetër, menjher pasonin Urdhëresat ministrore me pasojat prezantuese.<sup>181</sup>

Për këto toka pjellore, shfaqte interesim popullata nga Vranja, Toplica, Jabllanica, Surdulica, Mali i Zi, Hercegovina dhe Lika. Në veçanti ndryshim të strukturës së popullsisë ka pësuar Tasjani (Gjorçe Petrovi), në favor të popullatës sllave. Koncentrimin më të madh të kolonëve, ku pushteti sllav e kishte bërë veçanërisht në trevat e Kosovës dhe të Shkupit me rrethinë (B.R). Konstatimi i bazuar se gjendja nga ardhacakët kolonë, gjithnjë e vështirësonte dhe e rrezikonte ndërrimin e raportit etnik në favor të elementit

---

<sup>178</sup> Jusuf Buxhovi, *Kosova nga Konferenca e Londrës deri te protektorati ndërkombëtar*, 179-190.

<sup>179</sup> Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë 1918-1941*, 117-119; Александер Апостолов, *Колонизација на Македонија во Стара Југославија*, 64.

<sup>180</sup> Millutin Folliq, *Akcije Studenata Kosova za prava Allbanskog naroda u periodu 1937-1941*, në: "Kosova", nr. 8, 1979, 45.

<sup>181</sup> Gazeta "Rad", nr. 64, 5.VIII.1928.

sllav, për këto qëllime ekspansioniste, pushteti kishte ndaluar përdorimin e gjuhës shqipe.<sup>182</sup>

Në një plan të dhomës Agrare në Shkup, në të cilin përfshihen vendbanimet të rrethit të Shkupit dhe të Kumanovës, e që sipas udhëheqësve të atëhershëm të asaj dhome, ekzistonin kushte për vendosjen e kolonive serbe. Në rrethinën e Shkupit: Vllae, Orizare, Novo Sellë, Zllokuçan, Vuçi Doll, Bardovcë, Ormanë, Saraj, Vizbeg, Brazdë, Mirkovcë, Glluvë, Taftalixhe, Earanë, Lisiçe e Epërm, Draçevë, Lisiçe e Poshtme, Lubosh, Zelenikovë, Harashanë, Pakoshevë, Bujkovcë, Aleksandrovë, Belimbegovë, Hasanbeg, Trubarevë, Stajkovc, Inxhikovë, Dushanovë, Bërnjarcë, Ognjancë, Idrizovë, Jurumlerë, Rashtak, Creshevë, Butel, Konjare e Epërme, Konjare e Mesme, Shishovë, Katllanovë dhe Radishan. Në rrethinën e Kumanovës: Mërshevcë, Umin Doll, Petrovo Sellë, Delladrovçë, Buçincë, Rramanli, Gnillanovac, Studen Breg, Reçicë, Lubodrag, Çerkez, Opajë, Llopat, Ropalcë, Meteq, Tromegjë, Projevcë dhe Mllado Ngorariçan. Sipas këtij plani, rezulton se në rrethin e Shkupit, ishin paraparë të krijoheshin 41 koloni serbe, ndërsa në rrethin e Kumanovës tetëmbëdhjetë. Veç kësaj autoritetet e atëhershme serbe parashihnin edhe krijimin e kolonive serbe brenda në qytetin e Shkupit edhe atë: "Qendra e Shkupit, Vodno e Poshtme, Vodno e Epërme, Nerezi i Poshtëm, Kisella Voda, Maxhari, etj. Në vitin 1935 pushtetarët e Beogradit, përkatësisht, Dhoma e Reformës agrare në Shkup, filloi një aksion edhe më të ashpër, sa i përket konfiskimit të tokës pjellore nëpër vendbanimet shqiptare. Aksioni i ri parashihte që "fshatarëve shqiptarë, t'u lejohej vetëm 0,4 hektar tokë për një anëtar të familjes." Qëllimi i kësaj politike, siç bënin të ditur raportet e ndryshme të organeve policore dhe ushtarake serbe, ishte "dëshpërimi i banorëve shqiptarë", sidomos i fshatrave "që shtrihen buzë Malit Sharr, e deri në hapësirën Kumanovë-Prishtinë. Në këto treva fshatrat shqiptare ishin tepër kompakte".<sup>183</sup> Në vitin 1936, Shkupi kishte 30.000 banorë "serbë jo vendas", që përbënin mbi 40% të popullsisë së qytetit, ndërsa në periferi të qytetit ishin vendosur 10.000 kolonë.<sup>184</sup>

Sipas konstatimeve të ndryshme, një gjendje e ngjashme me këtë, mbretëronte edhe në vendbanimet e tjera ndër qytete të viseve shqiptare. Në bazë të shënimeve të

<sup>182</sup> Millotin Folliq, *Akcije Studenata Kosova za prava Allbanskog naroda u periodu 1937-1941*, 47.

<sup>183</sup> Qerim Lita, *Diplomacia shqiptare në Shkup (1935 – 1941)*, 57-58.

<sup>184</sup> AHI, Tiranë, Dok. A-VII-51.

Komisarit të Lartë Agrar Gj.Kërstiq, ku vërehet se, falë kolonizimit, Shkupi e ka dyfishuar popullimin e vet, Presheva kishte serbë gati gjysmën e shtëpive.

Rreth 200.000 kolonëve, të ardhur në trevat shqiptare, në kohën e Mbretërisë Jugosllave, njihej në opinionin ballkanik, ashtu edhe në atë Evropian e më gjërë. Por, për habi, karakteristikë e kolonëve serb, ishte pa ngopshmëria sllave të etur për tokat shqiptare nuk kishte fund. Ndërsa përfaqësuesit e kolonëve, me pezëm pohonin: “Edhe pse me këtë kolonizim masiv në Kosovë dhe vise të tjera shqiptare, përsëri, ishte herët të thuhet se Kosova është jona”.

Mbretëria jugosllave, për të siguruar dominimin e tyre në trevat shqiptare e veçanërisht në Kosovë, parashihnin të sjellin edhe 470.000 kolonë tjerë, gjë që ishte e pamundur, sepse shqiptarët dinin të rezistonin në forma të ndryshme. Sipas arkitektëve shovinistë serb, shqiptarët duhej të asimiloheshin, të shkombëtarizoheshin dhe të shndërroheshin në pakicë.<sup>185</sup>

Deri në fund të tetorit të vitit 1940, sipas shënimeve të Drejtorisë Supreme të Reformës Agrare në Shkup, gati në tërë teritorin e “viseve jugore” ishin arritur rezultate në lëmin e reformës agrare. Shënimet statistikore të Drejtorisë Supreme Agrare të Shkupit, vërtetojnë se deri më 31 dhjetor 1931 në Banovinën e Vardarit, Zetës dhe Moravë, kishin ndërtuar 10.969 shtëpi për kolonistë.<sup>186</sup>

Politika e pa drejtë kolonizuese pati pasoja negative si në situatën konkrete, ashtu edhe në perspektivën e gjatë të bashkëjetesës midis dy popujve. Pasoja direkte negative e kësaj politike është edhe, se në vitet e para pas luftës i bënë rezistencë pushtetit fshatra të tëra, kështu që ushtria u detyrua të përdorë edhe artilerinë. Antagonizmin midis vendësve dhe kolonëve e pezmatonin dhe e nxitnin vazhdimisht edhe vetë organet administrative, sidomos kur është fjala për Kosovën, si duke i vendosur familjet malazeze, të paktën përkohësisht, në shtëpitë e shqiptarëve, ashtu edhe duke u dhënë kolonëve, tokat e zaptuara, e pezmatonin dhe e nxitnin vazhdimisht edhe vetë organet administrative, sidomos kur është fjala për Kosovën, dhurata tokash ka ndarë edhe vetë Mbreti Stojadinoviq.<sup>187</sup>

---

<sup>185</sup> A VIII, P.17, K.2-29.1937.

<sup>186</sup> Arkivi Jugosllavisë: *Statistički pregled obavljenih radova do oktobra 1940. tehničog oteka Vrhovnog poverništva agrane reforme u Skoplju na dan 11.XI.1940.*

<sup>187</sup> Milotin Folliq, *Akcije Studenata Kosova za prava Allbanskog naroda u periodu 1937-1941*, 47.

Konfliktet e hapura ndaj shqiptarëve, krijonin përshtypjen e pasigurisë personale të kolonëve, antagonizmi i këtillë, në fillim, madje lindi konfliktet e hapura, kështu që disa nga ardhacakët, kishin braktisur tokën dhe ishin kthyer në vendlindje. Politika agrare borgjeze, ka qenë aq më e padrejtë ndaj popullatës autoktone, pasi pikë synim kishte shkombëtarizimin.<sup>188</sup>

Shkurt, politika e këtillë agrare në Kosovë dhe Maqedoni kishte, kryesisht, dy qëllime themelore, shkombëtarizimin e popullsisë maqedonase e shqiptare dhe krijimin e hendekut në mes të saj e kolonistëve. Borgjezia serbomadhe shpresonte se në këtë mënyrë do t'i siguronte pozitat e saj ekonomike, shoqërore e politike. Derisa qëllimin e dytë, ia doli në krye të realizojë deri diku në Kosovë, të parin nuk që në gjendje ta sendërtojë, sepse shqiptarët ditën dhe patën forca për t'i rezistuar asimilimit.<sup>189</sup>

Qarqet shtypëse nga instancat më të larta sllave, kishin vënë në dukje se procesi i ngushtimit gradual të hapësirave shqiptare me anë të kolonizimit, nuk i jepte frytet e dëshiruara gjenocide, prandaj e ndryshojnë atë metodologji, duke e plotësuar me formën sukses plotë të shpërnguljes së shqiptarëve në masë. Mbretëria gjithnjë është “kujdesur” që ta përshpejtojë shpërnguljen. Pra, hulumtohet në aspekte të ndryshme: metoda, forma dhe plasmani me i suksesshëm i shpërnguljes, duke ju paraprirë atyre torturat, masakrat, çarmatimet, vrasjet, djegiet, dhunimet, rrahjet, maltretimet e çka jo tjetër. Për këto qëllime jetike, siç i quanin sllavët, Turqia ishte tregu më i gjerë, që do të mundë të pranonte të shpërngulurit shqiptarë. Ajo kishte hapësira të mëdha toke të pabanuara. Për këtë qëllim, mendonin qarqet sllave, duhet të vendosen kontaktet diplomatike me Turqinë, duke përdorur të gjitha mjetet për ta bindur Shqipërinë që të pranojë një pjesë të shpërngulurve. Madje, theksonin ata duhet t'i bëhet me dije qeverisë shqiptare se nuk do të ngurrojmë fare për zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje. Ky ishte madje një kërcim serioz që i bëhej Shqipërisë. Kontaktet sllavo-qeveritare me Turqinë, sinjalizonin se ajo ishte në gjendje t'i pranonte të shpërngulurit në sasi të mëdha, pra ishte e disponuar

---

<sup>188</sup> Milivoje Erić, *Agrarna reforma u Jugosllaviji 1918-1941*, 412.

<sup>189</sup> Arkivi Historik të Malit të Zi: D 8909/V-2a-10 (*Izvtaj dopisnika* CPB, br. 57 od 25. VII.1940).

që t'i pranonte. Qarqet serbe kërkuan huazim të kredisë për t'i paguar qeverisë turke këtë shërbim të ashtuquajtur shpërngulje në masë të shqiptarëve në tokat e saja.<sup>190</sup>

Ardhja e Stojadinoviçit në pushtet për popullin shqipar shënoi fillimin e një terrori tëri të paparë, përfshi këtu: vrasje të shumë fshatarëve të pafajshëm, duke montuar proçese të llojllojshme politike, me të vetmin qëllim që shqiptarët të shpërngulen sa më parë nga shtëpitë e veta. Ndërsa tokën e tyre ua shitën ose ua ndanë njerëzve të vetë që ishin më të dëgjueshëm.<sup>191</sup>

Për të ndaluar këtë gjendje shkatërruese për popullin shqiptar, Ferat Draga së bashku me bashkëpunëtorët dhe një grup veprimtarësh, i dërguan kryeministrit dhe ministri të punëve të jashtme të Mbretërisë SKS, Millan Stojadinoviç, në nëntor 1936, një letër ku thuhej: “Me gjithë se nuk e kemi merituar, reforma është zbatuar në këtë vend në atë mënyrë që ne në këtë vend kemi mbetur formalisht qytetar dhe shtetas pa të drejta, sepse në bazë të ligjit dhe pa ligj kemi humbur të gjitha të drejtat e pasurisë sonë tokësore”. Përveç elaborimit të gjendjes faktike në letër janë parashtruar edhe kërkesat e shqiptarëve, të cilat janë parashtruar në pika të përcaktuara qartë. Në fund, letra mbaron më kërkesën që shuma prej 100 milion dinarë e caktuar për marrjen e tokave të qifqinjëve (e parapar 300 dinar për hektar), të rritet në 400 milion dinar dhe të filloi të paguhet që nga 1 prilli 1937, deri në 31 dhjetor 1937.<sup>192</sup>

Në fund të muajit korrik, një delegacion prej 80 përfaqësuesve të komunave shqiptare u nis për në Beograd, që të informoi institucionet e shtetit për dhunën, terrorin dhe padrejtësitë e tjera që bëheshin ndaj shqiptarëve në viset e jugut posaqërisht në Shkup me rrethinë. Delegacioni potencoi faktin se: Mënyra e zbatimit të reformës agrare për 20 vite të tera nuk ka qenë gjë tjetër veçse veprimi i paligjshëm dhe sidomos mënyra e veprimit që përdoret tani e provon fare mirë sjelljen e paligjshme. Interesi privat dhe jo njerëzimi u manifestuan në të gjitha format kundrejt neve shqiptarëve. Të ishte puna në bazë të ligjit nuk do të humbnin besimin tek drejtësia por u veprua në bazë të dekret-ligjeve dhe urdhërave për të shkatërruar bujqësinë shqiptare, duke përdorur tërë mjetet ligjore kundërnesh. Shqiptarët me anë të një pjesë të administratës, brenda disa ditëve

<sup>190</sup> *Izvori velike srpske agresije*, 115- 117.

<sup>191</sup> Спасоје Ѓаковић, *Сукоби на Косову*, Београд, 1984, 27.

<sup>192</sup> A.M. Shkup, „M.P.J. Letër dërguar Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme në Beograd, nga një grup veprimtarësh të udhëhequr nga Nexhip Draga (14 nëntor 1936), Shkup.

humbën pasurinë e vogël bujqësore dhe bashkëme familjet e tyre mbetën pa kurrfar mjetesh.<sup>193</sup>

Pengesat ndaj politikës së shkombëtarizimit të trevave shqiptare, ndikuan në rritjen e qëndresës së popullsisë autoktone, e cila i shqetësoi qarqet drejtuese serbe. Në disa raporte sekrete të vitit 1938, të përgatitura nga vëzhguesit zyrtar të Beogradit “ngritja ideore dhe politike e shqiptarëve”, prej nga buronte edhe “rezistenca ndaj shpërnguljes dhe kolonizimit”, u vlerësua si rrezik shumë i madh, në rast se shpërthente në të ardhmen një konflikt ndërkombëtar”. Në njërin prej këtyre raporteve, pohohej tek shumica e shqiptarëve, ishte ngritur vetëdija kombëtare dhe ndihet dëshira për tu bashkangjitur në shtetin amë Shqipëri marrja e tokës prej shqiptarëve, pohohej më tej në raport, ka ngacmuar pasionin e udhëheqësve të tyre, sidomos të arsimuarit, që t’i bashkohen Shqipërisë qoftë edhe me fuqi...”. Në periudhën (1921-1931) nataliteti i shqiptarëve ishte 88.060 banor ndërsa ai i serbeve 58.745 banor në 1.km<sup>2</sup> dallimi ishte 9.315 banor për 1.km<sup>2</sup>, në favor të shqiptarëve. Duke, pasur parasysh vazhdimësinë, nataliteti i madh i shqiptarëve, kushtet prore të rënda për kolonizim, me metoda klasike, ky dallim me kalimin e kohës bëhet gjithnjë më i madh, më në fund solli në pyetje, atë sukses të paktë të kolonizimit që ishte arritur prej vitit 1919, e deri me fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Nëse nisemi nga këndvështrimi, se shpërngulja permanente e shqiptarëve, me kolonizimin tonë në kontinuitet, ishte jo efikas, mbetet vetëm shpërngulja masovike.<sup>194</sup>

Konstatime të tilla kishte Vasa Çubriloviç, i cili pohonte se ”Kolonizimi”, nuk ka mundur të pengoj natalitetin natyral më të madh të shqiptarët se sa të serbët”. Duke paraqitur shkaqet e mos suksesit, ai konsideronte se me anë të kolonizimit, nuk mund të sigurohet pjesa dërmuese serbe, në viset ku jetonin shqiptarët, por me shpërnguljen me masë të shqiptarëve prej Jugosllavisë. Sipas tij, rezultatet e kolonizimit ishin shumë të vogla, sepse qeveritë nuk kanë pasur plane të përcaktuara, pasi deputetët u kanë bërë lajka shqiptarëve, për tua dhënë votat, prandaj shqiptarëve nuk u është marrë toka pjellore, në bazë të tapive të pa ligjshme, të hedhura poshtë, të cilat i kishin shumica prej tyre. Çubriloviçi nxori konkluzën: “*Tëri kapitullojnë, shqiptarët është e pa mundur, të*

<sup>193</sup> Fletorja “Politika”, Nr. 10835, Beograd, 20 Korrik, 1938 .

<sup>194</sup> *Izvori velike srpske agresije*, 111-112.

*asgjësohen vetëm me kolonizim... duke u nisur nga pikëpamja, se zbrazja graduale e shqiptarëve, me kolonizimin tonë shkallë-shkallë, ishte jo efikase”.*<sup>195</sup>

Gjatë viteve 1936-1938, hovshëm, dhe me shumicë, filloi procesi i shpërnguljes së shqiptarëve duke i realizuar të gjitha projektet që dirigjoheshin nga Beogradi, po këtë gjendje të vështirë, e përjetoi më së shumti Kosova, me seli në Shkup. Këtë gjendje të vështiër, e përjetoi rrethina e tij, sipas të gjitha të dhënave, burimeve historike që nga koha e Mbretit Aleksandër, në kohën e Qeverisë së Millan Stojadinoviçit e Cvetkoviç-Maçekut, gjendja më e vështirë e shqiptarëve, u bë në këtë periudhë, si në pikëpamje ekonomike, politike e sociale. Këto regjime, mbi popullatën shqiptare të Shkupit me rrethinë, mbi të cilën bëhej: dhunë terror, vrasje, gjenocid, asimilim dhe shkombëtarizim. Platforma më e rëndë për zhdukjen e shqiptarëve ishte e akademikut Vaso Çubrilloviç.<sup>196</sup>

### **III.3. Konventa jugosllavo-turke 1938 dhe dispozitat themelore të saj**

Me formimin e Qeverisë së Millan Stojadinoviçit, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë, filluan konsultimet intensive, lidhur me shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Pranë ministrisë së Punëve të Jashtme, ilegalisht u formua Komiteti i ngushtë, i cili më korrik 1935, duhej të përgatiste një maket-projekt për shpërnguljen e shqiptarëve. Më 24 shtator 1935, Komiteti i ngushtë, analizoi projektin, në harmonizim me Ligjin mbi shtetësinë neni 55, të njejtin ia dërgoi Forumit të themeluar nga Këshilli i ministrave. Kjo Konferencë ndërministrore u realizua, apostafat për shpërnguljen e popullatës me prejardhje jo sllave, nga e ashtuquajtura Serbi Jugore, më 1 tetor 1935, në Beograd, nën kryesinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ilija Milikiçit.

Në këtë gjendje të kaotike, kur shqiptarët protestonin me të madhe kundër politikës kolonizuese jugosllave, në Ankara u mbajtë një Mbledhje ndërministrore e

<sup>195</sup>Hajredin Hoxha, *Elemente të presionit ekonomik ndaj shqiptarëve në Jugosllavinë e vjetër*, 323; Vaso Çubrilloviç, *Shpërngula e Arnautëve (shqiptarëve)*.

<sup>196</sup> ASHSh, *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Tiranë, 1990, 318-331.

Këshillit të vendeve Ballkanike, e ashtuquajtur “Për marrëveshje”, më 25-27 shkurt 1938. Në këtë takim përveç tjerave, ministri i Punëve të Jashtme të Turqisë doli me propozim për shpërnguljen e myslimanëve të vendeve ballanike në Turqi.

Këtë propozim, Qeveria jugosllave e priti me pa durim, duke marrë masa përgatitore, që ky problem për shpërngulje të myslimanëve, të filloj sa më parë, ku prapa kësaj fshihej shpërngulja e shqiptarëve, qarqet jugosllave, ishin të interesuara së pari për shpërnguljen e shqiptarëve nga Kosova, Maqedonia dhe Sanxhaku.<sup>197</sup>

Menjëherë, pas vendimit të Këshillit Ballkanik të 25-27 shkurtit 1938, u realizua mbledhja në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, me pesë konferenca brendaministore, me qëllim të përgatisin materialin, për të hyrë në bisedime me Qeverinë turke, dhe në bazë të tyre, përgatitën Konventën dhe parimet e Rregullores së përgjithshme për shpërngulje. Për shpërnguljen e shqiptarëve, Komanda e III-të, doli me propozim se: *”Së pari të shpërngulen shqiptarët e banuar nëpër vendet kufitare, e mandej ato në brendi, e së fundmi të shpërngulen turqit”*. Klika Jugosllave në krye me Stojadinoviçin shprehte idenë... *“Është e pa mundur shtypja e shqiptarëve me kolonizim gradual, ai është i vetmi popull i cili ka mundur gjatë një mijë vjetëve të fundit, jo vetëm të mbahej... por edhe të rritet në dëm tonin, duke shtijë kufijtë tonë kah veriu dhe lindja”*. Në vitet e 30-ta synimet e Beogradit për të arritur shkombëtarizimin e trevave shqiptare nuk ishte realizuar.<sup>198</sup>

Kur nisemi nga fakti se shtypja graduale e shqiptarëve me kolonizimin tonë gradual, ka qenë jo efikas, e vetmja rrugë ishte shpërngulja në masë”.<sup>199</sup>

Në këtë gjendje të kaotike, shqiptarët protestonin me të madhe kundër politikës kolonizuese jugosllave, në Ankara u mbajtë një Mbledhje ndërministrore e Këshillit të vendeve Ballkanike, e ashtuquajtur “Për marrëveshje”, më 25-27 shkurt 1938. Në këtë takim përveç tjerave, ministri i Punëve të Jashtme të Turqisë doli me propozim për shpërngulitjen e myslimanëve të vendeve Ballanike për në Turqi, i cili propozoi themelimin e një Komisioni, me përfaqësim me nga dy përfaqësues nga çdo vend.<sup>200</sup>

<sup>197</sup> Milovan Obradoviç, *Agrarna Reforma i kolonizacija na Kosovu* (1918-1941), 189.

<sup>198</sup> *E vërteta mbi Kosovën dhe Shqiptarët në Jugosllavi*, 268.

<sup>199</sup> Vasa Çubrilloviç, *Shpërngulja e Arnautëve (Shqiptarëve)*, 7 mars 1937.

<sup>200</sup> Milovan Obradoviç, *Agrarna Reforma i kolonizacija na Kosovu* (1918-1941), 189; Hakif Bajrami, *Konventa jugosllavo-turke e vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve*, 258-265.



Konventa u nënshkrua në Stamboll, ku parashikohej shpërngulja e disa qindra mijë “myslimanëve” nga Mbretëria e Jugosllavisë në Turqi.

Siç, theksohej në një informacion tepër sekret të përfaqësisë jugosllave në Ankara, nga Ministria e Jashtme e Beogradit, qëllimi i vërtetë sekret i saj ishte shpërngulja e popullsisë shqiptare nga Kosova dhe nga Maqedonia.<sup>201</sup>

Numri i turqve në Mbretërinë e Jugosllavisë nuk kalonte 60.000-80.000 banorë. Regjistrimi zyrtar jugosllav i vitit 1931 ky numër u rrit më 132.000 banorë. Për këtë shpërngulje në masë të popullsisë në Turqi, borgjezisë serbomadhe i dhanë shkas marrëveshjet që ishin kontaktuar më parë me Bullgarinë, Greqinë, Rumaninë.

Menjëherë, pas vendimit të Këshillit Ballkanik të 25-27 shkurtit 1938, u realizua mbledhja në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, me pesë konferenca brendaministore, me qëllim të përgatisin materialin, për të hyrë në bisedime me Qeverinë turke, dhe në bazë të tyre, përgatitën Konventën dhe parimet e Rregullores së përgjithshme për shpërngulje. Në këto seanca, ishte vendosur, së pari të shpërngulet fshatarësia, që të vihej deri te pasuria tokësore për kolonizimin e saj.

Numri i shqiptarëve, se sa do shpërngulen për në Turqi dhe sa ka mundësi të pranoj shteti turk. Ndërsa qeveria serbe, pranoi t'i paguajë një sasi të hollash si dëmshpërblim maksimal prej 15.000 dinarësh për një familje të shpërngulur, përkatësisht 22.500 dinarë për anëtarë Komisioni për shpërngulje i Jugosllavisë së Vjetër përbëhej nga delegatët: M.Ristiq, shef i Seksionit Ballkanik pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe V.Magovçeviq inspektor i Ministrisë së Bujqësisë të cilët biseduan me përfaqësuesit turq, udhëheqës i bisedimeve nga pala turke ishte Hasan Saka.

Sipas konventës theksohej se duhet të shpërngulen 40.000 familje myslimane, nga vendet që i kishte pushtuar ushtria serbe në periudhën (1912-13), e cila posedonte gjithsej 200.000 banor në bazë të listave që i kishte përpiluar Komisioni Jugosllav.<sup>202</sup>

Në bazë të kësaj konvente shpërngulja do zgjaste 6 vjet, nga 1 korrikut 1939 deri në fund të vitit 1944<sup>203</sup>, edhe atë në vitin 1939, 4000 familje, në vitin 1940, 6000 familje, në vitin 1941/1942, 14.000 familje dhe në vitin 1943/1944, 16.000 familje.<sup>204</sup>

---

<sup>201</sup> Milotin Folliq, *Akcije Studenata Kosova za prava Albanskog naroda u periodu 1937-1941*, 43.

<sup>202</sup> Milovan Obradoviç, *Agrarna Reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*, 189

<sup>203</sup> Vuk Vinaver, *Çështja shqiptare në shtypin e PKJ 1919-1939*, në: “*Gjurmime albanologjike*”, Prishtinë, 1972, 93; Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore politike në Kosovë: 1918-1941*, Prishtinë, 1981, 160.

Për shpërnguljen e shqiptarëve, Komanda e III-të, doli me propozim se: ”Së pari të shpërngulen shqiptarët e banuar nëpër vendet kufitare, e mandej ato në brendi, e së fundmi të shpërngulen turqit”.<sup>205</sup>

Në Gazetën shqiptare “Vullneti i Popullit” citohej: ”Jugosllavia po i shtrëngon shqiptarët e Tetovës e të Gostivarit, të venë fesin e kuq të Turqisë”.<sup>206</sup>

Homologët hegjemonist anti shqiptarë Çubriloviqi dhe Gjoka Penina, në fund të vitit 1936, theksonin se për të krijuar shumicë sllave regjionin e zaptuar, me pretekst se duhet patjetër të shpërngulen rreth 300.000 shqiptarë, kështu vendasit të zvoglohen për 21,5% që të sigurohet shumicë në favor të sllavëve në rritje për 71%.<sup>207</sup>

Si rrjedhojë e një sspërnguljeje të kurdisur nga aparati i shtetit, në fund të vitit 1939, në pjesë të Maqedonisë, janë shpërngulur në Turqi, më se 100.000 banorë shqiptarë, dhe ca të tjerë, të deklaruar mysliman dhe turq, kurse në realitet për kah nacionaliteti të gjithë ishin shqiptarë, të cilët vazhdimisht gjendeshin në kurbet.<sup>208</sup>

Në çfarë gjendje të vështirë ekonomike dhe politike ishte popullsia në ”Serbinë e Jugut” deri në sundimin serb, tregon fakti se Mbretëria Jugosllave nga situata e rëndë politike, që kishte krijuar për qëllimet e saja asimiluese dhe për të mbajtur rend dhe qetësi mbi ta, ajo funksiononte me 35.000 ushtarë, 12.000 policë, prej 17.000 sa kishte gjithsej pushteti aktual, mbi 70% të xhandarëve ishin të angazhuar vetëm në Maqedoni.<sup>209</sup>

Situatën politike në Jugosllavinë e Vjetër, me theks të veçantë në Banovinën e Vardarit, për të cilën në gazetën “Borba”, dëshmohej se gjatë muajit shtator 1928, vetëm në Shkup e Manastir, u dënuan 40 persona, me gjithsejtë 350 vite burgim të rëndë.<sup>210</sup>

Ndërsa gazeta kroate ”Politički Vjesnik” e Zagrebit, në vitin 1938, botoi proklamaten e Organizatës myslimane të studentëve të Maqedonisë dhe të Kosovës, se protestohej kundër dhunës së organeve të pushtetit, që vepronte kundër shqiptarëve dhe kundër Marrëveshjes së fshehtë në mes të qeverive jugosllave dhe asaj turke, sipas secilës

---

<sup>204</sup> Hivzi Islami, *Kosova dhe shqiptarët çështja demografike*, Prishtinë, 1990, 244.

<sup>205</sup> Masar Kodra, *Shqiptarët e Maqedonisë gjatë Luftës së Dytë Botërore 1939-1944*, Kumanovë, 1996, 94.

<sup>206</sup> “Vullneti i popullit”, nr. 128. më 12 shtator 1930, 1.

<sup>207</sup> Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore politike në Kosovë: 1918-1941*, 165.

<sup>208</sup> Masar Kodra, *Shqiptarët e Maqedonisë gjatë Luftës së Dytë Botërore 1939-1944*, Kumanovë, 1996, 116.

<sup>209</sup> Instituti i Historisë Nacionale, *Historia e popullit maqedonas*, Shkup, 1983, 241.

<sup>210</sup> *Tabela o političkim progonima o Jugosllaviji za mjesec septembar 1928*, në: “Borba”, nr. 69, Zagreb, 20.10.1928.

në shkretëtirat e Anadollit, duhej të shpërnguleshin rreth 1.000.000 mysliman. Xhandarmëria serbe filloi aksione në shumë fshatra shqiptare, duke kërkuar si shumë herë përpara, ”*armët e fshehura*”, rasti, u shfrytëzua për rrahje, nënçmime dhe burgosje masive të shqiptarëve.<sup>211</sup>

Njërën ndër format më të përshtatshme, që hegjemonistët serb e gjetën, ishte përvetësimi i klerit shqiptar dhe përmes personaliteteve njerëzve me ndikim. Sipas tyre, kjo duhej të bëhej ose me korrupsionin e tyre me para, ose duke i përdorur mekanizmat e presionit, kërcënimit, frikësimit e kështu me radhë. Për formimin e vetëdijes, për shpërngulje duhet të kërkohen agjitorë, të cilët, dinë dhe kanë aftësi në propagandimin e shpërnguljes përmes përshkrimit të pasurive, të bukurive, të sipërfaqeve dhe të vendeve të mrekullueshme në Turqi, që rrallë kund mund të gjenden diku tjetër në botë.<sup>212</sup>

Duke propaganduar, kinse atje është jeta jetë, me bollëk e kënaqësi njeriu mund të bëjë jetë të lehtë e të rehatshme, në begati materiale, ashtu edhe në atë shpirtërore e fetare, sepse Turqia është shtet i myslimanëve, dhe për konfesionet jo myslimane katolike e ortodokse. Qarqet sllave, para mendonin se propagandimi në këtë frymë, do të shtonte apetitin e masës shqiptare, për shpërngulje dhe pre dispozicione serioze, për t`u liruar nga faktori shqiptar. Sa i përket mënyrës së presioneve, me anë të projekteve, për shfarosjen e shqiptarëve, atë mund ta bënte sistemi jugosllav-shtetëror, duke i zbatuar lligjet, deri në nivel, që shqiptarëve t`ua bëjë të pa mundur jetesën në këto treva, pa shtegdalje.

Presioni, parashihej të bëhej, vërtetë edhe bëhej, me forma të kombinuara përmes tatimeve të rënda, lloj-lloj dënimesh të pa arsyeshme, presione të lloj-llojshme të çarmatimit, me burgime të çdo lloji, gjoba të pa fundme, përmes rrahjeve të rënda fizike dhe fyese, përmes vrasjeve të inskenuara dhe të rëndomta, përmes, maltretimeve, dhunimeve, inskenimeve, kalljes të shtëpive, ahureve, sanës, të gardheve, me prerje kafshësh, marrje të pasurisë, mos lejimit që të bënin ahengje dasma, festa, kremte, mos lejimit të përdorimit të gjuhës shqipe në vende publike, mos shkollim, përmes prishjeve të xhamive, kishave dhe pengim të veprimtarisë së tyre. Të gjitha këto pengesa, i

---

<sup>211</sup> “*Politički Vjesnik*”, Zageb, novembar, 1938.

<sup>212</sup> *Izvori velike srpske agresije*, 113.

zbatonin dhe i sendërtonin, përmes jetësimit të dispozitave policore, xhandarmërike, ushtrake, të cilëve u ishte lejuar të vritnin pa asnjë arsye.<sup>213</sup>

Në mjetet e ngulfatjeve, hynin mënyrat, procedurat që shqiptarët të detyrohen të punojnë angari, pa pagesa duke pranuar masat më të ashpra, që mundë të ndërmarrë policia e xhandarmëria të vriten patriotët, njerëzit me zë e autoritet, t'u bëhen keq përdorime të rënda, t'u konfiskohet pasuria dhe buka dhe një mori masash tjera.

Në radhën e trysnive ekonomike, zbatonin dhe para shikonin trysni më të rënda si: mosnjohje të tapive të vjetra të Kadastrës, kudo në viset shqiptare, vënia e taksave të pa mëshirshme dhe të rënda siç ishin si më parë, detyrim të pagesës së të gjitha borxheve private e publike, marrje të kullotave shtetërore dhe komunale, zhveshje nga koncesionet, heqje të lejeve afariste për monopole, pushim nga puna shtetërore, me arsye e pa arsye, ose kur s'ka arsye duhej të trillohet arsyeja, privimi nga vetë administrimi, dhe nuk përfundonte kurrë mozaiku i trysnive.

Natyrisht, se këto masa tepër të ashpra. do lëkundnin qenien shqiptare, do ta nxisnin shpërnguljen masive, dhe se me këto akte represive, sllavët do të ndjenin veten përherë zotërues më të sigurt të tokave shqiptare, jo vetëm që mendonin, po edhe projektonin, madje edhe zbatonin me përpikëri, edhe pse efekti, u dilte disproporcional, por, sidoqoftë, shpërngulja vazhdonte. Të gjitha këto aktivitete të qëllimta tendencioze përfundonin kobshëm mbi qenien shqiptare ku më të ndjeshëm ishin shqiptarët, kur pushteti i ngacmonte në ndjenjat fetare.<sup>214</sup>

Në aspektë masash tjera, serbët zbatonin e projektonin masa tepër rigoroze me shtrëngesa sanitare, zbatimin me dhunë të të gjitha dispozitave "ligjore" nëpër shtëpi: prishja e mureve dhe gardheve rreth shtëpive, zbatimi i masave rigoroze veterinarë, për të penguar nxjerrjen e bagëtive në treg, detyrimin i bartjes së plehrave nga rruga ose si dëshironin të tjerët, defakto ishte fjala për maltretim. Shkurtë, kërkonin edhe zbatonin masa praktike në shkallë të lartë efikasiteti që kishin emërues të përbashkët shtypjen, trysninë, maltretim, vështirësimin, kushtin, që të mbijetonin në trojet e shqiptarëve. Vallë, mund të jetë ndryshe ky presion masiv, ndryshe s'ka si të definohej veprimet e

---

<sup>213</sup> Milovan Obradović, *Agrarana reforma i kolonizacija na Kosovo*, 201.

<sup>214</sup> *Izvori velike srpske agresije*, 113.

pushtetit serb ndaj shqiptarëve, më së miri e definojnë dhunën me përpjestime kaq të gjëra, që kishte ndërmarrë klika sunduese jugosllave.

Për të shpërngulur, sa më shumë shqiptarë, qarqet jugosllave zbatonin e planifikonin trillime të tjera si çarmatimin: kërkonin armë nga shqiptarët, pavarësisht se vallë i kishin apo jo, duke zbatuar format drastike rrahje pse e kishte armën, rrahje pse nuk e kishte atë, se praktikë e tillë sot e kësaj dite nuk po pushon. Në anën tjetër tek koloniët shpërndaheshin armët nga vetë organet e pushtetit.

Në vargun e presioneve të zbatuara të atyre, do të zbatoheshin, parashihnin edhe organizimin e aksioneve të vjetra çetnike, duke u ndihmuar fshehurazi e haptazi organeve e pushtetit dhe projektuesit intelektualë në kryerjen e detyrave “një nacionale”.

Sipas këtyre projekteve malazetët, kreshnikët, banditët, çetnikët e përbetuar, xhandarët plotë pezëm, nxitnin dhe krijonin një psikozë të vërtetë, sikur shqiptarët kanë ngritur kokë. Këtë kryengritje, të prezantuar në mënyrë të rrejshme, qarqet sllave e paraqitnin me keqardhje, si konflikt vëllezërisht e fisesh, dhe e shfrytëzonin për ndërmarrje ushtarake dhe për shfarosje në masë. Inskenimi sllav si praktikë ditore ndaj shqiptarëve, verifikoi pa besinë e tyre, mashtrimi i tyre nuk kishte skaj, sepse për të arritur qëllimin ata nuk zgjedhin mjete e forma shumë ngatërresa vetë i inskenonin si çdo herë dhe më herët, kush ishte fajtor dihet se shqiptari, dhe fundja mashtrimi, gënjeshtria, tradhtia, arrijtën shkallën e artit të sllavët.

Një mënyrë tjetër e shtypjes ishte dhe mbeti, në relacionin e montimit të shpërnguljes, shfarosjes së shqiptarëve në përgjithësi përfiditeti i nxitjes së krijimit të psikozës vëlla-vrasës, fenomen ky që pushteti sllav e shfrytëzoi me mjeshtëri të rrallë, duke krijuar situata të trilluara, me qëllim që shqiptarët të vriten në mes vete.

Në këtë mënyrë, ata kishin mjaftë sukses. Kështu, shumë familje për shkak të vëllavrasjeve u detyruan të largohen, të marrin rrugën pa kthim falë inskenimeve sllave. Pushteti jugosllav, me mjeshtëri të rrallë, e nxiste vëllavrasjet bile i financonte. Ata nxisnin me mjeshtëri, turbullira të mëdha, në mënyrë që pastaj, me masa tejet drastike, të trillonin forma të përgjakshme dhe me mjete shfarosëse. Këto metoda pre-përgatitore për shpërnguljen e shqiptarëve ishte dhe mbeti tejet e pasur në elaboratet e intelektualëve serb. Në rrethanat e krijuara në Ballkan, Qeveria jugosllave, arriti me propagandën e saj,

të bashkojë shtetet e Ballkanit duke lëshuar vazhdimisht thirrje e apele popullit sllav “Bashkohuni, duke kërkuar shtimin e procesit për shpërnguljen me dhunë të shqiptareve”. Shqiptaret vërtetë u gjenden në një situatë tejet konfuze në rrëmujë, në një anë nga dhuna, shtypja, masakra, vrasja, plaçkitja, rrahjat, në anën tjetër ardhja e kolonëve serb në tokat e shtëpitë e tyre dhe masa që përgatitej përshpërngulja jonë në drejtim të Azisë, e bënte situatën të tmerrshme se sa dukej më parë. Ishte krijuar një pasiguri e madhe.

Pushteti sllav ishte rrekur me tëra forcat drejtë shpërnguljes së shqiptareve për Jugosllavinë nuk kishte problem më prioritar kurdisja e pushtetit të tyre, se sa shpërngulja e Shqiptarëve nga trojet e tyre etnike. Pra, nuk kishte mekanizëm shtetëror, i cili nuk ishte vënë në disponim për çështjen e shpërnguljes së shqiptareve. Sllavët kishin të drejtë absolute, konstatimet e jashtme dhe të brendshme, se rrethanat shtypëse, diskriminimi politik e social, ekonomik, dhuna sistematike, masakrimet në çdo aspekt ndikuan që shqiptarët të shpërngulen prej tokave të tyre. Meqë, nuk posedojmë të dhëna statistikore më precize deri më vitin 1930, për në Turqi janë shpërngulur 120.000 banorë shqiptarë 150.000 banorë po shqiptarë, të 300 familje e më tepër, të shpërngulur në Shqipëri. Këto janë vetëm disa të dhëna tmerruese, për plaçkitjen e pasurisë me dhunë dhe forcë.<sup>215</sup>

Kjo ishte një periudhë tejet e rëndë, për fatin e një pjese të kombit shqiptar, që ishin nën sundimin e Mbretërisë jugosllave. Periudha (1918-1935), ishte periudhë e dhunës shtetërore me tepër iniciativa private, për shpërngulje që kishte ndjekur shumë shqiptarë për në shkretirat e Turqisë. Periudha nga viti 1935, karakterizohet me disa veçori të tjera specifike, ajo cilësohet si periudhë e shpërnguljes zyrtare shtetërore.

Pra shteti jugosllav, haptas ndërmori, shpërnguljen e shqiptarëve, si problem jetik për popullin serb. “Klubi Kulturor Serb”, botonte gazetën “Srpski Glasnik”, zhvilloj aktivitetin e tij tejet të dendur, rreth trajtimit të platformës anti shqiptare ku Qeveria Jugosllave, merrte pjesë me ministri lidhur me çështjen e shpërnguljes së shqiptareve. Në këtë aktivitet, ishin përqendruar e angazhuar maksimalisht Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Bujqësisë, Financave, e Ndërtimit, Ministria e Komunikacionit dhe Gjeneral Shtabi i Ushtrisë Jugosllave dhe Ministria e Reformës Agrare ajo e

---

<sup>215</sup>“Proleter”, nr. 11-15, shkurt 1930.

Shëndetësisë, Arsimit dhe Politikës Sociale. Qysh moti këto ministri vepronin me plotë kapacitet. Rezultatet e atëhershme për ta ishin të mira por jo edhe të suksesshme.

## Kapitulli IV

### VI. Organizimi i jetës arsimore, fetare dhe kulturore të shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë gjatë viteve 1918-1941

#### IV.1. Arsimi i shqiptarëve në Shkup mre rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore

Kur pushteti serb i përforcoi pozitat e veta, nuk mundi t'a fshehë politikën e tij okupuese, duke përdorë metoda më barbare, gjithë kjo me qëllim të gjoja se në këto toka ai nuk ishte robëruar, por një shtet që kujdesej për ta ngritur kulturën dhe arsimin. Politika arsimore e asaj kohe ishte më tepër preokupim i pushtetit ushtarako-policor sesa politikë shtetërore-arsimore, sepse siç shprehet një kryeshef i një rrethi, i quajtur dr. Karaxhiq, “Njëherë e përgjithmonë duhet të kuptoni se derisa të jenë analfabetë, deri atëherë do të sundojmë mbi këta, sepse kur të arsimohen, aty përfundon sundimi jonë.”. Pavarësisht nga ajo se çfarë politike arsimore ushtrohej në këto vende të robëruara, ku pjesa dërmuese ishte me përkatësi shqiptare, qëllimi ishte që shqiptarët të asimilohen dhe të shkombëtarizohen dhe në fund sa më parë të largohen nga vatrat e tyre stërgjyshore.<sup>216</sup>

Pas vitit 1919, kur në Beograd formohet Ministria e Arsimit në krye me Pribiçeviqin, fillon të behet edhe unifikimi i shkollave fillore, ndërsa aty fillon edhe përgatitja e plan-programeve dhe miratimi i Ligjit mbi shkollat fillore, i cili aprovohet në gusht të vitit 1926. Me miratimin e Ligjit të vitit 1929, pushteti serb kërkonte që sistemi edukativo-arsimor të vihet në shërbim të unitarizmit jugosllav, me çka synohej të rritet “atdheu i përbashkët” dhe rregullimi shtetëror si dhe besimi në Karagjorgjeviqët. Ligji i parë i Mbretërisë SKS për shkollat e ashtuquajtura “popullore” u soll më 5. XII 1929, ndërsa më pastaj u korrigjua më 7.VII.1930 dhe u miratua në kohën e diktaturës së mbretit Aleksandër. U morën vendime që të hapen shkollaserbe në vendet e pushtuara, ku rinia

---

<sup>216</sup> Avzi Mustafa, *Edukimi dhe arsimi i shqiptarëve në Shkup me rrethinë në mes dy luftërave botërore*, në: SCUPI, nr. 12, Shkup, 2015, 42-43.



do të arsimohet në frymën epushtetit, edhe pse në disa gazeta të Beogradit njoftonin se do të debatohet për ligjin shkollor. Po në këtë kohë pushteti serb eformoi edhe një komision të posaçëm, që ta shohë gjendjen eshkolave në këto troje. Mbi gjendjen dhe situatën e tillë u informuan nga njerëz të ndryshëm, ndërsa në disa vende bënë edhe vizita të drejtpërdrejta.<sup>217</sup>

Në dokumentet dhe në shtypin e kohës është pasqyruar në mënyrë të gjërë e të qartë politika antishqiptare e serbëveose sllavëve të jugut në fushën e arsimit, qëndrimet e tyre kundër mësimin e shkollës shqipe. Ministria e Arsimit, në Mbretërinë: Serbe-Kroate-Slllovene, filloi të hapte shkolla në gjuhën serbokroate, sidomos në qytetin e Shkupit dhe rrethin e saj u hapën këto shkolla: sholla fillore, shkollat e ulta profesionale, gjimnaze, shkolla fetare, shkolla e larta.

Pasi e analizuan situatën, ata filluan të sjellinmësues në trojet shqiptare. Ardhja e këtyre mësuesve nuk u pritmirë nga popullata. Këtu kishin rol imamët, si njerëz që e mbaningjallë jetën fetare dhe njerëz që e udhëhiqnin popullin dhe të cilëvepopulli u besonte. Qëllimi kryesorë i ligjeve shkollore ishte që sa më afër ta arsimojnëdhe edukojnë rininë në vendet e pushtuara në frymën e pushtetit. Mësimi në këto shkolla ishte i obliguar dhe i përgjithshëm. Shkolla fillore ishte katërklasëshe, ndërsa funksiononin edhe shkollat e lartapopullore, të cilat zgjatnin katër vjet, por këto fillonin prej klasës Vderi në klasën VIII. Më vonë filluan të hapen edhe shkollat e tipit tëshkollave qytetare, shkolla zejtare, gjimnazet e ulëta dhe të larta, poredhe Fakulteti Filozofik në Shkup, që kishte për qëllim ta promovojë politikën shtetërore.<sup>218</sup>

Menjëherë pas riokupimit të trevave etnike shqiptare, në vitin 1919 Ministrisë së Arsimit në qeverinë e Mbretërisë SKS-ë nga Xhemijeti (Bashkimi), në formë të rregullt iu shtrua kërkesa për hapjen e shkollave për fëmijët e konfesionit mysiman në gjuhën e tyre amëtare. Por, përkundër faktit se kërkesa kishte bazë juridike në nenin 16 të Kushtetutës së Vidovdanit si dhe në Ligjin mbi shkollat popullore, megjithë insistimin e deputetëve të kësaj partije në Parlamentin e Mbretërisë SKS-ë, shqiptarëve nuk iu lejua arsimimi në gjuhën amtare, jo vetëm në shkollat shtetërore, por as në ato private

---

<sup>217</sup> *Po aty*, 44

<sup>218</sup> Avzi Mustafa, *Edukimi dhe arsimiti i shqiptarëve në Shkup me rrethinë në mes dy luftërave botërore*, 44-45.

muslimane<sup>219</sup>, morën modelin e aplikuar nga Mbretëria e Serbisë në vitet 1913-1915, në të ashtuquajturën “Serbi e Jugut” dhe e shfrytëzuan gjatë viteve të para të krijimit të shtetit të ri. Në rrethe nga ana e Ministrisë së Arsimit ishte emëruar mbikqyrës së shkollave të rrethit, të cilët i përgjigjeshin në mënyrë të drejtë për drejtë inspektorit. Më vonë u emëruan edhe mbikqyrës së shkollave të qarqeve.

Shkollat ishin institucione publike ku mësimi zhvillohej në gjuhën zyrtare të Mbretërisë SKS. Kjo gjë më së miri shihet në kushtetutën e Vidovdanit 28 qershor 1921. Në nenin 3 të Kushtetutës përcaktohej si gjuha zyrtare është gjuha serbo-kroate-slllovene dhe se shqiptarëve u ndalohej shkollimi jashtë Mbretërisë.<sup>220</sup>

Sipas kushtetutës së Vidovdanit dhe Ligjit mbi shkollat popullore arsimit zhvillohej në bazë të njëjtë didaktike me disa ndryshime varësisht nga rrethi.

Të gjithë shkollat thuhet në ligj duhet të jenë:

- Pa taksë apo pagesë për regjistrim dhe shkollim;
- Duhet të përhapin unitetin në frymën popullore;
- Të japin edukatën morale dhe zhvillim të vetëdijes shtetërore;
- Të jenë nën mbikqyrjen e shtetit;
- Të hapen shkolla fillore për pakicat në gjuhën e tyre sipas ligjit, etj.;

Pikërisht pika e fundit “Hapja e shkollave fillore për pakicat kombëtare”, e cila ishte parashikuar në nenin 16, ngeli vetëm një akt në letër dhe kurrë nuk u zbatua, veçanërisht për shqiptarët. Të gjithë fëmijët shqiptar detyroheshin që mësimet fillore që zgjasnin 5 vjet, t’i mirrnin në gjuhën serbe viti i parë shërbente për mësimin e gjuhës serbe (që quhej cikli përgaditor) e pastaj vijonin me shkollimin fillor.<sup>221</sup>

Pas vitit 1919, numri i shkollave fillore në Serbinë Jugore filloi me rinovimin e shkollave të vjetra dhe ndërtimin e shkollave fillore të reja në vendet ku kishte më shumë kolonizatorë. Në vitin 1920/21, numri i shkollave fillore në gjithë Serbinë Jugore ishte 778, deri në vitet 1928/29 numri i shkollave fillore u rit në 1129 shkolla fillore.<sup>222</sup>

---

<sup>219</sup> Halim Purellku, *Vullneti për arsim më i fuqishëm se dhuna*, në *Flaka e Vëllazërimit*, d23.03.1996, 14

<sup>220</sup> Almarah Krlevine S.K.S. 1921-1922, 28-29.

<sup>221</sup> Marija Jovanović, *Prosfetno – politički prilik vo Vardarska Makedonija (1918-1929)*, Skopje, 1983, 195-196.

<sup>222</sup> Свет. К. Марковича и Јакова Ивановича, *Школство Јужне Србије од 1912-1937 г.*, 920.

Me 70.779 nxënës që do të thotë 33% . Mësuesit e parë “në vitet e çlirimit” ishin të ardhur nga Serbia.Hapja e këtyre shkollave serbe në viset me shumicë shqiptare të Shkupit dhe në fshatrat shqiptare kishte synime asimiluese.Sipas këtij dokumenti ajo përshkruan edhe hapjen e 40 çerdheve, 2 shkolla private dhe 6 shkolla për nxënës me tëmeta, dhe shkolla nate për ato njerëz që nuk dinë shkrim-lexim, në të gjithë Serbinë Jugore siç e quan ajo.<sup>223</sup>

Në Shkup u hapën edhe shkolla të mesme si: gjimnaze, shkolla zanatesh,shkolla qytetare,shkolla të larta për mësues,shkolla fetare, shkolla tregtare po ashtu edhe shkolla e mesme Medrese e vitit 1937, (e cila ishte mënyra e vetme e shqiptarëve që të arsimoheshin), në Shkup ishte edhe Fakulteti Filozofik .

Shkolla e mesme Medrese ishte shkolla e vetme e mesme për shqiptarët e Shkupit, edhe pse vazdimisht ishte nën mbikqyrjen e pushtetit ushtarak-politor jugosllav.U ndërtuan internate si Shtëpia e mbretit Aleksandrit I, dhe internati Kneginje Zorke në Shkup.Në Shkup u hapën biblioteka, muze, teatro dhe kinama, ndryshoj jeta kulturore pra filloj të ngrihet jeta kuturore e serbëve kolonizator dhe maqedonasve.Po ashtu në Shkup u formuan shoqëri muzikore, këngë të dalluara, aktivitete spotive, shoqëri humanitare por të gjitha përmenden si serbe e jo maqedone.U ndërtuan edhe kisha serbe në qytetine Shkupit.

Në vendbanimet shqiptare mungonin shkollat shqipe, dhe shumë fëmijë mbeteshin pa arsim ose disa ndiqnin arsimin në shkolla serbe. Në këto shkolla serbe u mohoj e drejta e tyre kombëtare dhe në programet e tyre mësimore kishin si qëllim që ti sërbizojnë fëmijët shqiptarë, dhe i quanin me emra si muhamedanë, arnaut etj. Shumë pak djem shkonin në shkollë dhe numri i tyre arrinte në 6% kurse vajzat qëshkonin në shkollë ishin 0.5%.Po ashtu duhet përmendur se në administratë serbe popullsinë shqiptare filluan t’i regjistrojnë me mbiemrat duke ju shtuar një prapashtesë: ski ose viq( pa dëshirën e tyre me forcë). Po t’i analizojmë del që mbiemrat të jenë të përfaqësues me mbiemrat serbë, ose disa fetarë të mëdhej të fesë islame i quante turq ose musliman e aspak nuk përmendet popull shqiptar.Në periudhën e themelimit të Mbretërisë Jugosllave (1929-1941), sistemi arsimor e ruante kontinuitetin e vet. Borgjezia serbe, vazhddonte politikën e vet asimiluese, gjatë asaj periudhe në Banovinën e Vardarit dhe më gjërë,

---

<sup>223</sup>Po aty.

përmes arsimit, ngajshëm edhe në sferën e shtypit, kohë kur Maqedonia e Vardarit përjetonte një burg të vërtetë, pasi shtypi progresiv ishte i ndaluar rreptësisht.<sup>224</sup>

Pushteti i borgjezisë serbë, në atë periudhë ishte më i fuqishëm në çdo aspekt material, kadrovik dhe politikë, prandaj sistemi arsimor ishte më i organizuar dhe stabil. Qëllimi i qarqeve sunduese, si që e pamë më lartë, kishte për qëllim, të kalitë rininë me frymën e atëhershme hegjemoniste serboborgjeze, që nga rinia të kalit qytetar lojal ndaj pushtetit të atëhershëm vazal të tyre. Prandaj Ministria e Arsimit kishte marrë masa të ashpra kundër mësuesve progresiv, të cilët vepronin në këto teritore duke kërkuar nga inspektorët e arsimit që të kontrolloheshin programet mësimore dhe të shihej me çka merren mësuesit.<sup>225</sup>

Për këtë qëllim në atë periudhë në viset e përziera në Banovinën e Vardarit, krahas shkollave fillore, vepronin dhe shoqëri të ndryshme me karakter kulturor ose sportiv, për këtë qëllim, një shoqëri e tillë u themelua e në shpatet e malit Sharr, në fshatin Urviç.<sup>226</sup>

Kjo flet qartë, se borgjezia serbe, kurrë nuk hoqi dorë nga politika shkombëtarizuese. Populli shqiptar, gjatë administrimit në Banovinën e Vardarit në Shkup me rrethinë, në periudhën (1929-1941), vazhdimisht ishte paraqitur problem, në pikëpamjet ekonomike, shoqërore, politike, kulturore, arsimore, por të cilën borgjezia serbe nuk dëshironte kurrë, që ta shqyrtojë si zgjidhje. Marrë në përgjithësi, numri i shkollave ku jetonte popullsia shqiptare kishte qenë mjaftë e kufizuar dhe mësohej vetëm në gjuhën serbe<sup>227</sup>.

Gjatë kësaj periudhe në Banovinën e Vardarit deri në vitin akademik 1938/1939, u hapën gjithsej 1.070 shkolla fillore por asnjë në gjuhën shqipe. Atëhere kishte vetëm një shkollë për mësues, 21 gjimnaze, 11 shkolla qytetare, të gjitha këto shkolla ishin vetëm në gjuhën serbe.<sup>228</sup>

Politika asimiluese, të cilën e zbatonin qeveritë në kohën e Diktaturës mbretërore ishte nën çdo nivel, krahas të drejtave ndërkombëtare. Sipas disa shënimeve statistikore

---

<sup>224</sup> Milan Vesović, *Revolucionarna štampa u kraljevini Srba, Hrvata i Slovenaca*, (Beograd), 275.

<sup>225</sup> Svetozar Naumovski, *Naprenoto učitelstvo vo Vardarskiot dell na Makedonija megjudvete Svetski vojni (1918-1941)*, Shkup, 1992, 96-97.

<sup>226</sup> Gazeta "Gllas Pologa", 8. IX. 1933.

<sup>227</sup> *Historia e popullit maqedonas*, 225.

<sup>228</sup> Branko Petrović, Momčillo Zeqeviç, *Jugoslovenski federalizam ideje i stvarnost (1914-1943)*, Beograd, 1987, 620-623.

për vitin shkollor 1930-1931, në shkollat fillore në popullatë prej 100 banor ishin përfshirë vetëm 10 nxënës.<sup>229</sup>

Borgjezia sunduese nuk hoqi dorë nga politika e shkombëtarizimit, ajo solli ashpërsime të reja në lëmin e arsimit. Në vitin 1930, u larguan nga Banovina e Vardarit për në Serbi 64 mësues, për mos suksesin në rrethin e tyre, se flisnin në dialektin lokal, pse u mishëruan me fshatarët vendas josllav. Kështu të folurit në gjuhën e amtare, u bë krim që ndiqej administrativisht dhe afrimi me fshatarët, ishte rrezik për sistemin politik jugosllav.<sup>230</sup>

Prandaj në këtë kohë, Ministria për Punë të Brendshme, kërkoi nga Ministria e Arsimit në Beograd, për sjelljen e numrit të mjaftueshëm të mësuesve "serb të sprovuar prej trevave të kufijve të paraluftës, këta mësues kishin për detyrë, përveç punës të mësuesit, të kryenin edhe mision të veçantë në vendet jugore, kurse për këtë veprim populli vendas nuk ishte i besueshëm". Në vendet kufitare, kishte mungesë të madhe të mësuesve. Në Banovinën e Vardarit, me teritore të pastra shqiptare, kishte katunde pa asnjë mësues e kjo nuk u vinte mirë organeve qeveritare, sepse populli shqiptar, do të binte nën ndikimin e të tjerëve. Pasiguria në vendet kufitare, situatën e bënte edhe më të rëndë, shumë mësues, nuk pranonin të shkonin në punë në këto anë, ata e lëshonin profesionin dhe punonin jashtë sektorit shoqëror.<sup>231</sup>

Sipas ideologjisë serbe, mësuesi para së gjithash duhet të jetë nacionalistë, pastaj të kryej punë tjera. Vetëm arsimtarët e këtillë ishin të pëlqyer për arsimin e brezave të rinjë, për politikën nacionale të shtetit.<sup>232</sup>

Si shkolla fillore shtetërore në Shkup e rrethinë, pa marrë parasysh përkatësinë nacionale, deri vitin 1941, ishin të evidentuara 247, por numri i nxënësve shqiptarë dhe turq ishte shumë i vogël. Në disavendbanime edhe pse ishin të paraparë këso shkolla, ato as edhe nuk u hapën. Shkolla serbe u hapen pas vitit 1928, por edhe kjo nëdisa fshatra që llogariteshin si fshatra qendrore, ku mund të përfshiheshin edhe nxënës nga fshatrat përreth. Në Shkup e rrethinëkanë funksionuar në 19 shkolla serbe. Kjo situatë ishte

---

<sup>229</sup> Gazeta "Glas Polloga", 3.VIII. 1935, 3.

<sup>230</sup> *Historia e popullit maqedonas*, 242; *Uçesnici dhe svedoci*, v. I, 162.

<sup>231</sup> Marija Jovanović, *Progoni na prosvetniot kadar poradi shirnje komunistički idei vo Vardarska Makedonija od 1919-1921*, Skopje, 1987, 216.

<sup>232</sup> *Uçesnici dhe svedoci*, v. I, 124.

evidente për arsye se sistemi i shkollimit në bazë ishte jodemokratik dhe dualist. Prindërit shqiptarë pyetnin se ç'dotë arrijnë edhe nëse e mbaronin këtë shkollë.

Por, qëllimi kryesorë i politikës shkollore ishte që të vihet në shërbim të politikës së shtetit një pjesë të popullatës, zakonisht nga ato më të pasurit, që nesërata të bëhet qytetarë lojalë të Serbisë. Prandaj në shumë rekomandime dhe statute, por edhe nëpërmjet seminareve dhe premtimevetë ndryshme për mësuesit, pushteti shihte “shpirtin e mësuesit”. Nuk është thënë rastësisht se “mësuesi është personi i parë dhe kryesorë në shtet”. Shumica e mësuesve që vinin në këto trevaishin mësues të dënuar të Shumadisë dhe të Malit të Zi. Pjesadërrmuese e tyre ishin në shkolla normale, por kishte edhe priftërinj, oficerë të pensionuar dhe me shkolla të ndryshme. Kushtet ekëqija të jetës, si edhe frika, bënin që shumica e tyre sapo të vinin, largoheshin nga shkollat dhe kështu në çdo vit 5 deri në 10 shkollaas që fillonin me punë.<sup>233</sup>

Meqë gjatë viteve 1918-1929, Mbretëria e SKS nuk kishte sukses për hapjen e shkollave shtetërore, atëherë u drejtua kah arsimi fetar, se gjoja ai ishte i lënë pasdore ose, siç thoshin pushtetmbajtësit, ailloj arsimi është në vullnetin e popullatës myslimane, nga njëra anë, kurse nga ana tjetër në çdo mënyrë kërkonin që edhe mbi institucionet fetare të kenë pushtet të plotë, që edhe ato të jenë nënmbikëqyrjen e Ministrisë së Arsimit. Pas vitit 1929, u bënë disa ndryshime, me të cilat Bashkësia Supreme e Beogradit e ndiqte mbarëvajtjen e jetës fetare, e cila angazhohej që ta forcojë moralin fetar te besimtarët myslimanë në Shkup. Prandaj formohet Ulema Mexhlisi i Shkupit, i cili do ta përgatiste planprogramin për lëndën e mësim besimit, do të emërontenëpunës fetarë, por edhe do të ushtronte pushtet disiplinor mbi ta. Sipas Ministri të Fesë, “shkollat shtetërore nuk janë gjendje të përfshijnë nxënës nëpër shkollat shtetërore për shkaktë mentalitetit të tyre, andaj është e nevojshme të hapen shkollafetare, në të cilat mësimi do të zgjasë 3 vjet dhe po ashtu edhe në shkollat fillore shtetërore do të mësohet mësimi i fesë me 2 orë nëjavë”. Për këtë qëllim në Shkup e rrethinë ishin angazhuar 19 mualimë (mësues të mësim-besimit islam). Me vendimin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 17531 të dates 5.III.1931, organet fetare fituan njëfarë autonomie. Ndër institucionet edukativo arsimore më të

---

<sup>233</sup> Avzi Mustafa, *Edukimi dhe arsimi i shqiptarëve në Shkup me rrethinë në mes dy luftërave botërore*, 46.

përhapura për edukimin fetar ishin sibjan-mejtepet, që ekzistonin pranë xhamive dhemesxhideve.<sup>234</sup>

Në rrethin e Shkupit ato ishin ndër më të përhapurat,saqë nuk kishte lagje në qytet ose në fshat që nuk kishte së paku njësibjan-mejtepe. Ato janë të vjetra sa edhe xhamitë. Shpesh në llojine mejtepeve themelore gjendej edhe sibjan-mejtepi, përkatësishtshkolla fillore dominonte fetare, të cilat më së shumti hapeshin nëfshatra, ku nuk kishte kushte për hapjen e shkollave të tjera në nivel më të lartë, si mejtep-ibtidaj ose medrese.Sibjan-mejtepet ishin institucione fetare islame të nivelit më tëulët në periudhën e sundimit të kësaj Mbretërie. Edhe pse në këtoskolla nuk jepej asnjë lloj diturie, përsëri pushteti serb ishte i qetë,sepse qarqet qeveritare dyshonin dhe herë-herë e pengonin me tëmadhe veprimtarinë e këtyre shkollave.Andaj ato kishin ndërprerjetë kohëpaskohshme, madje disa prej tyre edhe u ndërpre në fare.Mbyllja e këtyre institucioneve fetare në qarqet qeveritare bëhejnën dyshimin se edhe në këto shkolla po zgjohej vetëdija kombëtare, ndërsa mësuesit e tyre cilësoheshin si njerëz shumë të rrezikshëm.<sup>235</sup>

Për të pasur kontroll edhe mbi këta shkolla, Ministria e Arsimit nëQeverinë e Mbretërisë SKS në fillim solli vendim për mbyllje tëkëtyre shkollave, kundër të cilit vendim protestuan organet e atëhershme të Bashkësisë Fetare Islame, Ulema Mexhlisi dhe Reis-Ulemaja në atë kohë, Hfz.Ibrahim ef.Magllajliq, të cilët i dërguannjë memorandum Ministrisë, për ta arsyetuar jetën e këtyre shkollave. Pas këtyre protestave, më 5 mars të vitit 1931, Ministria eArsimit solli vendim që sibjan-mejtepet të vazhdojnë me punën etyre, në të cilat do të mësonin fëmijët myslimanë të moshës 3 derinë 7-vjeçare. Puna në sibjan-mejtepe do të vazhdojë në bazë tëplan-programit të hartuar nga Perandoria, por gjithsesi ato do tëishin të kontrolluara nga pushteti serb.Kjo hapje e sibjan-mejtepeve u bë në bazë të vendimeve që imerrte Ulema-Mexhlisi me seli në Shkup. Krahas hapjes së këtyre shkollave, ai i emëronte edhe sibjan-mualimët me dekrete të posaçme. Ulema-Mexhlisi në Shkup përpiloi edhe plan-program përsibjan-mejtepe, i cili dukej kështu: në vitin e parë mësoheshin lëndët: Shkrimi arab, Ilmihali, Edukimi dhe Edukata fizike, ndërkaq në vitin edytë ishin këto lëndë: Leximi i Kur'anit, Rregullat e

---

<sup>234</sup>*Po aty*, 47.

<sup>235</sup> Avzi Mustafa, *Edukimi dhe arsimiti i shqiptarëve në Shkup me rrethinë në mes dy luftërave botërore*, 47-48.

leximittë Kur'anit (texhvidi), Mësimi përmendësh i Kur'anit (hifzi), Edukata, Oratoria dhe Edukata fizike.<sup>236</sup>

Pushteti i atëhershëm, kishte marrë të gjitha masat, që popullata shqiptare, të mos ngrihej nga pikëpamja kulturore-arsimore, për këtë ekzistonin, udhëzime të veçanta të qarqeve qeveritare, në njërin prej tyre citohej: *"Në vendet me banorë të thjeshtë shqiptarë, të mos kërkohet që fëmijët të shkojnë në shkollë, gjegjësisht të mos arsimohen, çka është më me rëndësi, të mos mbahen kurset e edukimit fizik, për rininë, që të përgatitet para kohe për luftë"*. Jam më se i bindur, se kurset e këtilla në vendet shqiptare nuk duhen të mbahen, pasi vetëm mund të na dëmtojnë. Gjatë vitit shkollor 1929/1930 nga 18 banor u kyçen vetëm nga 1 nxënës në bankat shkollore, kurse gjatë vitit shkollor 1930/1931, në bankat shkollore, në çdo 15 banor inkorporuan nga 1 nxënës.<sup>237</sup>

Në të dhënat statistikore, shihej qartë se borgjezia serbe, nuk ishte e interesuar, që t'i japë popullatës së nënshtruar shkrim-lexim, por ajo ishte e interesuar të shkaktoj analfabetizëm masiv për qëllime të caktuara politike që veprohej në bazë të Projektit të Vasa Çubrilloviqit që të arrihet faza më e lartë e shkombëtarizimit të popullatës shqiptare dhe turke, për shpërnguljen tonë sa më masive në Turqi.<sup>238</sup>

Organet qeveritare nuk interesoheshin fare për rritjen dhe hapjen e shkollave fillore, në të shumtën e rasteve ky popull i shtypur, i varfër, por i etshëm për dituri, i kishte lëshuar edhe shtëpitë e tyre, me të mirat mësimore të nxënësve si paralele. Për kundër vullnetit dhe dëshirës së popullit, për të arsimuar fëmijët e tyre, nuk arritën të ndërrojnë vullnetin e borgjezisë serbe. Pra kjo politikë, mbeti e pa ndryshuar kur ishin në pyetje shqiptarët. Numri i shkollave fillore në këtë rreth, gjatë periudhës së lartë shënuar deri më vitin 1941, për këtë arsye relativisht mbeti i njëjtë. Përkundër direktivave të Ministrisë së Arsimit dhe për shkak të kontrollit të rreptë që bënte ajo faktet flasin ndryshe se një numër i madh i kuadrit arsimor ishin komunistë të cilët bashkë me të tjerët përhapnin ide komuniste ndër masat popullore duke shkuar shpeshherë nëpër shtëpitë e nxënësve duke bindur se pa tjetër duhet shkolluar jo vetëm djemtë por edhe vajzat.

Jeta kulturore për shqiptarët, nuk ishte e zhvilluar as më parë në Mbretërinë SKS-së, por pas grushtshtetit të 6-të janarit ajo u shua krejtësisht. Përpjekjet që të gjallërohet

---

<sup>236</sup> *Po aty.*

<sup>237</sup> *Almanah- Vardarska banovina, 517.*

<sup>238</sup> *Vasa Çubrilloviqi, Shpërngulja e shqiptarëve (arnautëve); Historia e popullit maqedonas, 743.*



jeta kulturore me aktivizimin e shoqatave nacionaliste, "Sokol", "Jadranska strazha", "Kollo srpskih sestara" etj, nuk dhanë kurrfarë rezultatesh.

Këto shoqata, edhe pse ishin të udhëhequra nga njerëz të shquar të borgjezisë serbomadhe, me buxhet të posaçëm financiar nga vet shteti, nuk arritën të zënë rrënjë në Banovinën e Vardarit as në mesin e rinisë maqedonase se qarqet sunduese i konsideronin si popull serb si të vetin, e mos të cekim popullin shqiptar, si element jo sllav i cili asnjëherë në asnjë moment nuk i ka pranuar këta shoqëri nacionaliste serbe.

Gjatë 22 viteve sa zgjati mbretëria e Jugosllavisë, nuk u botua asnjë libër shkollor në gjuhën shqipe, nuk u botua asnjë fletore ose revistë në gjuhën tonë. Prandaj nuk mund të konstatojmë se sistemi arsimor i Mbretërisë së Jugosllavisë, kishte dy veçori të qëndrueshme, atë restriktiv të pa zhvilluar që shkaktoi analfabetizëm masovik me qëllim shkombëtarizues. Në periudhën e themelimit të Mbretërisë Jugosllave (1929-1941), sistemi arsimor e ruante kontinuitetin e vet. Borgjezia serbe, vazhdonte politikën e vet asimiluese, gjatë asaj periudhe në Banovinën e Vardarit dhe më gjërë, përmes arsimit, ngjajshëm edhe në sferën e shtypit, kohë kur Maqedonia e Vardarit përjetonte një burg të vërtetë, pasi shtypi progresiv ishte i ndaluar rreptësisht.<sup>239</sup>

Populli serb në mënyrë të dhunshme bënte përpjekje që shqiptarëve, të cilët ishin nën sundimin e Mbretërisë Jugosllave, t'u imponohet gjuha, zakonet, mësimi i detyrueshëm igjuhës serbe. Pastaj, edhe ndërrimi i toponimeve të rrugëve në ato serbe, në këtë mbretëri, shqiptarëve ua ndërruan mbiemrat, duke jua shtuar prapashtesën "viq" p.sh Shaban-Shabanoviqose Zeqir-Zeqiroviq etj.

Sipas të dhënave të gazetës "Vardar" me hapjen e shkollave fillore dhe të mesme, nga Beogradi sollën mësues serb. Në Rashçe Stojan Dimitrieviq dhe Milan Markoviq, në Bojanë, mësues maqedonas në gjuhën serbe Boro Aleksievski, në fshatin Radush, Jevren Musllovariqi dhe Millosh Radoshani ku në këtë fshat edhe emri i shkollës ia kishte vënë "Vojvoda Micko". Arsimitartë cilët kishin shumë privilegj dhe nxënësve shqiptarë, ua mësonin shkrimin sllav dhe gjuhën e tyre,

Një ndër nxënësit e asaj kohe ishte Shaban Rameti (B.R), i cili, kishte mësuar në gjuhën serbe, ai rrëfente, se përveç mësimëve që merrnim nga arsimtari Millan, ai na e mësonte edhe betejën e FushëKosovës në gjuhën serbe. Qëllimi i hapjeve së këtyre

---

<sup>239</sup> Milan Vesoviq, *Revolucionarna shtampa u kraljevini Srba, Hrvata I Slovenaca*, (Beograd), 275.

shkollave në Shkup dhe rrethinë, ishte vetëm qëllim asimilimi dhe shkombëtarizimin e popullatës shqiptare, mirëpo në shkollën e vendlindjes dhe në Kuçkovë, mësonin vetëm fëmijë maqedonas në gjuhën serbe.<sup>240</sup>

Kjo metodë e mësimi, zhvillohej me lejen e Ministrisë së Arsimit të Mbretërisë Jugosllave në Shkup me rrethinë, në Krahinën e Dervenit, Karshiakës, Malit të Zi të Shkupit, dukshëm, për të asimiluar popullatën jo serbe, arsimtarët serb, ishin angazhuar edhe në Banovinën e Vardarit, në territorin e Kosovës. Përveç mësimi në mënyrë të ngjajshme, ato vepruan edhe me administratën, ku bënë ndërrimin e Toponimeve, nga shqipe në serbe.<sup>241</sup>

---

<sup>240</sup> Baki Bakiu, *Normalistët e Dervenit të Shkupit dhe rrethinës*, Shkup, 2009, 11.

<sup>241</sup> Abedin Krosi, *Gjurmët e të Kaluarës Shqiptare në Derven*, Shkup 2005, 135.

## PËRFUNDIMI

Periudha e Mbretërisë Serbe Kroate dhe Sllovene dhe Mretërisë Jugosllave njihet edhe si Jugosllavisë së Vjetër është një ndër periudhat më të vështira të rezistencës shqiptare. Kjo periudhë përfshinë edhe Banovinën e Vardarit 1918-1941, e cila ka përjetuar një politikë të rëndë ekonomiko-politike dhe administrative.

Popoullata shqiptare në Banovinën e Vardarit nën sundimin jugosllav përrjtoi të zitë e ullirit, pushteti me ndihmën e ushtrisë, policisë dhe çetnikëve të vendit e kolonëve të ardhur, dhunoi të drejtën legjitime të shqiptarëve mbi pronën e tyre të trashëguar. Kjo pasuri në të shumtën e rasteve ka kaluar me forcë në duar të ushtarakëve, policisë ku shumë kolonë të sjellë nga viset tjera të Jugosllavisë.

Në periudhën midis dy luftërave Botërore disa njerëz të njohur të politikës ditore serbe vazhduan paraqitjet e tyre me elaborate duke vazhduar rrugën e Ilija Garashaninit për eliminimin e shqiptarëve nga harta gjeografike. Këto projekte u përkrahën nga borgjezia dhe morën vizë edhe në parlamentin serb, ku kërkohet lidhja e kontratës së turpshme për shpërngulje të shqiptarëve nga trojet e veta, kinse me kompensim nga ana e Turqisë.

Nga ana tjetër kërkohet nga shtypi turk që kësaj marrëveshje për shpërngulje ti jepet peshë në kontest pozitiv, për atë se çka fitojnë shqiptarët (myslimanët), në qoftëse pranojnë të vendosen në vendet e “bukura” të Anadollisë. Kësaj politike shkombëtarizuese me të madhe iu kundërvu inteligjenca shqiptare, organizata “Besa”, pastaj forcat nacionaliste shqiptare si në Kosovë po ashtu edhe në Maqedoni të cilat kërkonin nga populli shqiptar që të qëndroj në vend dhe mos të shpërngulet. Ajo në veçanti apelonte te një pjesë e popullit e cila ishte e manipuluar nga elementë pro-turq, ku bënë pjesë edhe disa hoxhallarë fanatik, që trumbetonin, që shqiptarët të marrin rrugën e Turqisë.

Të gjitha këto veprime politike, të përcjellura nga aktiviteti ushtarak ndikuan që të forcohet pushteti i Jugosllavisë borgjeze. Forcimi i pushtetit nuk solli asgjë të re për përmirësimin e gjendjes së popullsisë të kësaj banovine e më gjerë, ku jetonte popullsia shqiptare. Shtypja nacionale dhe sociale ishin karakteristikë e këtij pushteti.

Shteti shfrytëzonte pasuritë dhe begatitë e saj, por nuk investonte gjë midis shqiptarëve, bile sadopak të përparojë ekonominë e vendit. Dega kryesore me të cilën merreshin pjesa dërmuese e popullsisë ishte bujqësia ekstensive e në veçanti kultura e duhanit. Për shkak të kushteve të mira klimatike dhe për arsye të nevojave të kohës dhe interesimit të pushtetit, kjo degë ekonomike filloi të përparoj me të shpejtë në tërë Banovinën e Vardarit.

Klasa sunduese e përkrahur nga organet shtetërore shtypte pa ndërprerë fshatarësinë e varfër. Në një situatë të tillë lindin dhe veprojnë parti të ndryshme borgjeze, të cilat bëheshin propaganduese “elite” kinse për të drejtat e popullit.

Jeta kulturore-arsimore në këtë kohë zhvillohej varësisht nga zhvillimi ekonomik dhe situata politike e shoqërore. Ajo ishte pasqyra më e mirë e zhvillimit të kësaj banovine dhe interesimi i të borgjezisë serbomadhe për ta kontrolluar. Nëpërmes të kësaj veprimtarie shoqërore shihej shtypja nacionale dhe shtypja sociale e popullsisë. Shkollat e pakta dhe institucionet e tjera të këtyre qyteteve ishin hapur kryesisht për popullsinë serbe. Për popullsinë shqiptare jo vetëm që nuk kishte shkolla, por edhe në jetën private mundoheshin tua ndalnin përdorimin e gjuhës dhe të veçorive të tjera nacionale.

Me ligj shkollat mund t’i ndiqnin edhe shqiptarët, por ndaj tyre zbatoheshin masa të ndryshme në mënyrë që numri i nxënësve shqiptarë të jetë sa më i vogël. Po ashtu, edhe format e tjera të ç’fardo aktiviteti kombëtar dënoheshin rreptë dhe ashpër. Shteti borgjez i Jugosllavisë nuk e pengonte arsimin fetar, ky gëzonte njëfarë autonomie, në një farë mënyre ndihmonte vetëm aktiviteti fetar. Për këtë arsye ishin hapur Sibijan mejtepet.

Në Jugosllavinë borgjeze shqiptarët ishin në pozitë më të vështirë se popujt tjerë që përbënin Jugosllavinë Mbretërore. Atyre jo vetëm që nuk janë njohur të drejtat themelore demokratike nacionale, të cilat ua njeh pakicave kombëtare edhe demokracia klasike borgjeze, por borgjezia serbe përpigëj t’i asimilonte dhe shkombëtarizonte, madje edhe t’i shfaroste fizikisht.

Pozita e shqiptarëve në Jugosllavinë e vjetër nuk duhet identifikuar me pozitën e pakicave të tjera kombëtare, siç vepohet rëndom në literaturën tonë të deritanishme historike e politike, sepse është gjë e pamohueshme se shqiptarët kanë jetuar në kushte shumë më të vështira sesa pjesëtarët e pakicave të tjera kombëtare.

Këto kondita ua plotësonte edhe ligji i vitit 1931, me plotësimin e përmirësimin e ligjit të vitit 1933, fshatarëve shqiptarë mund tu sekuestrohej toka deri te pragu i shtëpisë. Shpronësimit nuk i shpëtuan as pronat e institucioneve fetare shqiptare si myslimane ashtu edhe katolike. Kështu u shpronësuan pronat e xhamive të Shkupit, të Teqeve, pastaj të Muftynisë së Prizrenit, pronat e vakëfeve të Kumanovës, të Kaçanikut, të Preshevës. varrezat e kishës katolike të Pejës, varrezat shqiptare të Tetovës, të Shkupit. Kurse. nga ana tjetër kishave dhe manastireve serbe u jepeshin prona të familjeve shqiptare.

Shpërbërja e mbretërisë së Jugosllavisë pas pushtimit fashist në prill 1941 dhe periudha e viteve të Luftës II Botërore krijuan një ndërprerje të përkohshme të procesit të shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve nga Kosova dhe vise të tjera drejt Turqisë. Megjithatë vazhdoi hartimi i planeve për të rifilluar atë kur të përfundonte Lufta II Botërore dhe të krijohej sërishmi shteti i sllavëve të Jugut. Në përpjekjet për hartimin e platformave të tjera antishqiptare, thelbi i të cilave nuk ndryshonte aspak nga ato të para vitit 1941, u përfshinë pjesëtarë e përfaqësues të të dyja grupimeve politike jugosllave të vëna përballë njëra-tjetrës, të reaksionit çetnik profashist dhe, për çudi e për fat të keq, edhe të Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Ndërsa të parët e paraqiten platformën e tyre qysh në vitin e parë të pushtimit, të dytët e bënë këtë në fund të luftës.

Shqiptarët kanë qenë pa të drejta elementare në aspektin: politikë, ekonomik, nacional dhe kulturor. Borgjezia serbe është përpjekur me të gjitha metodat që t'i shkombëtarizojë dhe t'i likuidojë fizikisht shqiptarët, e në veçanti ata atdhetar që luftonin në mbrojtje të kauzës kombëtare. Në përgjithësi pozita e shqiptarëve ka qenë më e vështirë se e pakicave tjera në Jugosllavi. Kjo gjendje ka ndikuar në shtimin e urrejtjes së shqiptarëve ndaj Jugosllavisë borgjeze dhe organeve të saja. Baza ekonomike dhe superstruktura e kësaj ane ishte shumë e prapambetur, prandaj edhe mbretëronte një pozitë shumë e vështirë e shqiptarëve.

Angazhimi dhe interesimi i pushtetit vetëm për kolonët nuk mjaftonte për një jetë e përparim të kulturës e arsimit të tyre. Shkollimi kishte vulën klasore me privilegje speciale që kujdesi vetë shteti. Në këtë kategori bënin pjesë vetëm fëmijët e nëpunësve dhe oficerëve që shërbenin në poste në këto anë.

## **Shtojca 1:**

### **Shpërngulja e Arnautëve**

Problemi i arnautëve në jetën tonë kombëtare dhe shtetërore nuk ekziston prej dje. Ai ka luajtur rol të madh në jetën tonë nga periudha mesjetare, mirëpo përmasa jetike mori nga fundi i shekullit të 17, kur masat serbe filluan të shpërngulën prej tokave të vjetra të Rashkës kah veriu, e në vendin e tyre të vijnë malësorët shqiptarë. Ata gradualisht zbritën prej maleve të tyre në fushat pjellore të Metohisë dhe Kosovës dhe duke depërtuar kah veriu dhe u zgjeruan në drejtim të Moravës perëndimorë dhe jugore; nëpërmes malit Sharr lëshuan drejt Pollogut, e prej aty drejt Vardarit. Në këtë mënyrë, deri në shekullin XIX formuan trekëndëshin shqiptarë, pyka e cila e mbështetur, në boshtin Dibër-Rogozna, në prapashpinën e vet etnike thellë është ngulur në tokat tona, ka depërtuar deri në Nish dhe i ka ndarë tokat tona të vjetra të Rashkës nga Maqedonia dhe lugina e Vardarit. Derisa të gjitha shtetet ballkanike, prej vitit 1912 e këndeje, ose e kanë zgjidhur ose janë në rrugë për ta zgjidhur çështjen e pakicave kombëtare me shpërnguljen e tyre, në u përqendruam në metodën e mërzitshme të kolonizimit gradual. Rezultatet e këtij kolonizimi ishin negative. Se është kështu më së miri dëshmojnë të dhënat statistikore nga 18 qarqe të cilat e përbejnë atë trekëndësh shqiptar. Nga këto të dhëna statistikore shihet se shtimi natyror i shqiptarëve në këto hapësira ka qenë më i madh se numri i shtimit tonë natyror dhe kolonizimit të bashkuar. (Prej vitit 1921 deri në vitin 1931 shtimi i shqiptarëve është 88.060, ndërsa i serbëve 58.745 vete; dallimi është 9.315 në dobi të shqiptarëve). Nëse kemi parasysh vazhdimësinë, shtimi i madh i shqiptarëve dhe kushtet gjithnjë më të rënda për kolonizim me metoda të vjetra, ky dallim, me kalimin e kohës, do të bëhet gjithnjë më i madh më në fund do ta sjellë në pyetje edhe atë pak sukses të kolonizimit që është arritur prej vitit 1916 e deri më sot. Nëse nisemi nga këndvështrimi se shpërngulja graduale e shqiptarëve me kolonizimin tonë gradual është joefikase, mbetet vetëm shpërngulja masovike. Në këtë rast dy shtete vijnë në konsideratë, Shqipëria dhe Turqia. Rrallë e banuar, me shumë kënetë të pathara dhe me lugina të parregulluara lumore, Shqipëria do të ishte në gjendje të pranojë ca qindra mijë shqiptarë të shpërngulur prej këtu.

Turqia moderne, me hapësira të mëdha në Azinë e Vogël dhe në Kurdistan, ende të pabanuara, të pakultivuara, ofron mundësi të pakufizuara për kolonizim të brendshëm.

Mirëpo, krahas shume rekomandimeve te Qemal Ataturkut, turqit nuk e kanë plotësuar diferencën e shkaktuar me shpërnguljen e grekeve prej Azisë së Vogël në Greqi dhe një pjesë të kurdëve në Persi. Prandaj, gjasat më të mëdha janë se atje do të mund të dërgojmë pjesën më të madhe të shqiptarëve tanë. Supozojmë se me Tiranën do te jetë rëndë, aty është Italia e cila do ta pengojë këtë, mirëpo në Tiranë të hollat luajnë rol të madh. Gjatë negociatave, pala shqiptare duhet ti bëhet të vihet me dijeni ngurrojmë për asgjë gjatë zgjidhjes definitive të kësaj çështje dhe njëkohësisht atyre duhet tu bëhet me dije se do të këtë edhe subvencione kontrolla të drejtpërdrejt; e cila eventualisht mund të shkojë edhe nëpërmjet kanaleve te fshehta, por edhe me angazhimin e njerëzve me influence ne Tiranë, qe të mos jenë kundër kësaj çështje.

### **Mënyra e shpërnguljes**

Theksuam se shpërngulja efikase e shqiptareve nga trekëndëshi i tyre është vetëm shpërngulja masovike. E qe të vijë shpërngulja masovike, kusht i pare është krijimi i psikozës se përshtatshme. Ajo mund te krijohet në mënyra te ndryshme. Është e njohur se muslimanët në përgjithësi lehte u nënshtrohen ndikimeve, veçanërisht atyre fetare, janë naiv dhe fanatik. Për këtë arsye së pari nevojitet qe për çështjen e shpërnguljes se shqiptareve te përfitohet paria e tyre fetare dhe njerëzit me influence, ose me te holla ose me kërcënime. Sa me shpejte duhet gjetur agjikator, të cilët do të agjitojnë për shpërnguljen, veçanërisht nëse këta i ofron vetë Turqia. Ata duhet ti përshkruajnë bukuritë e viseve te reja ne Turqi, jetën e lehte dhe te këndshme, te nxisin ne mase fantazimin fetar dhe ta nxisin ne te krenarinë e përkatësisë (shtetësisë) turke. Shtypi ynë mund të bëjë shërbim te jashtëzakonshëm nëse bën përshkrimin e shpërnguljes së brendshme të turqve prej Dobruxhe dhe vendosjen e tyre të bukur në viset e reja. Me këto përshkrime edhe ndër masën e shqiptarëve tanë do te krijohet disponim i volitshëm për shpërngulje.

## **Mënyra tjetër do të ishte presioni i aparatit shtetëror**

Ai duhet deri ne maksimum ti shfrytëzojë ligjet qe ta beje sa më të padurueshme ekzistencën e shqiptareve në dënime, arrestime, aplikimi i pamëshirshëm i te gjitha rregulloreve policore, dënimi i kontrabandës, prerjes se malit, lëshimit te qeneve, kulluku, dhe te gjitha mënyrat dhe mjetet tjera qe një polici praktike është në gjendje ti shpikë. Ne ekonomi, mosnjohja e tapive te vjetra, në këto vise, duhet urgjentisht te ndërpritet puna e kadastarit, rritja e pamëshirshme e tatimeve, si dhe te borxheve publike, dhe private, marrja e kullotave shtetërore, komunale, tërheqja e lejeve për kafenetë, shitoret e zejtareve, monopolit, private dhe shërbimeve vetadministruese, etj, do te shpëtojnë shpërnguljen. Gjate shpërnguljes duhet patur kujdes rreth këtyre gjerave: Fillimisht duhet shpërngulur fshatrat e pastaj qytetet. Fshatrat janë me stabile, prandaj edhe me te rrezikshme. Pastaj, nuk guxon te gabohet dhe te shpërngulen vetëm te varfrit; në çdo popull shtyllën e përben shtresa e mesme dhe me e pasur, dhe ata duhet shtyre te shpërngulen. Varfanjaket, pa mbështetje me bashkatdhetarët e vet ekonomikisht te pavarur, humben shpejt. Kjo është çështje shume e rëndësishme dhe e theksoj meqë një nga arsyet e mossuksesit te kolonizimit tonë në jug ke qene ai se është shpërngulur shtresa me e varfër, e te pasurit kane mbetur, kështu qe, çdoherë kemi ngelur ne vend, Sepse kemi fituar shume pakë hapësirë per kolonizim. Gjatë krijimit te psikozës së shpërnguljes duhet tentuar qe te shpërngulen fshatra të tëra, ose se paku familje të tëra. Me çdo çmim duhet paguar qe një pjese e familjes te shpërngulet e një pjese te mbetet. Shteti ynë nuk do te harxhohet për atë qe ta lehtësojë jetën e shqiptareve por qe te lirohet prej numrit sa me te madh te tyre. Prandaj duhet patur kujdes qe te mos ndodhë qe pasurinë e patundshme te atyre qe shpërngulen ta blejnë ata qe mbeten këtu. Ketë duhet vëne si kusht të shpërnguljes jo vetëm të individëve por edhe te fshatareve te tere, nëse dëshirojnë te fitojnë lehtësime gjatë shkuarjes se tyre. Posa të pajtohen të shpërngulen duhet menjëherë tu ofrohet e gjithanshme. Administrata duhet thjeshtësuar, pasuria e patundshme duhet paguar urgjentisht, dokumentet për udhëtim duhet tu jepen pa kurrfarë formalitetesh, duhet tu ndihmohet qe te vijnë deri te te stacioni i pare hekurudhor, tu jepen në dispozicion trenat deri në Selanik dhe menjëherë me anije te barten në Azinë e Vogël. Shumë me rendësi është qe udhëtimi te jete i lehte dhe i lire.



Hekurudhat, mundësisht tu jepen falas, ndihma me ushqim poashtu, sepse prej kesaj varetnëse do të ketë shpërngulje masovike. Frika nga pengesat gjatë udhëtimit do te jete pengesa e pare për lëvizjen e tyre dhe prandaj kjo duhet gjithsesi te zgjidhet ne mënyre të shpejte dhe energjike nëpërmjet lehtësimit te te gjitha punëve rreth transportit.Me rendësi te klasës se parë për zgjedhjen e çështjes për te cilat diskutojmë është aparati i cili do te dirigjojmë me ketë pune. Një pjese e madhe e mossuksesit te politikës sonë të deritashme kolonizuese qëndron mbi aparatën e keq udhëheqës. Me qellim qe te evitohet një gjë e këtillë edhe ne të ardhmen, duhet të behet riorganizim.Asnjë punë nuk kërkon aq kontinuitet në udhëheqjen e saj saqë kërkon kolonizimi. Ne përmendëm se një nder arsytet e mossuksesit te kolonizimit ne veri dhe jug është jo kontinuiteti në udhëheqjen e punëve dhe mungesa e politikës së qëndrueshme e cila do ndryshoje me ndryshimin e qeverive. Qe të evitohet një gjë e këtillë edhe ne te ardhmen, udhëheqja me punet e kolonizimit duhet ti besohet Gjeneral Shtabit kryesor. Ja pse. Për arsye të pastra te mbrojtjes, ushtria jonë ka interes qe veçanërisht ne kufijtë e ndejshëm te këtë elementin e vet. Prandaj ajo do te punojë qe qe ti siguroje kufijtë me kolonizim sa me te fortë. Gjeneral shtabi suprem, si institucion i mbrojtjes kombëtare mund te ndihmoj shumë në politiken kolonizuese. Gjeneral shtabi me së miri do të dije te mbrohet nga ndërmjetësuesit privat, interesat e partive të ndryshme dhe te gjitha ndikimet e tjera nga anët, dhe do te munde te realizoje ne mënyrë te drejt politikën tonë kolonizuese. Është me rëndësi se ai do ta ketë me lehtë ti bindë faktorët përgjegjës lidhur me rëndësinë e çështjes dhe do të mundë te ndikojë ne sjelljen e vendimeve te rëndësishme dhe efikase. Kuvendi do ti besojë më se miri dhe me parë do ti lejojë kreditë e nevojshme.Me punën ne përgjithësi do te udhëhiqte Gjeneral Shtabi nëpërmjet një këshilli për kolonizim. Ky këshill do të ishte plotësisht autonom, do te ishte nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Gjeneral Shtabit, e nen kontrollin e plot do te kishte organizimin e plotë të organizimit te kolonizimit tonë. Ne ketë këshill do të hynin edhe përfaqësues te caktuar te ministrave te interesuar dhe shoqatave kombëtare, organizatave të specializuara dhe instituteve shkencore. Gabim i madh i politikës sonë kolonizuese ka qenë pikërisht ai se fjalën kryesore e ka patur aparati jo kompetent burokratik i cili ka zgjidhur çështjet në mënyrë të pjesërishme dhe pa i hulumtuar mirë.

## Shtojca 2:

### Konventa jugosllavo-turke e vitit 1938

Qeveria e Republikës së Turqisë dhe Qeveria e Madhërisë së Mbretit të Jugosllavisë konstatuan: Emigrimin e myslimanëve nga regjioni i Serbisë së Jugut, dhe njëherit vlerësuan se kjo popullatë nga ana tjetër, në përgjithësi, i ka humbur të drejtat e regjimit të lirë në Jugosllavi, së bashku kishin përcaktuar, ta braktisin teritorin e Mbretërisë, me dëshirën e tyre legjitime në mënyrë që t'u bashkohen etnikëve të tyre në Turqi. Ata shfaqën dëshirën që të nënshkruajmë Konventën sipas së cilës caktuan mënyrat e shpërnguljes prej ndikimet përkatës të Madhërisë së tij, prej Mbretit të Jugosllavisë, M. Ekselencës së tij “Zotëri Kryetar i Republikës së Turqisë”.

**Neni 1:** Me këtë Konventë identifikohen shtetasit jugosllav me fe, kulturë dhe kombësi myslimane, që flasin gjuhën turqishte. Ndërsa me këtë konventë nuk identifikohen, personat për të cilët hyrja në Turqi ishte e ndaluar sipas ligjeve dhe rregullave të Turqisë, të cilat ishin në fuqi edhe atë: popullata nomade dhe jevge.

**Neni 2:** Regjionet, të cilat i nënshtrohen emigrimit, sipas kësaj Konvente, ishin si vijon:

1. *Rajoni i Banovinës së Vardarit:* Rajoni i Malit Sharr (Prizreni), Gora (Dragashi), Podgora (Suha-Reka), Nerodimja (Ferizaj), Donji Pollog-Pollogu i Ulët (Tetova), Gornji Pollog, Pollogu i Sipërm (Gostivari), Galica (Rostusha), Dibra (Dibër), Struga (Strugë), Garaçanica (Prishtina), Kaçaniku (Kaçanik), Gjilani (Gjilan), Presheva (Preshevë), Prespa (Resnja), Poreçi (Juzhni Brod - Makedoski Brod), Pëilepi (Prilep), Bitol (Manastir), Kavadarci (Kavadari), Marihovo (Manastiri - Marihovë), Negotin na Vardaru (Negotini i Vardarit), Skopje (Shkupi), Kumanova (Kumanovë), Velesi (Veles), Ovçe Pole (Ovçe Pole), Radovishte (Radovishi), Strumica (Strumicë), Dojrani (Vallandova), Gjevgjelia (Gjevgjelia), Kriva Pallanka (Kriva Pallanka), Kratovo (Kratova), Carevo Sello (Carevo Sello), Malësi (Berova); 2. *Rajoni i Banovinës së Zetës, përfshinte këto territore :* Pejën (Pejë), Istoku (Istog), Mitrovicën e Kosovës (Mitrovia e Kosovës), Gjakovën (Gjakovë), Podrimjen (Rahovec). 3. *Rajoni i Banovinës së Moravës përfshinte trevat:* Llapin (Podujevën) Vuçiternën (Vuçiterna) Drenicën (Serbica). Qeveria jugosllave, caktonte se nga cili regjion, do fillonte emigrimi i dhunshëm.

### **Neni 3.**

Numri i familjeve, për të cilat Qeveria turke, mori obligimin, që t'i pranojë nga regjionet e përmendura në Nenin 2 Sipas kushteve të kësaj Konvente, të emigruarit e dhunshëm përfshinte te 40.000 Këtu përfshihen familjet e përbashkëta dhe anëtarët e tyre (personat) fëmijët e një gjaku, të cilët në momentin e nënshkrimit të kësaj Konvente, jetojnë në një bashkësi familjare të pandarë, nën një kulm të përbashkët.

**Neni 4:** Riatdhesimi i 40.000 familjeve, të realizohet për gjashtë vjet, sipas këtyre proporcioneve:

Në v. 1939, *4.000 -familje,*

Në v. 1940, *6.000- familje,*

Në v. 1941, *7.000- familje,*

Në v. 1942, *7.000- familje,*

Në v. 1943, *8.000- familje,*

Në v. 1944, *8.000- familje.*

Nëse ky numër i familjeve, nuk mund të realizohet sipas viteve të parapara, për shkak të pengesave, vështirësive eventuale, dy palët kontraktuese, do të bëjnë Marrëveshje sipas dispozitave përkatëse ligjore, mbi numrin e të emigruarve, të cilët do të evakuohen nga njëra anë, do të pranohen nga pala tjetër, tre muaj para fillimit të emigrimit. Kuptohet, këto ndryshime eventuale të numrit të të emigruarve në vjet, nuk mund të zgjatet më tepër se gjatë gjashtë vite të caktuara të fiksuara për emigrim. Koha e emigrimit, për çdo vit do të zgjasë prej muajit maj deri më 15 tetor pos kontinngjenit vitit të parë i cili do të fillojë në fillim të muajit korrik 1939.

**Neni 5:** Kjo Konventë, do zbatohet vetëm për emigrimin e popullsisë, siç u përmend me sipër. Turqit myslimanë dhe shqiptarët, të cilët jetojnë në qytet në regjionet e lartpërmendura, anëtarët dhe begatitë e tyre nuk përfshihen në stimuli sipas Marrëveshjes së caktuar me Kontratë. Nëse dëshirojnë të emigrojnë të lirë, në pajtim konform me ligjin mbi emigrimin e tyre në Turqi. Me këtë rast, ata lirisht mund t'i shlyejnë begatitë, mallrat e tyre në fshat dhe qytet. Qeveria jugosllave, sa i përket shpërnguljes në Turqi, caktoi sasinë dhe shumën e shlyerjes të mallrave të pasurisë së tyre, ndërsa sa i përket vizës për hyrjen e tyre definitive në Turqi, Qeveria Turke do t'i ofrojë të gjitha lehtësimet e nevojshme për dokumentet e duhura.

**Neni 6:** Sa i përket pasurisë së pa tundshme në qytet, ajo do t'u mbetet në disponim të lirë- pronarëve të tyre. Kuptohet, Qeveria jugosllave, nuk mori obligim për pasurinë e pa tundshme në fshat, në çastin kur njerëzit, të shpërnguleshin, sipas listës së caktuar, të cilët kishin braktisur vendbanimin e tyre, nga vend zbakimi i caktuar. Deri në marrjen e pasurisë nga Qeveria jugosllave, shfrytëzimi i kësaj pasurie, siç ishte e garantuar me këtë konventë do mbetet nga pronarët e saj.

Pronësimin e kësaj pasurie, Qeveria Jugosllave do ta realizoj lirisht në harmonizim me ligjin për kolonizimin e trevave të Serbisë së Jugut, me ligjin në fuqi.

**Neni 7:** Qeveria Jugosllave, duhet t'i paguajë Qeverisë turke shumë 500 lira turke për një familje, ndërsa sasia e plotë, ishte 2.000.000 lira turke, për 40.000 familje, në bazë të së cilët sasi, këto familje do merren në konsiderim. Përkundër kësaj pagese globale, të gjitha pasuritë e pa tundshme të shpërngulurve, në pajtim me Nenin 6 e gjithë pasuria e patundshme e të emigruarve me dhunë, mbetej pronë e Qeverisë Jugosllave. Sa i përket pasurisë së tundshme dhe të pa tundshme fshatare, të kombësisë myslimane ose të Vakëfit, kjo konventë nuk i dëmtonte dispozitat e ligjit ekzistues, i cili rregullonte ato.

**Neni 8:** Qeveria jugosllave më 1 prill dhe më 1 tetor të çdo viti zbatonte kryeje për pagesën periodike kuartale, në proporcion me familjet që shpërngulen, të evakuar gjatë vitit dhe të mund te zvogëlohet ose rritet në proporcion me numrin e tyre, kostoja pagesore e caktuar (Neni 7), të kryhet në 12 këste e ndarë për 6-të vjet.

**Neni 9:** Qeveria jugosllave, secilën pagesë, do ta bëjë: 30% ne deviza, të cilat ia dedikoi ti ket në dispozicion Qeveria e Republikës së Turqisë përmes Bankës Popullore të Jugosllavisë, 70% në dinarë, duke i deponuar në Bankën Popullore të Jugosllavisë, në dobi të xhirollogarisë në favor të Qeverisë së Republikës së Turqisë, Banka Popullore e Jugosllavisë, për secilën pagesë, ta njoftojë menjëherë Legatën e Turqisë në Beograd, se dispozita është kryer në xhirollogarinë e tyre.

**Neni 10:** Për konvertimin e dinarëve në lira turke, Banka Popullore e Jugosllavisë dhe Banka Qendrore e Republikës së Turqisë, do të realizojnë, Marrëveshje të përbashkët, sipas kursit të ndërrimit në lira turke, i cili vlen ditën e ndërrimit, përkatësisht në ditën e secilës pagesë.

**Neni 11:** Fondet e deponuara në Bankën Popullore të Jugosllavisë, të shfrytëzohen nga ana e Qeverisë së Republikës Turke, në cilëndo formë pagese, apo shpenzim. Të realizuara në Jugosllavi, qoftë për blerje në tregun jugosllav, përveç mallrave, eksportimi i të cilëve ishte i ndaluar dhe kushtëzuar me pagesat e tyre në deviza, siç ishin: bakri, leshi, prodhimet nga lëkura, prodhimet nga druri i arrës, frutat e vajrave, ullinjtë, gruri dhe misri. Blerja e të gjitha këtyre mallrave, realizoheshin duke ia destinuar Turqisë. Këto mallra, do lirohen nga çdo tatim, taksë ose ngarkim tjetër i eksportimit. Kuptohet se për eksportim, nuk do të zbatohen dispozitat e parashikuara në harmonizim të Marrëveshjeve komerciale të kontraktuara ose të ndërprera por ajo bëhet në harmonizim me dispozitat e kësaj Konvente.

**Neni 12:** Personat që do të evakohen gjatë periudhës së shpërnguljes, të cilët do të shpërngulen sipas Listës vjetore. Duhet të japin Deklaratë me shkrim para autoriteteve jugosllave, në harmonizim të nenit 53 të ligjit mbi shtetasit jugosllavë që ishte në fuqi, të heqin dorë dëshirë nga shtetësia Jugosllave. Këta persona do t'i kenë cilësitë dhe do t'i gëzojnë të drejtat e të shpërngulurve sipas ligjeve turke, që nga momenti kur përfaqësuesit e Turqisë, të cilët do të emërohen për këtë çështje, do t'i nënshkruajnë Listat vjetore të emigrimit në Turqi.

**Neni 13:** Të shpërngulurit, në përgjithësi, do të jenë të lirë t'i shlyejnë ose t'i bartin me veteë, të gjitha mallrat, pasuritë e tyre të tundshme, që i posedonin si pronë individuale, si: shtazët e shpezët nga fermat e tyre, veglat, makinat etj, të cilat i përdornin në punë bujqësore ose industriale, ose për ushtrimin e zejeve e profesioneve të tyre. Megjithatë, për transportin e mallrave të shpërngulurit gëzonin zvogëlimin e taksave sipas tarifës në fuqi. Megjithatë nuk gëzonin zvogëlimin e taksave për kafshë si p.sh gjashtë 6-të kafshë të trasha, 20-të kafshë të imëta, duke mos i llogaritur të vegjlit e tyre për secilën familje që shpërngulej. Ata që shpërngulen, ishin të autorizuar, në mënyrë të barabartë të importojnë ekskluzivisht stolitë e tyre personale, qaforet ose pjesët e tyre, gjerdanët nga ari, argjendi, të cilat i mbanin në qafë femrat, secili nga ata, nuk mund të importojnë me shumë se një palë të së njejtës markë. Përkundër kësaj secili kujdestar i familjes ishte i autorizuar, që lirisht të importojë në të dalurit nga Jugosllavia, shumë prej 2.000 dinarësh ose maksimum prej 4.000 dinar, të shndërruar në kundërvlerë deviza, pas likuidimit të pasurisë së tyre të tundshme dhe të pa tundshme në qytet ose fshat,

mallrat eksportimi i të cilave nuk ishte i kushtëzuar në deviza ose i ndaluar në Jugosllavi, as importimi i tyre nuk ishte i ndaluar në Turqi. Të gjitha këto mallra, u nënshtroheshin taksave dhe ngarkesave të tjera për eksport dhe import.

**Neni 14:** Banka Popullore e Jugosllavisë, hapi xhiro-llogarinë speciale në emër të Qeverisë së Turqisë në Bankën Qendrore të Republikës së Turqisë, ku secili i shpërngulur do këtë mundësi të deponojë të gjitha sasi të monetares, që i takojnë, me të cilat disponon, në pikëpamje të garantimit të transportimit, përmes blerjes së mallrave në Jugosllavi. Banka Popullore e Jugosllavisë, njoftonte Legatën e Turqisë në Beograd për secilën transaksion të bërë në efektiv, me udhëzim të detajuar të deponuesit. Këto sasi, të transferuara në Turqi përmes mallrave të blera në Jugosllavi do t'u kthehen të interesuarve nga pala e Bankës Qendrore e Republikës së Turqisë

**Neni 15:** Fondet, mallrat, stollitë, mobiliet dhe të gjitha sendet e tjera, të cilat u përkasin të miturve dhe anëtarëve të tjerë të familjes që u ka besuar kujdestari i familjes, të besuara nga organet kompetente jugosllave, do t'u paguhet ose do t'i lejohen Qeverisë së Republikës së Turqisë që në të ardhmen do t'i sigurojë administrata dhe mbrojtja e tyre, deri se të rriten ata ndërsa shpagimi i tyre do të transaksionohet kryetarit të familjes, i cili e gëzon këtë të drejtë në harmonizim me ligjin e Turqisë.

**Neni 16:** Të gjithë të rinjtë myslimanë, familjet e të cilëve ishin regjistruar në listat vjetore të shpërnguljes, e të cilët ende gjendeshin në radhët e Armatës jugosllave menjëherë do të lirohen nga shërbimi ushtarak i mëtejshëm dhe në të njëjtën kohë të shpërnguleshin së bashku me familjet e tyre. Në të njëjtat kushte nuk do të përfshiheshin të rinjtë myslimanë-turq që jetonin në regjionet popullore e të cilave është caktuar të emigrohet gjatë vitit vijues.

**Neni 17:** Nga pala e Qeverisë jugosllave, të emërohet një Komision i veçantë i cili do angazhohej për hartimin e listës vjetore për të shpërngulurit duke detajuar me të gjitha shënimet e nevojshme mbi kushtet, profesionin dhe zejet e tyre. Listat duhet t'u prezantohen nga pala e tyre, të cilat do shërbejnë si bazë, për dëshminë e dhënies së pasaportit turk, dhe për llogaritjen e numrit të familjeve të shpërngulurve. Komisioni jugosllav mbajti bashkëpunim të përhershëm me të dëbuarit turq në kërkesë të tyre duhet t'u ofrojë atyre të gjitha informatat për të cilat ata kanë nevojë.

**Neni 18:** Nisja dhe ngarkimi i të shpërngulurve të bëhet në bazë të pasaportave turke kolektive, të cilat do t'u lejohen atyre nga autoritetet konsullore të Qeverisë së Republikës së Turqisë në Jugosllavi, Pasaportat kolektive turke, dhe të gjitha dokumentet tjera të nevojshme, të cilat vlejnë si dëshmi, si përgatitja e Listave vjetore, e vizave përkatëse me pasaporta për të dalë nga Jugosllavia të bëhen gratis.

**Neni 19:** Në zonën e lirë të Jugosllavisë në Selanik të konstituohet një Komision miks turko- jugosllav i përbërë nga nëpunës të emëruar nga të dy qeveritë i cili do angazhohet me Marrëveshje të përbashkët për të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme, sipas rrethanave dhe kushteve të ngarkimit dhe të zbarkimit të të shpërngulurve.

**Neni 20:** Kjo Konventë, hyn në fuqi ditën e ratifikimit të saj nga pala e dy qeverive. Njëherit nënshkruesit, këtë Konventë do të vërtetojnë me vullat përkatëse, të hartuar në gjuhën frënge më vitin 1938.

## **DOKUMENTET ARKIVORE**

### **Dokumente të pa botuara:**

#### **Arkivi i Maqedonisë-Shkup:**

Fondi: “Materiali juzhni pregled”, nr. 19, kut. 8.

ДАРМ-Фонд 619, кутија 7- Окружни и обласни муфтијства, скопје 1921-1941

Raport i armatës së III, kut. 36/7, nr.768, më 13 qershor 1939, Beograd.

АИНИ, фонд: *Треќа Армиска Облас*, ред.бр. 201, број на инв.5012, 14.09.1919, 1.

АИНИ, фонд. Миладин Стојадиновиќ, К.ХХХИХ.

Историски Архив- Скопје, Двдесет денови на Скопската црвена Општина.

#### **Arkivi i Shqipërisë- Tiranë:**

AQSH.Fondi 261,viti 1941, dosja 99; fondi 251; fondi 846, dos. nr.1, 1918.

АИН,Тiranë, Dok. A-VII-51.

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej AMPJSH ), Viti.1922, dosja.50, Raport i Legatës së Shqipërisë në Beograd dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë.

### **Dokumente të botuara:**

1. *Sluzhbene novine*, 6 janar 1929.
2. *Dokumenti i materiali u oči Drugog svetskog rata*, I, Zagreb 1949
3. *Izvori velike srpske agresije*, Zagreb 1991.
4. Pavle Mitreski, *Srpski dokumenti za istoriata na Ohridsko-Strushkiot region (1890-1940)*, Struga, 2002.
5. *Almanah- Vardarska banovina*, Beograd, 1931.
6. *Zakon o unutrashnjoj upravi 1929*, Beograd, 1932.
7. *Definitivni rezultati popisa stanovništva 31.X.1931*, Sarajevo, 1940.
8. *Statistički godisnjak 1931*, Beograd, 1934.
9. *Statistika izbora narodnih poslanika*, 8.XI.1931, Beograd, 1935.
10. *USTAV Islamske Vjerske Zajednice Kraljevine Jugoslavije*, 9 Jula 1930.
11. *Isaljavanje arnauta*, Beograd 1937.
12. *Elaborat o Albaniji iz 1939*.
13. *Statistika narodnih poslanika Kraljevine SHS drzhanih* 18.III.1923, Beograd.



## LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Abedin Krosi, *Gjurmët e të kaluarës Shqiptare në Derven të Shkupit*, Shkup, 2005.
2. Ali Hadri, *LNÇ në Kosovë (1941-1945)*, Prishtinë, 1971.
3. Ali Hadri, *Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë Jugosllavisë 1918-1941*, Prishtinë, 1980.
4. Akademia e Shkencave të RPS-së të Shqipërisë, *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Tiranë 1990.
5. Ала Качева, Славица Христова, Татјана Ѓорѓиевска, *Животот во Скопје 1918-1941*, Скопје, 2002.
6. Алексије Јелачич, Франце Масеснел, Атанасије Урошевич, *Скопје и Околнину*, Скопје, 1937.
7. *Almanah Kralvine S.H.S.*, III, 1927- 1929, Zagreb, 1930.
8. Aleksandar Apostolov, *Vardarska Makedonija od Prvata Svetska vojna do izborite za konstituantata 28 noemvri 1920*, në: "Zbornik", Filozofskog Fakulteta Shkup, 1962.
9. Александар Апостолов, *Колонизацијата на македонија во стара Југославија*, Скопје, 1966.
10. Avzi Mustafa, *Edukimi dhe arsimit i shqiptarëve në Shkup me rrethinë në mes dy luftërave botërore*, në: SCUPI, nr. 12, Shkup, 2015.
11. Bajram Xhafa, *Lufta e Dibrës 1920*, Shkodër 2001.
12. Baki Bakiu, *Derveni i Shkupit ndër shekuj*, Shkup 2011.
13. Baki Bakiu, *Normalistët e Dervenit të Shkupit dhe Rrethinës plejadë pishtarësh të arsimit*, Shkup, 2009.
14. Bogomil Hrabrak, *Stanje u Vardarskoj Makedoniji u Jesen i zimu 1918*, "Istoriski Glasnik", 1966.
15. Bogumil Hrabrak, D.Janković, *Srbija 1918*, Beograd, 1968.
16. Branko Petranović, Momçillo Zeçeвиç, *Jugosllovenski federalizam idje i stvarnost, 1914-1943*, Beograd 1987.
17. Branko Petroviç, Momçillo Zeqeviç, *Jugosllovenski federalizam ideje i stvarnost*, pjesa e I, 1914-1943, Beograd 1987.
18. Boshković, Aleksander Apostolov, *Stav KPJ prema agrarnoj reformi i kolonizaciji na Kosovu i Metohiji 1919-1941*, në: "Kosova", nr. 1, Prishtinë 1972

19. Çlirim Dervishi, *Fushëgropa e Ohrit në vitet 1918- 1941*, gusht, 2011 (temë magjistrature, e pa botuar).
20. Димитрије Богдановић, *Књига о Косову*, САНУ, књига. DLXVI, Београд, 1986.
21. Dorđe Krstić, *Kolonizacija Juž. Srbije* Sarajevo 1928.
22. *E vërteta mbi Kosovën dhe Shqiptarët në Jugosllavi*, Tiranë, 2000.
23. Gazmend Kadiu, *Rrjedhat ekonomike te shqiptarët e Maqedonisë*, në: *Shqiptarët e Maqedonisë*, Shkup, 1994.
24. Halim Purellku, *Maqedonia Perëndimorë dhe qëndresa e popullsisë shqiptare kundër pushtuesve*, në: *“Shqiptarët e Maqedonisë”*, Shkup, 1994.
25. Halim Purellku, *Lëvizja Kaçake në Maqedoninë Perëndimore (1919 – 1927)*, Zvicër, 1991.
26. Halim Purellku, *Veprimtaria e Komitetit të Kosovës në Mbretërinë shqiptare në vitet 1934-1939*, Tiranë 2009.
27. Halim Purellku, *“Si u tretën myslimanët”*, në: *Hëna e Re*, nr. 39, Qershor 1992
28. Hajredin Hoxha, *Elemente të presionit ekonomik ndaj shqiptarëve në Jugosllavinë e vjetër*, në: *“Përparimi”*, nr. 4 viti XVI, Prishtinë 1970.
29. Hajredin Hoxha, *Politika e eliminimit të shqiptarëve nga trualli i Jugosllavisë së Vjetër*, në: *“Përparimi”*, 1972.
30. Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë 1918-1941*, Prishtinë, 1981.
31. Hivzi Islami, *Kosova dhe shqiptarët çështja demografike*, Prishtinë, 1990.
32. *Historia e popullit shqiptar*, v. III, Tiranë, 2007.
33. *Historia e popullit maqedonas*, Shkup, 1983.
34. Hivzi Islami, *Kosova dhe shqiptarët çështja demografike*, Prishtinë, v.1990.
35. Hysen Terziu, *Gjenocidi serb*, Prishtinë, 2005.
36. *Istorija na makedonskiot narod*, Skopje, 1988.
37. Jacques Ansel, *La Macedoine*, Paris, 1930.
38. Јанка Вукичевиќа, *Приведа Јужне Срвије*.
39. Jovan Marjanović, *Narodnooslobodilački rat. Narodna revolucija u Jugosllaviji (1941-1945)*, Beograd 1956.
40. Jovan Trifunovski, *Skopski derven*, Skopje 1983.
41. Јован Хаћи Васињевиќ, *Скопје и негова околина*, Београд, 1930.

42. Jusuf Buxhovi, *Kosova nga Konferenca e Londrës deri tek protektorati ndërkombëtar*, Prishtinë, 2012.
43. Jusuf Osmani, *Organet për zbatimin e reformës agrare dhe të kolonizimit në Kosovë ndërmjet luftërave botërore*, në: Kosova, nr. 15, Prishtinë 1986.
44. Jusuf Osmani, *Rezistenca e Xhemijetit kundër zbatimit të reformës agrare dhe kolonizimit të Kosovës*, në: SCUPI, nr. 20, Shkup, 2018.
45. Krisaq Prifti, *Kontribut i Komitetit “MKK”, për rimëkëmbjen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe për bashkim kombëtar 1918-1924*, Tiranë, 2004.
46. Крсто Манчев, *История на балканските народи 1918-1945*, Софиа, 2008.
47. Lush Culaj, *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” 1918-1924*, Prishtinë, 1997.
48. Лубодраг Димић, *Културна политика у Кралевини Југославији 1918-1941 груги део школо и црква*, Београд, 1997.
49. Limon Rushiti, *Regullimi administrativ i Kosovës 1918-1929*, në: Përparimi, 1976.
50. Љиљана Чолић, *Партија Цемијет како парламентарна странка у Кралевини СХС*, në: Историјски часопис, књ. XLVII (2000), Београд, 2002.
51. Лазар Марковић, *Економско- финансијски програм народне радикалне странке*, Загреб - Београд - Љубљана, 1925.
52. Masar Kodra, *Shqiptarët e Maqedonisë gjatë luftës Dytë Botërore*, Kumanovë, 1996.
53. Masar Kodra, *Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane (1918-1945)*, Shkup, 1997.
54. Marija Jovanović, *Prosvetnitate politički priliki vo Vardarska Makedonija, 1918-1928*, Skopje, 1983.
55. Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë 1918-1941*, Tiranë 1992.
56. Marija Jovanović, *Prosfetno – politički priliki vo Vardarska Makedonija (1918-1929)*, Shkup, 1983.
57. Marija Jovanović, *Progoni na prosvetniot kadar poradi shirnje komunistički idei vo Vardarska Makedonija od 1919-1921*, INI, Shkup 1987.
58. Milovan Obradović, *Agrarna Reforma i Kolonizacija na Kosovu 1918-1941*, Prishtina, 1981.
59. Millutin Folliq, *“Akcije Studenata Kosova za prava Allbanskog naroda u periodu 1937-1941”*, në: Kosova, nr.8, Prishtinë, 1979.

60. Milivoje Erić, *Agrarna reforma u Jugosllaviji 1918-1941*, Sarajevë 1958
61. Миливоје Павлович, *После двадесетнет година*, Скопје.
62. Milan Vesović, *Revolucionarna shtampa u kraljevini Srba, Hrvata i Slovenaca*, Beograd.
63. Милана Чемериќича, *Трговина, Занатство, Индустија, Кредитне Установе од 1875-1937*.
64. Muhamed Salkić, *Ustavi islamike zajednice*, Sarajevo, 2001.
65. Muhamed Keshetovuç, *Kontrarevolucija na Kosovu*, Bograd 1984.
66. Mustafa Memiq, *Velika Medresa i njeni uçenici i revolucionarnom pokretu*, Skopje, 1984.
67. Надежта Цветковска, *Просветна прилика Вардарска Македонија*, Скопје, 1999.
68. Nadezta Cvetkovska, *Makedonskoto prashanje vo Jugosllovenskiot parlament megu dvete Svetski vojni*, Shkup, 2000.
69. Nebi Dervishi, *Etnokultura e Fushgropës së Ohrid*, Tetovë, 2005.
70. Nikola Vućo, *Poljoprivreda Jugosllavije 1918-1941*, Beograd, 1958.
71. Петар Стојанов, *Македонија времето на балканските и Правата Светска Војна (1912-1918)*, Скопје, 1969
72. Pançe Kirovski, *Tetovo i tetovsko niz isorijata*, Tetovo, 1982.
73. Qerim Lita, *Diplomacia shqiptare në Shkup (1935 – 1941)*, Shkup, 2015.
74. Rauf Fico, *Shtetar dhe diplomat shqiptar* (monografi), Tiranë, 2007.
75. Sarac Nedim, *Politicka istorija naroda 1878 – 1945*, Sarajevo, 1967.
76. Skender Asani, *Dëshmit për Shkupin shqiptar dokumente*, Shkup, 2011.
77. Skender Asani, *Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore* (dokumente), v. I, Shkup, 2015.
78. Skender Asani, *Aktiviteti zgjedhor i Xhemijetit gjatë vitit 1923*, Shkup, 2016.
79. Свето Стаменов, Искра Чоловиќ, Хорбај Драшко и Кире Попов, *Поглед врз стара Скопска Чаршија*, Скопје, 1997.
80. *Skopje 30 godini sloboden razvoj*, Mladinska Kniga, Lubjanë 1976.
81. *Srbija i Allbanci- Pregled politike Srbije prema Allbancima od 1913do 1945*, v. II, Ljublana, 1989.
82. Стефан Фртулиќ, *Тежак живот занатлија Јужне Србије*, пë: “Занатлија”, г. IV, бр. 3, Београд, 1924.
83. Svet K. Marković, Jakov Ivanović, *Shkolstvo Juzhne Srbije od 1912-1937*, Skopje, 1937.

84. Svetozar Naumovski, *Naprenoto učitelstvo vo Vardarskiot dell na Makedonija megjudvete Svetski vojni (1918-1941)*, Shkup, 1992.
85. Спасоје Ѓакович, *Сукоби на Косову*, Београд, 1984.
86. Shinazi Memeti, *Roli i Bashkësisë Fetare Islame dhe Myftinisë së Shkupit ndërmjet luftërave botërore*, në: SCUPI, nr. 12, Shkup, 2015.
87. Ђоко Богојевић, *Аграрна реформа*, Јубиларни Зборник живота и рада Срба, Хрвата и Словенаца 1918 - 1928, Београд, 1938.
88. Ђурђе Јеленић, *Нова Србија и Југославија (1788-1921)*, Београд, 1923.
89. Група автори, *Погледа врз стара Скопска Чаршија*, Скопје 1997.
90. Vebi Xhemaili, *Pozita e vështirë ekonomike dhe politike e shqiptarëve të Pollogut gjatë sundimit të Mbretërisë Serbe në Pollog*, 1918-1941, “Flaka”, 11-19.I.1994.
91. Vebi Xhemaili, *Zgjedhjet parlamentare në Mbretërinë SKS dhe partitë politike borgjeze në Tetovë*, në: Shqiptarët e Maqedonisë, Shkup, 1994.
92. Vodić Kroz, *Skopje i Okolinu*, Skopje 1937.
93. Vuk Vinaver, *Çështja shqiptare në shtypin e PKJ 1919-1939, “Gjurmime albanologjike”*, Prishtinë, 1972.
94. Zamir Shtylla, *Shpërnguljet me dhunë të shqiptarëve nga Kosova dhe viset tjera midis dy luftërave Botërore (1918-1941)*, në: “Kosova”, nr. 3. Tiranë 1995.

## REVISTA

1. Revista “Scupi” Shkup.
2. Revista “Jehona” Shkup.
3. Revista “Kosova” Prishtinë.
4. Revista “Zbornik Radova” Beograd.
5. Revista “Përparimi” Prishtinë.
6. Revista “Jugosllovenski istoriski časopis”, Beograd.

## GAZETA

1. Gazeta “*Borba*”, Zagreb, më 5 .IV. 1923.
2. Gazeta “*Novosti Zagreb*”, 14 sijeçna 1929
3. Gazeta “*Radniçe novine*”, nr. 172/23-VIII, 1913.
4. Gazeta “*Tetovske novine*”, 15 nëntor 1934.
5. Gazeta “*Grafiçar*”, Beograd, më 24 V. 1938.
6. Gazeta “*Proleter*”, nr. 11-15, shkurt 1930.
7. Gazeta “*Glas Polloga*”, 18 shtator 1937.
8. Gazeta “*Radikal*”, Beograd, nr. 72, 6 janar, 1922.
9. Gazeta “*Vardar*”, Shkup.
10. Gazeta “*Vullneti i popullit*”, nr.128, 12 shtator 1930.
11. Gazeta “*Rad*”, Zagreb.
12. Gazeta “*Borba*”, Beograd.
13. Gazeta “*Politiçi Vjesnik*”, Zagreb.